



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

RAPORT
MBI
ZBATIMIN E BUXHETIT VJETOR,
SITUATËN MAKROEKONOMIKE DHE FISKALE
GJATË VITIT 2020

Tiranë, Maj 2021

PËRMBAJTJA

1. REZULTATI I BUXHETIT TË KONSOLIDUAR.....	6
2. PASQYRË E ZHVILLIMEVE MAKROEKONOMIKE.....	7
2.1 Zhvillimet e fundit ekonomike.....	7
2.1.1 Sektori real	7
2.1.2 Sektori monetar	8
2.1.3 Sektori i jashtëm	8
2.2 Krahasimi me vendet e rajonit	9
3. POLITIKAT FISKALE DHE REZULTATI I MBLEDHJES SË TË ARDHURAVE	11
3.1 Politika fiskale në vitin 2020 dhe efektet në buxhet e në ekonomi	11
3.1.1 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	12
3.1.2 Tatimi mbi të Ardhurat	12
3.1.3 Akciza	13
3.1.4 Taksat Vendore	13
3.2 Të ardhurat e përgjithshme	13
3.2.1 Të ardhurat nga ndihmat	15
3.2.2 Të ardhurat tatimore	15
3.2.3 Të ardhurat nga pushteti vendor	15
3.2.4 Të ardhurat nga fondet speciale	16
3.2.5 Të ardhurat jotatimore	17
3.2.6 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat	18
3.3 Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera	21
3.3.1 Taksimi Indirekt	21
3.3.2 Taksimi direkt	24
4. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME.....	28
4.1 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike.....	29
4.2 Shpenzimet sipas natyrës funksionale.....	36
4.3 Ndryshimet në ligjin e buxhetit 2020.....	37
4.4 Fondi Rezervë dhe Kontigjenca.....	40
4.5 Programi i Rindërtimit	42
4.6 Politikat sociale dhe ekonomike në kuadër të masave anti-COVID19.....	44
4.6.1 Mbështetje për shëndetësinë	45
4.6.2 Mbështetje sociale për familjet në nevojë	45
4.6.3 Mbështetje për punësimin dhe bizneset.....	46
4.6.4 Masat për nxitjen e punësimit	46
4.6.5 Stimuli për ekonominë: Garancia sovrane.....	46
4.6.6 Lehtësimet fiskale	47
5. BUXHETI VENDOR.....	47
5.1 Të ardhurat e njëjësive të vetëqeverisjes vendore	48
5.2 Shpenzimet e njëjësive të vetëqeverisjes vendore	50
5.3 Detyrimet e prapambetura të Njëjësive të Vetëqeverisjes Vendore	52
6. MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK	53

7. RREZIQET FISKALE DHE DETYRIMET KONTIGJENTE GJATË 2020.....	54
7.1 Ndërmarrjet shtetërore	56
7.2 Detyrimet e prapambetura të pushtetit qendror	59
7.3 Koncesionet/PPP-të.....	61
7.4 Detyrime të tjera Kontigjente:.....	62
7.4.1 Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ)	62
7.4.2 Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit	63
8. SHTOJCAT	64
8.1 Shtojca 1 - Zbatimi dhe monitorimi i parimeve dhe rregullave fiskale.....	64
8.2 Shtojca 2 – Efektet e paketës fiskale 2020	70
8.3 Shtojca 3 Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës.....	71
8.3.1 Shëndetësia dhe Mbrojtja Sociale	72
8.3.2 Arsimi	74
8.3.3 Bujqësia dhe Zhvillimi Rural	76
8.3.4 Infrastruktura dhe Energjia	77
8.3.5 Turizmi dhe Mjedisi	79
8.3.6 Drejtësia	80
8.3.7 Institucionet e Sistemit të Drejtësisë	81
8.3.8 Financat, Ekonomia, Punësimi dhe Arsimi Profesional	81
8.3.9 Mbrojtja	84
8.3.10 Kultura	85
8.3.11 Rendi dhe Siguria Publike	86
8.3.12 Politika e Jashtme	87

TABELA DHE GRAFIKË

Tabela 1 Produkti i Brendshëm Bruto	9
Tabela 2 Norma e papunësisë	10
Tabela 3 Bilanci tregtar	10
Tabela 4 Norma e inflacionit	10
Tabela 5 Bilanci fiskal	11
Tabela 6 Borxhi publik	11
Tabela 7 Treguesit e të ardhurave kryesore (në miliardë lekë)	14
Tabela 8 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat (në milionë lekë)	19
Tabela 9 Performanca e të ardhurave nga akciza: mallrat kryesorë 2020 - 2019	23
Tabela 10 Shpenzimet sipas funksionit (në milionë lekë)	36
Tabela 11 Të ardhurat dhe shpenzimet e pushtetit vendor, sipas natyrës	51
Tabela 12 Detyrimet e prapambetura në nivel vendor sipas kategorive	53
Tabela 13 Matrica e riskut	55
Tabela 14 Koncesionet/PPP-të aktive me mbështetje nga buxheti i shtetit (në mijë lekë)	62
Tabela 15 Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës	71
Tabela 16 Realizimi i buxhetit 2020 në disa institucione kryesore qendrore	71
Tabela 17 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (në mijë lekë)	72
Tabela 18 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (në mijë lekë)	74
Tabela 19 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (në mijë lekë)	76
Tabela 20 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (në mijë lekë)	77
Tabela 21 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit	79
Tabela 22 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Drejtësisë	80
Tabela 23 Realizimi i buxhetit 2020 për Institucionet e Drejtësisë	81
Tabela 24 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë	82
Tabela 25 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Mbrojtjes	84
Tabela 26 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Kulturës	85
Tabela 27 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Brendshme	86
Tabela 28 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme	88
Grafiku 1 Shpenzimet e përgjithshme publike ndaj PBB-së (në miliardë lekë)	6
Grafiku 2 Të ardhurat e përgjithshme (në miliardë lekë) ndaj PBB-së	13
Grafiku 3 Ecuria e zërave kryesorë të të ardhurave gjatë vitit 2020	14
Grafiku 4 Të ardhurat e përgjithshme (në miliardë lekë), sipas kategorive kryesore	15
Grafiku 5 Të ardhura nga pushteti vendor në vite (në miliardë lekë)	16
Grafiku 6 Përbërja e të ardhurave nga pushteti vendor sipas zërave kryesorë në 2020 (në %)	16
Grafiku 7 Të ardhurat nga fondet speciale në vite (në miliardë lekë)	17
Grafiku 8 Përbërja e të ardhurave nga fondet speciale (në %)	17
Grafiku 9 Përbërja e të ardhurave jotatimore (miliardë lekë)	18
Grafiku 10 Të ardhura nga tatimet dhe doganat në vite (në miliardë lekë) dhe në % të PBB-së	18
Grafiku 11 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat sipas llojit	19
Grafiku 12 Të ardhurat doganore, rënia vjetore sipas llojit të taksave 2020 - 2019 (në milionë lekë)	20
Grafiku 13 Të ardhurat tatimore, rënia vjetore sipas llojit të taksave (në milionë lekë)	20
Grafiku 14 Të ardhurat tatimore, sipas sektorëve (në %)	21
Grafiku 15 TVSH-ja brenda vendit, sipas sektorëve (në %)	22
Grafiku 16 Rimbursimi i TVSH-së në vite (në milionë lekë)	22
Grafiku 17 Akciza në vite (miliard lekë)	23
Grafiku 18 Akciza sipas natyrës së mallrave (në %)	24
Grafiku 19 TAP në vite (në miliardë lekë)	25
Grafiku 20 TAP sipas zërave në vitin 2020 (në %)	25
Grafiku 21 Tatimi mbi fitimin në vite (në miliard lekë)	26
Grafiku 22 Tatimi mbi fitimin sipas sektorëve në vitin 2020 (në %)	26
Grafiku 23 Kontribuesit aktivë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, sipas llojit të biznesit	27
Grafiku 24 Kontribuesit aktivë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, sipas sektorit (në %)	28
Grafiku 25 Shpenzimet e përgjithshme korrente dhe kapitale (mld lekë) dhe ritmi i rritjes vjetore (në %)	29
Grafiku 26 Shpenzimet korrente dhe kapitale plan dhe fakt ndaj totalit të shpenzimeve 2020 (mld lekë)	29
Grafiku 27 Struktura e shpenzimeve të përgjithshme dhe raporti me PBB-në ndër vite	30
Grafiku 28 Shpenzimet korrente dhe ritmi i rritjes së tyre (milion lekë)	30

Grafiku 29 Struktura e shpenzimeve korrente (milion lekë)	31
Grafiku 30 Shpenzimet e personelit në vite dhe ritmi i rritjes (miliardë lekë)	31
Grafiku 31 Shpenzimet për interesa në vite dhe ritmi i rritjes (miliardë lekë)	32
Grafiku 32 Shpenzimet operative e të mirëmbajtjes dhe ritmi i rritjes vjetore (miliardë lekë)	32
Grafiku 33 Shpenzimet per subvencione dhe ritmi i rritjes (miliardë lekë)	33
Grafiku 34 Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (miliardë lekë)	33
Grafiku 35 Shpenzimet per ndihmën ekonomike, PAK dhe papunësinë (miliardë lekë)	34
Grafiku 36 Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliardë lekë)	34
Grafiku 37 Realizimi i të ardhurave tatimore dhe jotatimore në vitin 2020 dhe 2019.	48
Grafiku 38 Të ardhurat vendore në raport me totalin e të ardhurave publike dhe PBB.	49
Grafiku 39 Të ardhurat e pushtetit vendor në vite dhe ritmi i ndryshimit.	49
Grafiku 40 Të ardhurat e pushtetit vendor sipas burimit në vite	50
Grafiku 41 Të ardhurat e veta të pushtetit vendor sipas burimit në vite	50
Grafiku 42 Shpenzimet e pushtetit vendor në rritje dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)	51
Grafiku 43 Shpenzimet e pushtetit vendor sipas klasifikimit ekonomik (në milionë lekë)	51
Grafiku 44 Sektori quasi publik sipas numrit të ndërmarrjeve	56
Grafiku 45 Ecuria e nivelit të arkëtimeve të OSHEE sh.a (në miliardë lekë)	57
Grafiku 46 Ecuria e nivelit të humbjeve në rrjet për OSHEE sh.a (në %)	57
Grafiku 47 Stoku i detyrimeve të prapambetura qendrore dhe vendore gjatë vitit 2020, mln lekë	60
Grafiku 48 Stoku i detyrimeve të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës dhe ministrive të tjera	60

1. REZULTATI I BUXHETIT TË KONSOLIDUAR

Covid-19 pati një efekt mbizotërues në ekonominë shqiptare dhe atë globale gjatë vitit 2020, ndërsa Shqipëria përballoi dhe efektet e tërmetit të nëntorit 2019. Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) nominale u kontraktua me 3.3% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, duke shënuar vlerën 1,607.9 miliardë lekë. Ky është recesioni i parë në Shqipëri për më shumë se dy dekada, por ekonomia shqiptare dëshmoi qëndrueshmëri dhe rënia ekonomike rezultoi shumë më e përmbajtur se sa parashikimi fillestar, i cili luhatej midis -6.1% dhe -8% në vit. Gjithashtu edhe parametrat e tjerë më të rëndësishëm mbetën përgjithësisht të qëndrueshëm, duke marrë parasysh përhapjen e pandemisë Covid-19 në gjithë botën dhe dhe masat kufizuese të ndërmarra nga autoritetet publike për të frenuar përhapjen e saj që në mars 2020. Shqipëria është veçanërisht e ekspozuar ndaj tkurrjes ekonomike të lidhur me pandeminë për shkak të marrëdhënieve të saj intensive me disa nga ekonomitë e BE-së të prekura më rëndë nga pandemia, si dhe sepse ajo mbështetet fort në sektorin e turizmit.

Ndikimi i pandemisë në tregun e punës ishte i ndjeshëm, veçanërisht në tremujorin e dytë të vitit 2020. Megjithatë, një pjesë e punësimit u recuperua gjatë gjysmës së dytë të vitit si pasojë e rihapjes graduale të ekonomisë dhe masave të marra për subvencionimin e pagave dhe implikimet strukturore afatgjata për tregun e punës nuk janë shqetësuese. Shkalla e papunësisë në tremujorin e fundit të vitit 2020 ishte 12.3%, me një rritje të lehtë nga niveli prej 11.6% që shënonte në fund të vitit 2019. Ndërkohë, punësimi u kontraktua me rreth 1.8% në krahasim me një vit më parë dhe në fund të vitit 2020 numri i të punësuarve në Shqipëri ishte 1,172,988 persona.


Pozicioni i jashtëm i ekonomisë mbetet relativisht i fortë. Tkurrja e mprehtë e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve u kompensua nga pesha e lartë strukturore e importeve të mallrave dhe shërbimeve, të cilat gjithashtu kanë patur rënie të ndjeshme. Si rezultat, bilanci i përgjithshëm i pagesave u mbyll me një teprice relativisht të lartë, ndryshe nga shqetësimet fillestare, kryesisht edhe në sajë të flukseve hyrëse në formën e huamarrjes së huaj të qeverisë, të cilat kompensuan si zgjerimin relativ të balancës korrente, ashtu edhe rënie me rreth 11% të flukseve të Investimeve të Huaja Direkte.

Të ardhurat totale të buxhetit të konsoliduar për vitin 2020 ishin 425.9 miliardë lekë, ose rreth 34.4 miliardë lekë (-7.5%) më pak se një vit më parë dhe . Edhe ky kontraktim i të ardhurave, edhe pse nga më të fortit në dekada, sërish rezultoi të ishte ndjeshëm më i zbutur se sa parashikimet fillestare. Si peshë ndaj ekonomisë, të ardhurat e përgjithshme publike arritën në 26.5% të PBB-së (nga 27.4% në 2019).

Në terma nominalë, **shpenzimet e përgjithshme** publike gjatë vitit 2020 ishin 536.2 miliardë lekë, ose 44.3 miliardë lekë (9.0%) më shumë se në vitin 2019. Zërat kryesorë që ndikuan në rritjen e shpenzimeve në vitin 2020 ishin rritja e shpenzimeve kapitale, në veçanti lidhur me fillimin e procesit të rindërtimit nga tërmeti, si dhe rritja e shpenzimeve të ndihmës sociale për mbështetjen ndaj efekteve të pandemisë.

Deficiti fiskal në 2020 arriti në 6.9% të PBB-së, nga një mesatare prej afro 2% në tre vitet e mëparshme, por megjithatë rezultoi më i ulët se sa kufiri ligjor prej 8.4% e PBB-së, ndërsa borxhi publik arriti nivelin prej 76% të PBB-së, në rritje me pothuaj 10 pikë për qindje nga viti 2019. Sidoqoftë, borxhi publik rezultoi më i ulët se sa pritshmëritë fillestare prej rreth 80%, ndonëse u rriti për herë të parë pas katër vjetësh, për shkak të nevojës së huamarrjes së qeverisë për të përballuar efektet e krizës së pandemisë.

Grafiku 1 Shpenzimet e përgjithshme publike ndaj PBB-së (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Huamarrja u realizua nëpërmjet burimeve të brendshme dhe burimeve të huaja, përkatësisht në nivelin prej 3.1% dhe 3.8% ndaj PBB-së. Borxhi publik neto për vitin 2020 ishte 1,216.6 miliardë lekë, ose 75.7% e PBB-së, në rritje nga 64.8% e PBB-së në vitin 2019. Stoku bruto i borxhit që përfshin dhe likuiditetin për financimin e borxhit për 2020 ndaj PBB-së gjithashtu u rrit, duke arritur 76.1% në vitin 2020, në rritje me pothuaj 10 pikë për qindje nga viti 2019, por megjithatë edhe ky parametër rezultoi më i ulët se sa pritshmëritë fillestare prej rreth 80%.

2. PASQYRË E ZHVILLIMEVE MAKROEKONOMIKE

2.1 Zhvillimet e fundit ekonomike

2.1.1 Sektori real

Rritja ekonomike për vitin 2020 pati një kontraktim vjetor prej 3.3% kundrejt vitit 2019. Ndihmuar nga efektet bazë, tkurrja e ekonomisë shqiptare në tremujorët paraardhës u recuperua në tremujorin e katërt, duke regjistruar një rritje prej 3% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, ndërkohë që tkurrja rezultoi -10.2% dhe -2.8% përkatësisht në tremujorin e dytë dhe të tretë. Në rënien ekonomike prej -3.3%, tkurrja më e madhe rezultoi në sektorët e shërbimeve; ndërkohe që patën rritje sektorët: “Aktivitete të pasurive të paluajtshme” me 0.41 pikë për qindje; “Bujqësia, pyjet dhe peshkimi: me +0.16 pikë për qindje; si dhe “Ndërtimi: me +0.14 pikë për qindje.

Sipas optikës së shpenzimeve, konsumi final si dhe kërkesa e brendshme kanë pësuar rënie respektivisht me vlerat -2% dhe -1.96%. Ndërkohë, për 2020 pozicioni i jashtëm i ekonomisë mbetet i qëndrueshëm. Tkurrja e mprehtë e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve është kompensuar nga pesha e lartë strukturore e importeve të mallrave dhe shërbimeve, të cilat gjithashtu kanë patur rënie të ndjeshme.

Tregu i punës ka treguar shenja se pasojat nga pandemia nuk kanë qenë shumë shqetësuese. Në fund të vitit 2020, shkalla e papunësisë pësoi një rritje të lehtë në 11.8% për grupmoshën 15 vjeç e lart, e gjithashtu për grupmoshën 15-64 vjeç, shkalla e papunësisë arriti në nivelin 12.3%. Ritmi vjetor i rritjes së punësimit për popullsinë 15-64 vjeç, nga tremujori i katërt të vitit 2019 deri në tremujorin e katërt të vitit 2020 ishte negativ prej -1.8% ose rreth 37 mijë të punësuar më pak. Megjithatë, edhe shkalla e pjesëmarrjes në tregun e punës u kontraktua, duke arritur në 68.7% krahasuar me 69.7% që ishte në tremujorin e katërt të vitit 2019. Në fund të vitit 2020 numri i të punësuarve në Shqipëri ishte 1,172,988 persona.

2.1.2 Sektori monetar

Gjatë vitit 2020, inflacioni mesatar rezultoi 1.6%, ndërkohë inflacioni i fund-vitit rezultoi 1.1%. Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato të cilët patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

- (i) “Ushqime dhe pije jo alkoolike” me rritje vjetore të çmimit prej +2.5%, duke kontribuar me +0.95 pikë për qindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.1%.
- (ii) “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me rritje vjetore të çmimit prej +1.2%, duke kontribuar me +0.24 pikë për qindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.1%.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato të cilët patën kontributin më të ulët në inflacionin e përgjithshëm ishin:

- (i) “Transport” ka pësuar rënie vjetore të çmimit prej -4.9%, duke kontribuar me -0.31 pikë për qindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.1%.
- (ii) “Veshje dhe këpucë” ka pësuar rënie vjetore të çmimit prej -0.6%, duke kontribuar me -0.02 pikë për qindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.1%.

Në vitin 2020, *stoku total i kredive bankare* pati një rritje me 6.6% krahasuar me vitin 2019. Stoku i kredive në lekë shënoi rritje prej 7.3%, ndërsa ai në valutë rritje prej 5.9%, krahasuar me muajin dhjetor të vitit të kaluar. Pjesa më e madhe e kontributit në rritjen e stokut total të kredisë gjatë kësaj periudhe ka ardhur prej kredive akorduar bizneseve. Stoku i kredive akorduar bizneseve jo-financiare (private dhe publike) për muajin dhjetor 2020 shënoi një rritje me 7.1%. Kredia vetëm për bizneset private jo-financiare u rrit me 10.3%, duke kontribuar pozitivisht me 6 pikë për qindje në ndryshimin e stokut total të kredisë. Ndërsa, stoku i kredive akorduar bizneseve publike jo-financiare për muajin dhjetor të vitit 2020 ka shënuar rënie me 37.3%, krahasuar me dhjetorin e vitit 2019, me kontribut negativ prej 1.6 pikë për qindje. Stoku i kredive akorduar individëve deri në muajin dhjetor të vitit 2020, ka shënuar rritje prej 6.6%, krahasuar me dhjetorin e vitit 2019, duke kontribuar pozitivisht në ndryshimin e stokut total të kredisë me 2.3 pikë për qindje. Raporti i kredive me probleme zbriti në nivelin 8.2% në muajin dhjetor, duke pasqyruar masat konkrete të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për reduktimin e tyre, si dhe përmirësimin e ambientit ekonomik dhe të gjendjes financiare të kredimarrësve.

Monedha shqiptare ka vijuar të ketë një kurs këmbimi përgjithësisht të stabilizuar kundrejt valutave kryesore në tregun e këmbimit valutë. Përgjatë vitit 2020, kursi i këmbimit Lek/Euro shënoi mesatarisht në nivelin 123.8, ndërsa kursi ndaj dollarit Lek/Dollar arriti në 108.65.

2.1.3 Sektori i jashtëm

Eksportet e mallrave për periudhën janar-dhjetor 2020 shënuan rënie prej -9% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Grupet që kanë ndikuar në uljen vjetore të eksporteve janë: “Tekstile dhe këpucë” me -5.3 pikë për qindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3.5 pikë për qindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1.2 pikë për qindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Ushqime, pije, duhan” me +1.2 pikë për qindje dhe “Makinëri, pajisje, pjesë këmbimi” me +0.5 pikë për qindje.

Importet e mallrave për vitin 2020 shënuan rënie me -6.8% krahasuar me vitin 2019. Grupet që kanë ndikuar kryesisht në uljen vjetore të importeve janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3.5 pikë për qindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1.8 pikë për qindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -0.8 pikë për qindje. Në ndryshimin vjetor të importeve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Produkte kimike dhe plastike” me +0.4 pikë për qindje dhe “Ushqim, pije, duhan” me +0.1 pikë për qindje. Deficiti tregtar për vitin 2020 është ulur me -4.9% krahasuar me vitin e kaluar, pasi importet u tkurrën më shumë se eksportet: norma e mbulimit të eksporteve ndaj importeve për këtë vit është 44.9%. Shkëmbimet tregtare për vitin 2020 me vendet e BE zënë 61,3 % të gjithë tregtisë. Eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 74.7 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 58.0 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (31,4 %), Greqia (7,7 %), Gjermania (7,1 %) dhe Turqia (7,0 %).

Në vitin 2020, *Bilanci i Pagesave* shënoi rritje, duke arritur vlerën 654.7 milionë euro, nga -77.8 milionë euro që ishte në vitin 2019.

Për vitin 2020, *deficiti i llogarisë korrente* u zgjerua në -1,154.7 miliardë euro krahasuar me një vit më parë që ishte -1,089.0 miliardë euro. Llogaria financiare dhe kapitale u zgjerua në vlerën +1,624.7 miliardë euro krahasuar me +903.3 milionë euro që ishte në vitin 2019. Ndërkohë, investimet e huaja direkte shënuan vlerën +996.7 milionë euro ose -10.8%, krahasuar me +1,118.0 miliardë euro që ishte një vit më parë. Për vitin 2020, remitancat shënuan rënie në vlerën +673.4 milionë euro, krahasuar me +701.9 milionë euro në vitin 2019, ose -4.1%.

2.2 Krahasimi me vendet e rajonit

Në vitin 2020, rritja mesatare e PBB-së në Ballkanin Perëndimor ishte -3.3%, nga +3.6% që ishte në vitin 2019, ndikuar kryesisht nga pasojat e masave shtrënguese për parandalimin e përhapjes së pandemisë. Kjo është rënia e parë në prodhimin vjetor të rajonit, pas 10 vite zgjerim të produktit të brendshëm bruto (PBB-së). Ecuria ekonomike e tremujorit të katërt të vitit 2020 ka shfaqur një përmirësim për të gjitha vendet e rajonit, por aktiviteti ekonomik mbetet nën nivelet e parapandemisë. Në përgjithësi, komponentët e kërkesës së brendshme kanë ndikuar negativisht në rritjen ekonomike, ndërsa ato të kërkesës së jashtme kanë kontribuar në mbështetje të saj.

Në Shqipëri, rritja vjetore ekonomike shënoi një rënie të ndjeshme në -3.3% nga +2.1% që ishte në vitin 2019, kryesisht si pasojë e ndikimit të krizës globale të pandemisë COVID-19, e cila pasoi efektet negative të tërmetit që goditi vendin në nëntor 2019. Megjithatë, PBB-ja përshpejtoi ritmin e rikuperimit të saj në tremujorin e katërt të vitit 2020, duke qëndruar mbi nivelin e një viti më parë. Rritja ekonomike për T4-2020 rezultoi 3%, e mbështetur si nga sektori prodhues ashtu edhe nga ai i shërbimeve, të cilët kontribuan me përkatësisht 1.8 dhe 1.5 pikë për qindje.

Tabela 1: Produkti i Brendshëm Bruto

Produkti i Brendshëm Bruto (rritja vjetore ne %, në terma reale)	2019	2020
Maqedonia e Veriut	3.2	-4.5
Mali i Zi	4.1	-15.2
Serbia	4.2	-1.0
Turqia	0.9	1.8
Shqipëria	2.2	-3.3
Bosnja dhe Hercegovina	2.9	-4.5
Kosova	4.9	-3.9

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Në përputhje me rënien e aktivitetit ekonomik, rritja e vendeve të punës ishte negative në Ballkanin Perëndimor për vitin 2020. Rënia mesatare e punësimit në rajon qëndroi në 1.7%, krahasuar me një normë rritjeje prej 2.0% që ishte në vitin 2019. Pavarësisht nga humbjet e punësimit, rënia e njëkohshme e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, e kombinuar me masat e politikës për të mbrojtur vendet e punës, kufizoi rritjen e normave të papunësisë. Megjithatë, normat e papunësisë mbeten ende të larta, duke variuar nga 9% në Serbi në 24.6% në Kosovë.

Tabela 2: Norma e papunësisë

Norma e Papunësisë (mesatare vjetore, në %)	2019	2020
Maqedonia e Veriut	17.3	16.4
Mali i Zi	15.4	18.4
Serbia	10.4	9.0
Turqia	14.0	13.4
Shqipëria	12.0	12.2
Bosnja dhe Hercegovina	15.7	18.0
Kosova	25.7	24.6

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Zhvillimet negative në sektorin e jashtëm gjatë vitit 2020 u nxitën nga kolapsi i eksporteve të shërbimeve, në veçanti i turizmit, rënies së eksporteve të mallrave, si dhe rënies së të ardhurave nga remitancat në shumicën e vendeve të rajonit. Në të njëjtën kohë, importet gjithashtu ranë me një ritëm të shpejtë, i cili në disa vende tejkaloi ndikimin e rënies së eksporteve dhe remitancave. Deficitet e llogarisë korrente vazhduan të financohen kryesisht nga flukset hyrëse të IHD-ve, të cilat në lidhje me PBB-në u rritën në Mal të Zi, Kosovë dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, ndërsa ato ranë mesatarisht në të gjitha vendet e tjera të rajonit.

Tabela 3: Bilanci tregtar

Deficiti i llogarisë korrente (në % të PBB) ¹	2019	2020
Maqedonia e Veriut	-3.3	-3.5
Mali i Zi	-15.0	-26.0
Serbia	-6.9	-4.3
Turqia	0.9	-5.1
Shqipëria	-8.0	-8.9
Bosnja dhe Hercegovina	-3.0	-3.1
Kosova	-5.6	-7.1

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Dobësimi i dinamikës së inflacionit në Ballkanin Perëndimor gjatë muajve të parë të 2020, i shoqëruar nga lehtësimi monetar i shtuar nga bankat qendrore kryesore për shkak të pandemisë Covid-19, mundësoi vazhdimin e politikës monetare akomoduese në vendet me autonomi të politikës monetare.

Tabela 4: Norma e inflacionit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit/Inflacioni (ndryshimi vjetor në %)	2019	2020
Maqedonia e Veriut	0.8	1.2
Mali i Zi	0.5	-0.8
Serbia	1.8	1.6
Turqia	15.2	12.3
Shqipëria	1.4	1.6
Bosnja dhe Hercegovina	0.6	-1.1
Kosova	2.7	0.2

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

¹ Këto shifra i referohen një mesatare rrëshqitëse për 4 tremujorët

** Këto shifra i referohen balancës tremujore pjestuar me PBB vjetore të vlerësuar

*** Këto shifra i referohen balancës tremujore pjestuar me PBB tremujore

Në vitin 2020, rritja e shpenzimeve të lidhura me krizën e pandemisë, kombinuar gjithashtu me një rënie të madhe të të ardhurave rezultuan në një zgjerim të ndjeshëm të deficiteve fiskale për rajonin e Ballkanit Perëndimor, pavarësisht nga përpjekjet e disa vendeve për të krijuar hapësira fiskale duke shkurtuar shpenzimet kapitale.

Tabela 5: Bilanci fiskal

Bilanca e përgjithshme e qeverisë/Deficiti fiskal (në % të PBB)	2019	2020
Maqedonia e Veriut***	-2.2	-8.2
Mali i Zi**	-2.0	-11.0
Serbia***	-0.2	-8.1
Turqia***	-3.7	-4.5
Shqipëria**	-1.9	-6.9
Bosnja dhe Hercegovina***	1.9	N/A
Kosova	-2.9	N/A

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Borxhi i përgjithshëm i qeverisë u rrit në të gjitha vendet e rajonit gjatë vitit 2020, duke reflektuar rritjen e nevojave për financim dhe rënies së PBB-së nominale (me përjashtim të Serbisë). Në fund të vitit 2020, raporti i borxhit ishte më i larti në Malin e Zi (105% të PBB-së), ndjekur nga Shqipëria (76.1%) dhe Serbia (57.4%).

Tabela 6: Borxhi publik

Borxhi i përgjithshëm i qeverisë (në % të PBB)	2019	2020
Maqedonia e Veriut	40.7	51.2
Mali i Zi	76.5	105.1
Serbia	52.1	57.3
Turqia	32.6	39.5
Shqipëria	66.3	76.1
Bosnja dhe Hercegovina	32.2	N/A
Kosova	17.5	21.8

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

3. POLITIKAT FISKALE DHE REZULTATI I MBLEDHJES SË TË ARDHURAVE

3.1 Politika fiskale në vitin 2020 dhe efektet në buxhet e në ekonomi

Politika fiskale në vitin 2020 ka vijuar të synojë sigurimin e një sistemi taksimi të drejtë, të balancuar dhe që nxit produktivitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të ekonomisë. Ndryshimet në paketën fiskale 2020 synuan përgjithësisht korrektime në elementë të veçantë tatimesh dhe taksash, si tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi të ardhurat dhe taksat vendore. Qëllimi i paketës fiskale ka për objekt harmonizimin e dispozitave përkatëse të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar që lidhen me faturimin me përcaktimet e ligjit për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, thjeshtimin e procedurave dhe mbështetjen e biznesit dhe sektorëve të ndryshëm të ekonomisë me synim përbalimin e vështirësive të mëdha të shkaktuara nga pandemia globale COVID-19, si dhe të pasojave të shkaktuara nga tërmeti i Nëntorit 2019, duke synuar rritjen e konkurrueshmërisë dhe atë ekonomike.² Ndryshimet kryesore paraqiten si më poshtë:

² Shtojca 8.2 për një diskutim më të detajuar të efekteve të politikës fiskale.

3.1.1 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Ligji nr. 85/2019, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 92/2014 ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”, ka parashikuar disa furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja, siç janë:

- Furnizimi i automjeteve vetëm me motor elektrik, të reja, e që nuk janë regjistruar më parë për qarkullim në asnjë shtet tjetër.
- Furnizimi i procesit të ndërtimit nga ndërtuesit subjekte të rindërtimit, brenda Programit të rindërtimit, të autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, përgjatë periudhës së rindërtimit, sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës;
- Furnizimi i shërbimeve dhe mallrave i kryer direkt për ndërtuesit subjekte të rindërtimit, brenda Programit të rindërtimit, që përdoren prej tyre për procesin e ndërtimit për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, përgjatë periudhës së rindërtimit, sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës, të autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.
- Importimi i materialeve, pajisjeve dhe ndërtesave të parafabrikuara nga organet shtetërore, organizatat e bamirëse dhe filantropike për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, brenda programit të rindërtimit.
- Përjashtimi nga TVSH-ja i importimit të jahteve dhe mjeteve të tjera ujore që përdoren për qëllime turistike, kënaqësie dhe argëtimi, jo më të vjetra se 20 vjet, për të lehtësuar ndërtimin e një flote mjeteve lundruese relativisht të re dhe më miqësore me mjedisin, rritjen e flotës së mjeteve lundruese turistike, si dhe nxitjen e zhvillimit të infrastrukturës së marinave në funksion të zhvillimit të turizmit.
- Shkalla e reduktuar e TVSH-së prej 6% për furnizimin e shërbimit të punimeve të ndërtimit për investimet shtetërore të klubeve sportive/federatave sportive apo për investimet e subjekteve private në infrastrukturën sportive, u miratua me ligjin nr. 123/2020 dhe hyri në fuqi më 1 janar 2021. Trajtimi me shkallë të reduktuar i këtij furnizimi synon nxitjen dhe lehtësimin e investimeve në infrastrukturën sportive, me qëllim mbështetjen dhe rritjen e ndikimit pozitiv të sportit në shoqëri.

Nga 1 janari 2021, kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në u caktua qarkullimi vjetor prej 10 milionë lekë në një vit kalendarik (nga 2 milionë lekë/vit më parë).³ Si rezultat, në vendin tonë zbatohet një kufi minimal i regjistrimit për TVSH-në i unifikuar për të gjithë tatimpaguesit.

3.1.2 Tatimi mbi të Ardhurat

Gjatë vitit 2020, afatet e deklarimit dhe të pagesës së tatimit mbi fitimin në vitin 2020 u shtynë për të lehtësuar tatimpaguesit në kushtet e shtrëngesës financiare të shkaktuar nga mbyllja e ekonomisë për shkak të pandemisë.

Një ndryshim i rëndësishëm në normën e tatimit mbi të ardhurat u miratua gjatë vitit 2020. Nga 1 janari 2021 zerohet norma e tatimit mbi fitimin për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 000 000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë, për të stimuluar zhvillimin e biznesit të vogël.

³ VKM 576, datë 22.07.2020

3.1.3 Akciza

Legjislacioni në fushën e akcizave gjatë vitit 2020 nuk ka pësuar ndryshime, përjashtuar kalendarit për nivelin e akcizës së cigareve që përmbajnë duhan, niveli i të cilës u rrit nga 6000 lekë/1000 copë në vitin 2019, në 6250 lekë/1000 copë në vitin 2020.

3.1.4 Taksat Vendore

Ndryshimet ligjore të bëra gjatë vitit 2020 për taksat vendore synuan mbështetjen e subjekteve të prekura nga pandemia COVID-19, si dhe rehabilitimin e komuniteteve të prekura si pasojë e fatkeqësisë natyrore.


Konkretisht, investimet në kuadër të programeve të rindërtimit u përjashtuan nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas dispozitave të ligjit “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”. Po ashtu, bizneset të cilat ndërprejnë aktivitetin si pasojë e masave të marra për përballimin e COVID-19 përfituan nga shtyrja e afateve të kësteve të parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në vitin 2020. Po ashtu, në vitin 2020 u miratua zerimi i normës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për tatimpaguesit me të ardhura deri në 8 milionë lekë, me efekt nga 1 janari 2021.

Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, me synimin për t’u dhënë kohën e mjaftueshme të gjithë atyre individëve apo subjekteve tatimore që kanë interes ta kryejnë procesin e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme, afatit i aplikimit të ligjit nr. 90/2019 u zgjat deri më 31 dhjetor 2020.

3.2 Të ardhurat e përgjithshme


Të ardhurat totale të buxhetit të konsoliduar për periudhën 12-mujore 2020, arritën në 425.9 miliardë lekë, me një realizim në masën 95 për qind të planit vjetor sipas Aktit Normativ nr. 34, datë 16.12.2020 (të rishikuar). Të ardhurat totale rezultuan 16.4% më të ulëta se plani fillestar i vitit 2020 (510 miliardë lekë) dhe 5 për qind ose 20.6 miliardë lekë më pak se realizimi vjetor në vitin 2019. Rënia e kontributit të të ardhurave të buxhetit të shtetit për vitin 2020, krahasuar me vitin paraardhës është tregues i impaktit negativ nga kriza e shkaktuar nga Covid-19, çka detyroi mbylljen e aktiviteteve ekonomike në tremujorin e dytë. Pavarësisht hapjes graduale nga 3 mujori i tretë, efekti i tkurrjes ekonomike dhe uljes së kërkesës për konsum ishte i ndjeshëm, veçanërisht në sektorin e shërbimeve si dhe në turizëm dhe tregti. Po kështu, mbështetja shtetërore e biznesit për të lehtësuar barrën fiskale gjatë periudhës së pandemisë, nëpërmjet shtyrjes së kësteve të parapagesave të tatimit të biznesit të madh pati efekt negativ në hyrjet e vitit 2020.

Grafiku 2 Të Ardhurat e përgjithshme (në miliardë lekë) ndaj PBB-së



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Grafiku 3 Ecuria e zërave kryesorë të të ardhurave gjatë vitit 2020



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)


Zërat kryesorë në të ardhurat totale të buxhetit të shtetit janë ndihmat, të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të ardhurat e pushtetit vendor, të ardhurat nga fondet speciale dhe të ardhurat jotatimore; të cilat zënë përkatësisht 1.9 për qind, 65.5 për qind, 5.2 për qind, 22.9 për qind dhe 4.4 për qind të të ardhurave të përgjithshme publike në vitin 2020. Kontributin më të madh në rënien e të ardhurave totale e kanë dhënë të ardhurat tatimore, ndër të cilat peshën kryesore e zënë tatimi mbi vlerën e shtuar (21.3 miliardë lekë më pak se plani fillestar), për shkak të rënies së konsumit dhe tatimi mbi të ardhurat personale (13.8 miliardë lekë më pak se plani fillestar), për shkak të rënies në punësim dhe të ardhurave të tjera të lidhura me pagesat e interesave, dividendëve e të tjera personale.

Tabela 7 Treguesit e të ardhurave kryesore (në miliardë lekë)

	2016	2017	2018	2019	2019 (në % ndaj vitit paraardhës)	2020 (plan fillestar)	2020 (plan I rishiku ar)	2020 (fakt)	2020 (në % ndaj planit fillestar)	2020 (në % ndaj planit të rishiku ar)	2020 (në % ndaj vitit paraardhës)
Të ardhura nga ndihmat	14.6	11.1	8.2	10.6	129.9%	23.0	16.0	8.3	36.1%	51.8%	78.2%
Të ardhura tatimore	69.9	398.6	419.3	426.3	101.7%	465.1	410.0	398.7	85.7%	97.2%	93.5%
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	131.4	139.5	143.5	132.4	92.3%	151.6	130.8	130.4	86.0%	99.7%	98.4%
Tatimi mbi Fitimin	29.2	31.6	34.5	36.6	106.1%	38.0	30.4	28.4	74.7%	93.4%	77.6%
Akcizat	41.9	45.1	45.0	46.7	103.9%	50.5	45.3	44.5	88.2%	98.3%	95.2%
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	31.4	32.1	36.5	46.1	126.3%	47.5	41.1	33.7	70.9%	81.9%	73.0%
Taksa Nacionale dhe të tjera	35.8	38.5	38.7	36.4	94.2%	39.5	36.0	35.8	90.7%	99.5%	98.4%
Taksa Doganore	6.1	6.5	6.2	6.5	104.3%	7.0	6.5	6.2	89.2%	96.6%	96.3%
Të ardhura nga Pushteti Vendor	15.0	18.4	21.9	23.1	105.7%	26.9	23.0	22.0	81.6%	95.4%	95.1%
Të ardhura nga fondet speciale	79.2	86.8	93.2	98.4	105.6%	104.0	97.0	97.7	93.9%	100.7%	99.3%
Të ardhura jotatimore	22.5	20.7	22.4	23.5	104.7%	21.6	20.5	19.0	87.8%	92.3%	80.8%
TOTALI I TË ARDHURAVE	407	430	450	460	102.3%	510	447	426	83.6%	95.4%	92.5%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Grafiku 4 Të ardhurat e përgjithshme (në miliardë lekë), sipas kategorive kryesore



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

3.2.1 Të ardhurat nga ndihmat

Të ardhurat nga ndihmat për periudhën Janar-Dhjetor 2020 janë 8.3 miliardë lekë nga 10.6 miliardë lekë të një viti më parë, duke pësuar rënie në masën 21.8 për qind ose 2.3 miliardë lekë dhe me realizim ndaj planit në masën 51.8 për qind.


3.2.2 Të ardhurat tatimore

Të ardhurat tatimore, ku përfshihen të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të ardhurat nga pushteti lokal dhe të ardhurat nga fondet speciale, për periudhën 12-mujore arritën në vlerën 398.7 miliardë lekë, me një realizim ndaj planit vjetor të rishikuar në masën 97.2 për qind dhe me realizim kundrejt vitit të kaluar në masën 93.5 për qind ose 27.6 miliardë lekë më pak.

3.2.3 Të ardhurat nga pushteti vendor


Të ardhurat nga "Pushteti vendor" u realizuan në masën 22 miliardë lekë, rreth 18.4 për qind ose 5 miliardë lekë më pak se plani fillestar dhe 4.6 për qind ose 1 miliardë lekë më pak se të ardhurat sipas planit të rishikuar për vitin 2020. Kjo shënon edhe një rënie prej 1.1 miliardë lekë (4.9 për qind) më pak krahasuar me të ardhurat gjatë vitit 2019. Rënia e të ardhurave të pushtetit vendor ka ndodhur për shkak të një sërë faktorësh të lidhur me përkeqësimin e gjendjes financiare të bizneseve dhe të familjeve për shkak të pandemisë po edhe të tërmetit të vitit 2019 në disa bashki të mëdha; aplikimi i masave fiskale lehtësuese për kategoritë në nevojë si edhe zhvendosja në kohë e pagesave për detyrimet vendore. Megjithatë, rënia relative e të ardhurave nga pushteti vendor ishte më e ulët se të ardhurat e tjera: në vitin 2020, të ardhurat nga pushteti vendor përbënë 5.16 për qind të të ardhurave publike gjithsej, përkundrajt 5.02 për qind në vitin 2019. Tkurrja e të ardhurave është shënuar kryesisht nga ulja e arkëtimeve nga taksat mbi pasurinë e paluajtshme (1.6 për qind ose 84 milionë lekë më pak se një vit më parë) dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë (6.1 për qind ose 514 milionë lekë më pak se në 2019-ën), të cilat përbëjnë edhe burimet mbizotëruese të të ardhurave të veta vendore.

Grafiku 5 Të ardhura nga pushteti vendor në vite (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Grafiku 6 Përbërja e të ardhurave nga pushteti vendor sipas zërave kryesorë në 2020 (në %)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

3.2.4 Të ardhurat nga fondet speciale


Të ardhurat nga “Fondet Speciale” rezultuan 97.7 miliardë lekë, me një realizim ndaj planit të rishikuar në nivelin 100.7 për qind ose 0.7 miliardë lekë më shumë. Megjithatë, edhe të ardhurat nga fondet speciale shënuan një frenim të konsiderueshëm në kraasim me parashikimin në buxhetin fillestar të vitit 2020 prej 6.1 për qind, ose 6.3 miliardë lekë më pak dhe 0.7 miliardë lekë apo 0.7 për qind më pak sesa një vit më parë. Zërat që përbëjnë të ardhurat nga “Fondet Speciale” janë: Sigurimi Shoqëror, Sigurimi Shëndetësor dhe të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve, përkatësisht në vlerën 83.5 miliardë lekë, 13 miliardë lekë dhe 1.2 miliardë lekë.

Grafiku 7 Të ardhurat nga fondet speciale në vite (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Grafiku 8 Përbërja e të ardhurave nga fondet speciale (në %)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

3.2.5 Të ardhurat jotatimore

Të ardhurat jotatimore rezultojnë në vlerën 19 miliardë lekë krahasuar me 23.5 miliardë të një viti më parë, me një rënie vjetore prej 19.2 për qind ose 4.5 miliardë lekë më pak dhe me një realizim ndaj planit të rishikuar në masën 92.3 për qind ose 1.5 miliardë lekë më pak. Zërat që përbëjnë të ardhurat jotatimore janë: Transferimi i fitimit nga Banka e Shqipërisë; të ardhurat nga institucionet buxhetore, dividendii institucioneve me kapital shtetëror dhe tarifa shërbimesh dhe të tjera; të cilat kanë mbledhur përkatësisht 1.4 miliardë lekë, 11.9 miliardë lekë, 0.26 miliardë lekë dhe 1.6 miliardë lekë.

Grafiku 9 Përbërja e të ardhurave jostatimore (miliardë lekë)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

3.2.6 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat

Të ardhurat nga “Tatimet dhe Dogana”⁴ janë burimi kryesor i të ardhurave të përgjithshme dhe kontribuojnë në buxhetin e shtetit me rreth 17.3 për qind të PBB-së. Krahasuar me një vit më parë, ky zë shënon një performancë negative në vlerën 25.8 miliardë lekë ose 8.5 për qind më pak. Në krahasim me planin, realizimi ishte 96.2% e planit të rishikuar vjetor, duke rezultuar në 279 miliardë lekë, nga 290 miliardë lekë të planifikuara; por ishte ndjeshëm (16.6 për qind) më i ulët se plani në buxhetin fillestar.


Grafiku 10 Të ardhura nga tatimet dhe doganat në vite (në miliardë lekë) dhe në % të PBB-së



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

⁴ Nuk përfshihen të ardhurat nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Grafiku 11 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat sipas llojit



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Këto të ardhura, të cilat administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), përfshijnë Tatimin mbi vlerën e shtuar; Tatimin mbi fitimin; Tatimin mbi të ardhurat personale; Akcizat; Taksat doganore dhe Taksa të tjera kombëtare. DPT administron gjithashtu mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Burimet nga të gjitha të ardhurat e administruara nga DPT dhe DPD për vitin 2020, janë realizuar në vlerën 373.1 miliardë lekë, 6.5 për qind ose 25.9 miliardë lekë më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe në masën 97.5 për qind të planit vjetor të rishikuar. *Rezultati negativ* krahasuar me vitin e kaluar, është tregues i qartë i ndikimit negativ të pandemisë në ekonominë shqiptare, e reflektuar me tkurrjen e aktivitetit ekonomik, kërkesës së brendshme dhe të jashtme; si edhe uljen e numrit të të punësuarve dhe si rrjedhojë rënie e të ardhurave nga mbledhja e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Tabela 8 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat (në milionë lekë)


Lloji i taksave	Fakt 12 mujor 2019	Fakt 12 mujor 2020	Plan Fillestar 2020	Diferenca 2020/2019	Ndryshimi në % 2020/2019	Diferenca Fakt/Plan fillestar 2020	Ndryshimi në % Fakt/Plan Fillestar 2020	2020 (plani i rishikuar)	Diferenca Fakt/Plan i Rishikuar 2020	Ndryshimi në % Fakt/Plan i Rishikuar 2020
TVSH TOTAL	132,412	130,354	151,621	-2,058	-1.6%	-21,267	-14.03%	130,760	-406	-0.3%
<i>Tvsh në import</i>	107,160	100,850	113,721	-6,310	-5.9%	-12,871	-11.32%	101,100	-250	-0.2%
<i>Tvsh brenda vendit</i>	25,252	29,504	37,900	4,252	16.8%	-8,396	-22.15%	29,660	-156	-0.5%
<i>Rimbursim TVSH</i>	23,509	16,508	21,000	-7,001	-29.8%	-4,492	-21.39%	21,000	-4,492	-21.4%
Tatimi mbi fitimin	36,575	28,381	38,000	-8,194	-22.4%	-9,619	-25.31%	30,390	-2,009	-6.6%
Akciza	46,742	44,521	50,500	-2,221	-4.8%	-5,979	-11.84%	45,300	-779	-1.7%
Tatimi mbi të ardhurat personale	46,124	33,658	47,500	-12,466	-27.0%	-13,842	-29.14%	41,080	-7,422	-18.1%
Taksa nacionale dhe të tjera	36,424	35,829	39,500	-594	-1.6%	-3,671	-9.29%	36,010	-181	-0.5%
<i>Taksat nacionale</i>	33,789	34,034	36,600	245	0.7%	-2,566	-7.01%	33,450	584	1.7%
<i>Renta Minerare</i>	2,635	1,795	2,900	-839	-31.9%	-1,105	-38.09%	2,560	-765	-29.9%
Taksë Doganore	6,482	6,241	7,000	-240	-3.7%	-759	-10.84%	6,460	-219	-3.4%
TOTALI TATIME + DOGANA	304,758	278,985	334,121	-25,774	-8.5%	-55,136	-16.50%	290,000	-11,015	-3.8%
Kontributet e mbledhura (DPT)	94,248	94,121	99,455	-127	-0.1%	-5,334	-5.36%	92,834	1,287	1.4%

TOTALI (përfshirë kontributet)	TATIME +	DOGANA	399,006	373,106	433,576	-25,901	-6.5%	-60,470	-13.95%	382,834	-9,728	-2.5%
-----------------------------------	-------------	--------	---------	---------	---------	---------	-------	---------	---------	---------	--------	-------

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Të ardhurat nga **Administrata Doganore** për vitin 2020 arritën në 153.4 miliardë lekë, me një realizim në masën 98.7 për qind të planit të rishikuar, ose 2 miliardë lekë më pak. Në krahasim me vitin 2019, performanca ka qenë negative me rreth 9.6 miliardë lekë më pak sesa një vit më parë, me ulje 5.9 për qind. Krahasuar me vitin 2019, paraqiten me rënie Akciza (-4.8 për qind) dhe Taksa doganore (-3.7 për qind), Renta minerare (-31.9 për qind) dhe TVSH në import (-5.9 për qind). Krahasuar me planin, të gjithë zërat e të ardhurave doganore paraqiten me mosrealizim. Deficiti i krijuar me planin lidhet kryesisht me impaktin negativ të kursit të këmbimit mbi të ardhurat doganore, duke sjellë vlera më të ulëta të importit të taksuar, çka ka ndikuar në uljen e të ardhurave tatimore nga veprimtaria doganore.


Grafiku 12 Të ardhurat doganore, rënia vjetore sipas llojit të taksave 2020 - 2019 (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Të ardhurat nga **Administrata tatimore** (përfshirë kontributet) rezultojnë 219.7 miliardë lekë nga 236 miliardë lekë të një viti më parë, me një rënie vjetore prej 6.9 për qind ose 16.3 miliardë lekë më pak. Edhe të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të mbledhura nga DPT kanë pësuar një rënie të lehtë mbi baza vjetore, prej 127 milionë lekësh. Krahasuar me të dhënat e një viti më parë, pothuajse të gjitha llojet e të ardhurave tatimore kanë pasur një tendencë në tkurrje, në krahasim me buxhetin fillestar 2020 dhe realizimin e një viti më parë.


Grafiku 13 Të ardhurat tatimore, rënia vjetore sipas llojit të taksave (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Nga të dhënat për 12-mujorin 2020, lidhur me kontributin e sektorëve të ekonomisë në totalin e të ardhurave nga administrata tatimore rezulton se peshën kryesore e zë sektori i “Shërbimeve” dhe sektori i “Tregtisë”, përkatësisht 33.5 për qind dhe 29.5 për qind.

Grafiku 14 Të ardhurat tatimore, sipas sektorëve (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

3.3 Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera

3.3.1 Taksimi Indirekt

- Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH)


Të ardhurat nga T.V.SH qenë 130.4 miliardë lekë në vitin 2020, duke zënë sërish peshë të rëndësishme në të ardhurat buxhetore: 8.1 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto ose 32.7 për qind të totalit të të ardhurave tatimore. Pesa e të ardhurave nga TVSH ndaj të ardhurave tatimore gjithsej në 2020 mbetet në të njëjtat nivele me parashikimin në buxhetin fillestar, por në terma nominalë realizimi ka qenë 14% më i ulët se buxheti fillestar dhe 1.6 për qind ose 2 miliardë lekë më pak se realizimi në vitin paraardhës.

Të ardhurat e mbledhura nga TVSH në import u realizuan në nivelin 100.8 miliardë lekë, me një realizim në masën 99.8 për qind kundrejt planit të rishikuar dhe 94.1 për qind kundrejt vitit të kaluar. Për këtë periudhë, të ardhurat nga TVSH-ja në doganë përbëjnë rreth 77.4 për qind të të ardhurave totale nga TVSH-ja. Situata ekonomike e shkaktuar prej Covid-19 është reflektuar ndjeshëm në uljen e të ardhurave nga TVSH-ja. Në veçanti, performanca e të ardhurave nga TVSH në import u ndikua nga:

- ✓ Rënia e importeve të tatueshme me 7.2% kundrejt vitit paraardhës, me efekt negativ në të ardhura me vlerë -3.4 miliardë lekë.
- ✓ Rënia e çmimit të mallrave të importit për disa artikuj me peshë në performancën e TVSH-së, si ulja drastike e çmimit të karburanteve në tregjet ndërkombëtare krahasuar me vitin 2019, me peshë rreth 15% në strukturën e TVSH-së në import, duke dhënë efekt negativ prej 1.6 miliardë lekësh.

Të dhënat 12-mujore të vitit 2020, mbi shpërndarjen sektoriale të TVSh-së brenda vendit, tregojnë se, “Tregtia”, “Shërbimet” dhe “Prodhimi” kanë peshën kryesore në të ardhurat nga TVSH.


Grafiku 15 TVSH-ja brenda vendit, sipas sektorëve (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Të ardhurat e mbledhura nga TVSH brenda vendit (TVSH neto) janë 29.5 miliardë lekë, me rritje kundrejt vitit të kaluar në masën 16.8 për qind ose +4.25 miliardë lekë. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si rezultat i uljes së volumit të TVSH-së së rimbursuar për vitin 2020, e cila u realizua në vlerën 16.5 miliardë lekë, 29.8 për qind ose 7 miliardë lekë më pak se 12-mujori i vitit 2019. Grafiku më poshtë paraqet rimbursimin e TVSH-së në vitet 2010-2020 në milionë lekë.

Grafiku 16 Rimbursimi i TVSH-së në vite (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

- Akciza

Të ardhurat nga Akciza për periudhën Janar–Dhjetor 2020 arritën në rreth 44.5 miliardë lekë; ose 11.8 përqind më pak se plani në buxhetin fillestar dhe rreth 1.7 për qind ose 0.8 miliardë lekë më pak se plani i rishikuar. Në krahasim me vitin 2019, realizimi ishte 2.2 miliardë lekë apo 4.8 për qind më pak. Rënia në realizimin e të ardhurave nga akciza ka ardhur kryesisht si rezultat i kërkesës më të ulët për disa mallra kyç, përfshirë:

- ✓ *Importi i cigares ishte rreth 2,714 tonë, me një rënie prej 264 tonë ose – 8.9 për qind krahasuar me 12 mujorin e vitit 2019, me efekt negativ - 584 milionë lekë.*
- ✓ *Rënie e sasisë së karburantit të importuar, me 2.5 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, me efekt – 0.9 miliardë lekë.*

- ✓ Rënie e sasisë së karburantit të prodhuar në vend me 57.7 mijë tonë (-66.5%) krahasuar me një vit më parë, duke sjellë një efekt negativ në akcizë me -2.4 miliardë lekë


Ndërkohë, performancë pozitive si rezultat i rritjes në sasi kanë shënuar deklarimi i prodhimit vendas të duhanit, nga 29 tonë në 41 tonë të deklaruar në periudhën janar - dhjetor 2020, me rritje të sasisë + 40.9 për qind dhe efekt në të ardhura 41 milionë lekë, importi i gazit të lëngët + 8.9 për qind krahasuar me një vit më parë dhe efekt + 14 milionë lekë.

Tabela 9 Performanca e të ardhurave nga akciza: mallrat kryesorë 2020 - 2019

Mallrat e forta	Njësia e matjes	Janar - Dhjetor		Diferenca	
		2019	2020	në njësi fizike	në për qind
Cigare	Ton	2,978	2,714	-264	-8.9%
Birrë (import+prodhim vendi)	Ton	89,330	80,821	-8,509	-9.5%
Gaz i lenget	Ton	139,559	151,912	12,353	8.9%
Karburant (import+prodhim vendi)	Ton	606,907	562,022	-44,885	-7.4%


Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Grafiku 17 Akciza në vite (miliard lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Grafiku 18 Akciza sipas natyrës së mallrave (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

- Taksat doganore

Të ardhurat nga taksat doganore për periudhën Janar–Dhjetor 2020 janë rreth 6.2 miliardë lekë; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, të ardhurat nga kjo taksë janë ulur me 240 milionë lekë ose 3.7 për qind, si dhe realizim në masën 96.6 për qind e planit. Peshën më të madhe në taksën doganore e zënë produktet si cigaret (10%), mish importi (8.3%), fruta – perime (7.3%), veshjet e këmbës (7.2%). Faktori kryesor që ka ndikuar në këtë mosrealizim lidhet me rënien e volumit të importit si pasoje e situatës ekonomike shkaktuar nga Covid-19.

- Taksat nacionale

Të ardhurat nga taksat nacionale për periudhën janë realizuar në vlerën 34 miliardë lekë, me realizim ndaj planit të rishikuar në masën 101.7 për qind ose 0.6 miliardë lekë më shumë. Krahasuar me vitin e kaluar, të ardhurat nga taksat nacionale kanë pësuar rritje në masën 0.7 për qind apo 0.2 miliardë lekë.


3.3.2 Taksimi direkt

- Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga Tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 33.7 miliardë lekë për periudhën janar-dhjetor 2020, me rënie kundrejt vitit të kaluar në masën 27 për qind ose 12.5 miliardë lekë dhe me realizim ndaj planit fillestar në masën 70.9 për qind dhe ndaj planit të rishikuar 81.9 për qind ose 7.4 miliardë lekë më pak. Ndikimin kryesor në rënien kundrejt vitit të kaluar e ka sjellë tatimi mbi dividendin me 8.7 miliardë lekë më pak. Gjithashtu, rritje kanë pësuar të ardhurat nga të punësuarit në sektorin publik me + 127 milionë lekë, ndërkohë të ardhurat nga sektori privat kanë pësuar rënie me - 503 milionë lekë. Këto faktorë së bashku kanë ndikuar në rënien e derdhjes së tatimit mbi të ardhurat personale me efekt pozitiv - 375 milionë lekë krahasuar vitin fiskal 2019. Njëkohësisht, tatimi mbi të ardhurat nga interesat e depozitave është ulur me - 0.1 miliardë lekë dhe tatimi mbi të ardhurat nga


qiradhënia është ulur me - 0.22 miliardë lekë. Sipas burimit të të ardhurave individuale që taksohen, bazuar në të dhënat për 12-mujorin 2020, situata pasqyrohet në grafikun më poshtë:

Grafiku 19 TAP në vite (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Grafiku 20 TAP sipas zërave në vitin 2020 (në %)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

- Tatim Fitimi

Të ardhurat nga Tatimi mbi fitimin për 12-mujorin 2020 arritën në rreth 28.4 miliardë lekë nga 36.6 miliardë lekë të mbledhura një vit më parë, me një rënie prej 25 për qind krahasuar me planin fillestar dhe 6.6 për qind ose 2 miliardë lekë më pak përkundrajt të rishikuarit. Krahasuar me vitin paraardhës, performanca e të ardhurave nga tatim fitimi ishte 22.4 për qind ose 8.2 miliardë lekë më pak. Kjo rënie lidhet kryesisht me shtyrjen e afateve për pagesën e kësteve të tatimit mbi fitimin si pasojë e masave të marra nga qeveria në mbështetje të biznesit për


shkak të situatës së pandemisë. Sektori me rënie më të madhe në të ardhurat për tatimin mbi fitimin është ai i prodhimit.

Grafiku 21 Tatimi mbi fitimin në vite (në miliard lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Grafiku 22 Tatimi mbi fitimin sipas sektorëve në vitin 2020 (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

- Renta Minerare


Të ardhurat nga Renta Minerare në eksport janë realizuar në vlerën 1.8 miliardë lekë nga 2.6 miliardë lekë të mbledhura një vit më parë, me një rënie prej 31.9 për qind ose 0.8 miliardë lekë më pak, si dhe realizim kundrejt planit vjetor të rishikuar në masën 70.1 për qind. Të ardhurat nga renta minerare e naftës bruto ishin 1.4 miliardë lekë, 830 milionë ose 37.8% më pak se renta e vitit 2019; rënie e cila ka ardhur kryesisht si rezultat i rënies së çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare, me një efekt -647 milionë lekë; por edhe nga ulja e sasisë së eksportit të naftës bruto me efekt negativ prej -183 milionë lekë. Gjatë vitit 2020 pati ulje të rentës për njësi nga

3.42 lekë/ton në 2.32 lekë/ton naftë bruto. Ndërkohë, të ardhurat nga mineralet e eksportuara kanë pësuar rënie në masën 38 milionë lekë, për shkak të rënies së sasisë së mineraleve me 5.1%, me efekt 24 milionë lekë si dhe uljes së çmimit të mineraleve në tregjet ndërkombëtare me efekt –14 milionë lekë.

- Të ardhurat e fondeve speciale


Të ardhurat nga Fondet Speciale për periudhën Janar – Dhjetor 2020 arritën në 97.7 miliardë lekë, me një realizmin në masën 93.9 për qind ndaj planit fillestar dhe 101 për qind kundrejt atij të rishikuar. Këto të ardhura janë pothuajse në të njëjtat nivele si në vitin paraardhës (0.1 për qind ose 0.7 miliardë lekë më pak se në 2019). Ky grup të ardhurash përbën rreth 22.9 për qind të totalit të të ardhurave të përgjithshme për këtë periudhë. Nga totali i fondeve speciale, rreth 86.5 miliardë lekë janë kontribute të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe 1.2 miliardë lekë të ardhura për kompensimin në vlerë të pronarëve. Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur rreth 83.5 miliardë lekë, 0.7 miliardë lekë ose 0.9 për qind më pak sesa viti i kaluar dhe nga sigurimet shëndetësore janë mbledhur 13 miliardë lekë, 0.1 miliardë ose 0.8 për qind më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Grafiku 23 Kontribuesit aktivë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, sipas llojit të biznesit



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Grafiku 24 Kontribuesit aktivë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, sipas sektorit (në %)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Peshën më të madhe, për numër mesatar kontribuesish e zë biznesi i madh dhe ndërmarrjet shtetërore buxhetore, përkatësisht 35.3 për qind dhe 21 për qind. Gjatë viti 2020 numri i kontribuesve ka pësuar rënie në krahasim me një vit më parë në sektorin privat si pasojë e situatës ekonomike shkaktuar nga Covid-19. Duke e analizuar nga këndvështrimi i sektorëve të ekonomisë, peshën kryesore në kontribuesit aktivë e zënë punonjësit në sektorin e “Shërbimit” me 33%, “Tregtia” me 29% dhe “Prodhimi” me 22%. Krahasuar me vitin e kaluar, ky tregues ka pësuar këto ndryshime: sektori i “Prodhimit” është ulur me 9 për qind, sektori i “Shërbimit” është ulur me 7 për qind, sektori i “Tregtisë” është ulur me 4 për qind si dhe sektori “Transportit” është rritur me 1 për qind.

4. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME

Shpenzimet e përgjithshme publike për vitin 2020, arritën në rreth 536.5 miliardë lekë me një realizim në masën 97.7 për qind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 92.6 për qind të planit vjetor të ndryshuar sipas Aktit Normativ nr.34 datë 16.12.2020 (AN nr.34). Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 ky zë ka rezultuar 9.1 për qind më i lartë ose rreth 44.6 miliardë lekë më shumë.

Grafiku 25 Shpenzimet e përgjithshme korrente dhe kapitale (mld lekë) dhe ritmi i rritjes vjetore (në %)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

4.1 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike


Struktura e shpenzimeve gjatë vitit 2020 paraqet shumë ndryshime në krahasim me planin fillestar, për shkak të masave për përbalimin e krizës së pandemisë si edhe ecurisë së procesit të rindërtimit, të cilat sollën nevojën për disa rishikime të buxhetit.

Grafiku 26 Shpenzimet korrente dhe kapitale plan dhe fakt ndaj totalit të shpenzimeve 2020 (mld lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)


Grafiku 27 Struktura e shpenzimeve korrente, kapitale dhe raporti me PBB-në ndër vite



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)


Shpenzimet korrente për vitin 2020 rezultuan në rreth 421.37 miliardë lekë, ose 94.5 për qind të planit vjetor fillestar (95.3 për qind të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.34). Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shpenzimet korrente në vitin 2020 ishin rreth 4.5 miliardë lekë, ose 1.1 për qind më shumë. Kategoria kryesore që ka ndikuar në realizimin e shpenzimeve korrente ishin kryesisht shpenzimet sociale për shkak të pandemisë, të cilat arritën 116.7 për qind të planit vjetor fillestar (111.3 për qind të planit vjetor të ndryshuar sipas AN nr.34). Ndërkohë, shpenzimet për buxhetin vendor arritën 89.7 për qind të planit vjetor fillestar (96.9 për qind të planit vjetor të ndryshuar) dhe shpenzimet operative mirëmbajtje arritën 98.1 për qind të planit vjetor fillestar (95.4 për qind të planit vjetor të ndryshuar). Për rrjedhojë, shpenzimet korrente në vitin 2020 arritën në nivelin rreth 27 për qind të PBB-së, nga niveli rreth 24% në vitet paraardhëse.

Grafiku 28 Shpenzimet korrente dhe ritmi i rritjes së tyre (milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)


Grafiku 29 Struktura e shpenzimeve korrente (milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Shpenzimet e personelit, gjatë vitit 2020, përfaqësuan 18.2 për qind të totalit të shpenzimeve korrente. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 76.9 miliardë lekë, realizon nivelin e parashikuar për këtë zë në masën 92.4 për qind sipas planit vjetor fillestar dhe 94.8 për qind të planit vjetor të ndryshuar sipas AN nr.34. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, ky zë është 0.1 për qind më i ulët ose 67 milionë lekë më pak.


Grafiku 30 Shpenzimet e personelit në vite dhe ritmi i rritjes (miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet për Interesa për vitin 2020 kanë arritur në masën rreth 34.4 miliardë lekë duke përfaqësuar 8.2 për qind të shpenzimeve korrente. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 84 për qind të planit vjetor fillestar dhe 87.8 për qind të planit vjetor të ndryshuar sipas AN nr. 34. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, ky zë ka rezultuar 2.1 për qind më i ulët ose 749 milionë lekë më pak.


Grafiku 31 Shpenzimet për interesa në vite dhe ritmi i rritjes (miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet operative & mirëmbajtje për vitin 2020, kanë shënuar një realizim në masën 48.9 miliardë lekë ose 98.1 për qind të planit vjetor fillestar dhe 95.4 për qind të planit vjetor të ndryshuar sipas AN nr.34. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, ky zë ka rezultuar 3.6 për qind më i lartë, ose rreth 1.7 miliardë lekë më shumë.


Grafiku 32 Shpenzimet operative e të mirëmbajtjes dhe ritmi i rritjes vjetore (miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Shpenzimet për subvencione, në fund të vitit 2020, arritën nivelin rreth 1.48 miliardë lekë, me një realizim në masën 114.6 për qind të planit vjetor fillestar dhe 75.4 për qind të planit vjetor të ndryshuar sipas AN nr.34. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2019 shpenzimet për subvencione rezultojnë 4.1 për qind më të larta ose 58 milionë lekë më shumë.

Grafiku 33 Shpenzimet per subvencione dhe ritmi i rritjes (miliardë lekë)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Shpenzimet për Fondet Speciale, për vitin 2020, rezultuan në nivelin rreth 179.4 miliardë lekë, me një realizim prej 95.1 për qind të planit vjetor fillestar dhe 94.7 për qind të planit vjetor të ndryshuar sipas AN nr.34. Përkatësisht:

- ✓ Shpenzimet për sigurime shoqërore u realizuan në masën rreth 134.15 miliardë lekë, duke rezultuar me një realizim 97.6 për qind të planit vjetor fillestar ose 96.7 për qind të planit vjetor të ndryshuar sipas AN nr.34,
- ✓ Shpenzimet për sigurime shëndetësore në rreth 43.3 miliardë lekë, duke rezultuar 98.2 për qind të planit vjetor fillestar ose 94.7 për qind të planit vjetor të ndryshuar sipas AN nr.34,
- ✓ Shpenzimet për kompensimin e pronarëve në rreth 1.9 miliardë lekë, duke rezultuar 42.7 për qind të planit vjetor fillestar ose 66.3 për qind të planit vjetor të ndryshuar sipas AN nr.34.

Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2019, shpenzimet për sigurime shoqërore janë rreth 2.9 miliardë lekë më të larta, shpenzimet për sigurime shëndetësore janë 1.17 miliardë lekë më të larta dhe shpenzimet për kompensimin e pronarëve 348 milionë lekë më të ulëta.

Grafiku 34 Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)


Shpenzimet për Papunësinë për vitin 2020 janë realizuar në masën 888 milionë lekë, ose 48 për qind më të larta se plani fillestar, për shkak të rritjes së masës së përfitimit dhe zgjerimit të përfituesve në kuadrin e mbështetjes ndaj pandemisë. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2019 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 75.8 për qind ose 383 milionë lekë më shumë në terma nominalë.

Shpenzimet për Ndhimën ekonomike dhe Pagesën e paaftësisë (PAK) për vitin 2020 u realizuan në masën rreth 24 miliardë lekë duke rezultuar 114.3 për qind e planit vjetor fillestar dhe 109.1 për qind e planit vjetor të ndryshuar sipas AN nr.34, po ashtu lidhur me masat e ndihmës për kategoritë në nevojë. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2019 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 18.9 për qind ose rreth 3.8 miliardë lekë më shumë në terma nominalë.

Shpenzimet për kompensimin e ish-të përndjekurve politikë për vitin 2020 u realizuan në masën 1 miliard lekë duke rezultuar 100 për qind e planit vjetor fillestar dhe sipas AN nr.34. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2019 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rënie në masën 16.6 për qind ose 199 milionë lekë më pak në terma nominalë.

Shpenzimet për bonusin e lindjeve për vitin 2020 u realizuan në masën 2.82 miliardë lekë duke rezultuar 141 për qind e planit vjetor fillestar dhe sipas AN nr.34. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, shpenzimet për bonusin e lindjeve rezultojnë 19 për qind më të larta, ose 456 milionë lekë më shumë.


Grafiku 35 Shpenzimet per ndihmën ekonomike, PAK dhe papunësinë (miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Shpenzimet kapitale për vitin 2020 rezultuan në rreth 85.3 miliardë lekë, ose 104.5 për qind të planit vjetor fillestar (95.5 për qind të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.34). Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, ky zë është 13.8 për qind më i lartë ose rreth 10.3 miliard lekë më shumë. Ky mbirealizim erdhi si pasojë e ecuresë pozitive të projekteve të investimeve me financim të brendshëm, të cilat shënuan një realizim në masën rreth 59.5 miliardë lekë ose 116 për qind të planit vjetor fillestar dhe 98.2 për qind të planit vjetor të rishikuar. Po ashtu, investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë shënuan një realizim në masën 1.04 miliardë lekë ose 104 për qind në raport me planin vjetor fillestar (dhe AN nr.34); ndërsa financimi i huaj u realizua në masën rreth 24.7 miliardë lekë ose 84.3 për qind të planit vjetor fillestar dhe 89.3 për qind të planit vjetor të ndryshuar.

Grafiku 36 Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Fondet buxhetore të alokuara për investime kanë prekur fusha të rëndësishme të ekonomisë. Një prej prioriteteve të buxhetit 2020 për shpenzimet kapitale ishte rindërtimi i infrastrukturës së dëmtuar nga tërmeti i nëntorit të vitit 2019, kryesisht në fushën e arsimit, infrastrukturës publike dhe strehimit. Sektorë të tjerë prioritarë ishin edhe infrastruktura e ujësjellës kanalizimeve; shëndetësia, kultura, mbrojtja, etj. Realizimi i investimeve në total ka qenë në nivele të larta, veçanërisht për financimin e brendshëm. Pavarësisht realizimit më të lartë se plani fillestar, i cili lidhet ngushtë me procesin e rindërtimit, përbërja e shpenzimeve kapitale faktike paraqet diferenca në lidhje me planin fillestar, të shkaktuara kryesisht nga disa vonesa të procedurave të prokurimit, pjesërisht edhe prej situatës së pademisë, pavarësisht angazhimit nga institucionet buxhetore.

Me buxhetin e vitit 2020 janë **financuar dhe mbyllur rreth 369 kontrata investimesh me financim të brendshëm.**

Konkretisht:

- ✓ Janë mbyllur 15 kontrata investimi të transportit rrugor me vlerë totale rreth 6.1 miliardë lekë.
- ✓ Janë mbyllur 46 kontrata investimi për ujësjellësia dhe kanalizime me vlerë totale 2.1 miliardë lekë.
- ✓ Janë mbyllur 17 kontrata investimi për mbështetje për industrinë, transportin hekurudhor, transportin ajror, planifikimin urban me vlerë totale rreth 120 milionë lekë.
- ✓ Janë mbyllur 59 kontrata investimi për përmirësimin e kanaleve ujitëse në disa zona, ndërtimi i argjinaturave të lumenjve dhe mbrojtja prej tyre si edhe rikonstruksion i godinës dykatëshe të (ISUV), me vlerë totale 831 milionë lekë.
- ✓ Janë mbyllur 52 kontrata për rikonstruksione të ambienteve në disa spitale dhe poliklinika, blerje autoambulancash, furnizim dhe vendosje pajisjesh spitalore, projekt preventiva për rikonstruksione etj.
- ✓ Janë mbyllur 32 kontrata kontrata të rëndësishme për rikonstruksione/ndërtime të bazave prodhuese/pajisje dhe hartim projekt preventativash për disa shkolla profesionale në vend, ndërtime godinash në dogana dhe pagesa e biletë "Fiscalis 2020" në tatime, me vlerë totale rreth 1.1 miliardë lekë. Përsa i përket strehimit me buxhetin e vitit 2020 janë mbyllur 15 kontrata me vlerë totale 160.6 milionë lekë për rikonstruksionin e godinave (Shkodër, Rrogozhinë, Cerrik), dhe përmirësim i kushteve të banimit për komunitetin rom/egjiptian, bashkia (Devoll, Korçë, Kucovë, Kamëz, Roskovec, Librazhd, Përmet, Pogradec, Vlorë, Vau Dejës).
- ✓ Janë mbyllur 79 kontrata investimi për rikonstruksione/rindërtime/shtesa/ ambiente sportive të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në shumë bashki të vendit, me vlerë totale rreth 3.2 miliardë lekë
- ✓ Janë mbyllur 4 kontrata për Mjete transporti dhe Restaurimi i godinës së re Prefekturës Tiranë -Faza I etj. me vlerë totale rreth 488 milionë lekë.
- ✓ Janë mbyllur 13 kontrata investimi për sisteme armatimi, rikonstruksione e përmirësime infrastrukturës ushtarake të Forcave të Armatosura me vlerë totale rreth 1.8 miliardë lekë.
- ✓ Kanë përfunduar 13 projekte të rëndësishme në fushën kulturore me vlerë totale 1.8 miliardë lekë: Rikonstruksion dhe pajisje për TKOB, Muzealizim i Muzeut "Mësonjëtorja e pare shqipe", Restaurim kishash dhe hartim projektesh në fushën e Trashëgimisë Kulturore dhe Muzete
- ✓ Janë mbyllur 18 kontrata për programet e turizmit dhe mjedisit, me vlerë totale 440.7 milionë lekë.
- ✓ Janë mbyllur 21 kontrata me vlerë 743 milionë lekë për blerje pajisjesh të ndryshme për Institucionet e Sistemit të Drejtësisë, rikonstruksioni i ambienteve të zyrave të D.P.Burgjeve dhe qendra e trajnimeve dhe krijimi i sistemit Upgrade për zyrën e gjendjes gjyqësore.

4.2 Shpenzimet sipas natyrës funksionale

Sektori me peshën më të lartë në shpenzimet buxhetore është mbrojtja sociale, me 33 për qind të shpenzimeve të përgjithshme publike në vitin 2020, e dominuar nga shpenzimet për fondin e pensioneve si edhe programet në mbështetje të familjeve dhe individëve në nevojë (ndihma ekonomike dhe aftësia e kufizuar). Arsimi dhe shëndetësia përbëjnë 10 për qind të shpenzimeve të përgjithshme publike në vitin 2020. Çështjet ekonomike dhe strehimi dhe komoditetet e komunitetit (ku përfshihen infrastruktura rrugore, ujësjellës kanalizime, mbetjet urbane si dhe planifikimi urban) zënë përkatësisht 11 për qind dhe 10% të shpenzimeve të përgjithshme për vitin 2020. Shpenzimet e përgjithshme publike përbëjnë 16% të buxhetit për vitin 2020, përfshirë edhe pagesat e borxhit.

Tabela 10 Shpenzimet sipas funksionit (në milionë lekë)

		2020 (plan)	Plani në % ndaj totalit	2020 (fakt)	Fakti në % ndaj totalit	2020 (fakt i korrigjuar)**	Fakti i korrigjuar (në % ndaj totalit)	Fakti i korrigjuar (në % të planit)
1	Sherbimet e Përgjithshme Publike	38,713	7%	83,742	16%	35,508	8%	92%
2	Mbrojtja	15,800	3%	12,610	2%	12,610	3%	80%
3	Rendi dhe Siguria Publike	30,718	6%	32,336	6%	28,749	7%	94%
4	Cështjet Ekonomike	40,816	7%	60,423	11%	44,401	10%	109%
5	Mbrojtja e Mjedisit	1,197	0%	5,298	1%	1,336	0%	112%
6	Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit	28,903	5%	51,755	10%	33,540	8%	116%
7	Shendetësia	52,834	10%	51,590	10%	51,561	12%	98%
8	Argetimi, Kultura dhe Cështjet Fetare	3,419	1%	6,842	1%	4,304	1%	126%
9	Arsimi	45,055	8%	54,150	10%	43,731	10%	97%
10	Mbrojtja Sociale	163,595	30%	177,761	33%	176,382	41%	108%
	Të paklasifikuara*	128,324	23%		0%		0%	
	TOTALI	549,374	100%	536,508	100%	432,122	100%	79%

* Ne zërin "Shpenzime të tjera të paklasifikuara" (Totali) janë përfshirë: (i) pagesat për shërbimin e borxhit, (ii) kontigjenca për politika pagash dhe pensione, (iii) fondi rezervë, dhe (iv) shpenzimet e pushtetit vendor

** Vlerësim i përafërt, korrigjuar për interesat, shpenzimet e buxhetit vendor dhe rezervat

Plani fillestar i vitit 2020 kishte parashikuar po këto nivele, pak a shumë të ngjashme, të peshave relative të shpenzimeve sipas klasifikimit funksional, kundrejt një viti më parë. Në shmangien e vërejtur kundrejt rezultatit faktik 2020, ka ndikuar shpërndarja gjatë vitit 2020 e atyre shpenzime të paklasifikuara, të lidhura respektivisht me shërbimin e borxhit, shpenzimet e pushtetit vendor me fondin rezervë dhe fondin e rindërtimit. Këtu, një vend të konsiderueshëm zënë edhe rishpërndarjet dhe alokimet e fondeve në kuadër të financimit të masave anti-COVID19, të cilat kanë qenë në fokus të të katër Akteve Normative të buxhetit 2020. Në çdo rast, rezultati faktik i korrigjuar tregon nivele të kënaqshme të realizimit të planit sipas funksioneve për vitin 2020.

4.3 Ndryshimet në ligjin e buxhetit 2020

Gjatë vitit 2020, buxheti i shtetit u ndryshua me katër Akte Normative dhe më specifikisht:

✓ **Akti Normativ Nr.6 datë 21.03.2020 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”:**

Aspekti i nevojës dhe urgjencës së këtij akti normativ lidhej tërësisht me alokimin e fondeve të nevojshme buxhetore për përbalimin të situatës emergjente të krijuar nga Pandemia COVID-19, përmes financimit të sektorit të shëndetësisë për pajisje, medikamente, materiale mjekësore dhe shërbimet e tjera të nevojshme, si dhe financimin e paketave sociale, në kuadër të saj. Si rezultat i gjendjes së emergjencës shëndetësore, ky AN synoi:

- a) *Të reflektojë reduktimin në masën 20 miliardë lekë, të zërit “Të ardhura tatimore”, si pasojë e ngadalësimit të pritshëm në mbledhjen e tyre.*
- b) *Të reflektojë rritjen e shpenzimeve të përgjithshme, buxhetore në masën 9 miliardë lekë ku, përfshirë edhe rialokimet e brendshme, mbështetja financiare për masat Anti-Covid 19 arrin në 12 miliarde leke.*
- c) *Të reflektojë për rrjedhojë, rritjen e deficitit buxhetor në nivelin 68.7 miliarde leke, ose 3.9 përqind të PBB, nga përkatësisht 39.7 miliardë lekë ose 2.2% e PBB që ishin sipas buxhetit fillestar.*
- d) *Të reflektojë për rrjedhojë, rritjen e borxhit publik total në nivelin e pritur prej rreth 68.8% e PBB, nga 65.4% të PBB që pritej sipas buxhetit fillestar.*

Rritja e borxhit publik total të pritshëm si raport ndaj PBB në këtë Akt Normativ kundrejt buxhetit fillestar reflektoi (i) rritjen e deficitit buxhetor dhe huamarrjes totale neto; (ii) rritjen e stokut të pritshëm të borxhit të garantuar (përmendur më poshtë); dhe (iii) reduktimin e PBB nominale të parashikuar. Ndërkohë, ndryshe nga rregulli fiskal i përcaktuar në Ligjin Organik të Buxhetit për targetimin e një niveli të borxhit publik më të ulët se sa një vit më parë, devijimi i përkohshëm nga ky rregull fiskal në këtë Akt Normativ, ku borxhi publik i pritshëm për vitin 2020 prej rreth 68.8% e PBB është më i lartë se sa ai i vitit 2019 prej 65.9% të PBB, ishte në përputhje me një prej rasteve të rrethanave të jashtëzakonshme të përcaktuar në nenin 4/4, pika (a) të Ligjit Organik të Buxhetit (Ligji Nr.9936 datë 26.06.2008, i ndryshuar), rast në të cilin Qeveria mund të devijojë përkohësisht nga rregulli fiskal i sipërpërmendur.

Në terma konkretë dhe të detajuar, ky AN përcaktoi dhe synoi:

- ✓ *Të akordojë një fond prej 6.5 miliardë lekë në zërin e ri “Kontigjenca për paketën sociale anti-COVID”, e cila u përdor me VKM. Ky fond i dedikohet financimit të masave me karakter social që ndërmoi Qeveria, në funksion të lehtësimit dhe mbështetjes së punëmarrësve dhe/ose shtresave të tjera të prekura nga pezullimi i proceseve të punës në shkallë vendi, dhe konkretisht u lëvrua:*
 - *Për shtresat në nevojë*
 - *Për të papunët, si rrjedhojë e situatës aktuale*
 - *Për mbështetje të ndryshme të komuniteteve dhe sektorëve më të dëmtuar për shkak të situatës.*
- ✓ *Të akordojë një fond prej 2.5 miliardë lekë në programin “Shërbimet e kujdesit dytësor (spitalori)” të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që u përdor me VKM. Ky fond kishte për qëllim financimin e shpenzimeve, korrente dhe kapitale, të sektorit shëndetësor, për furnizimin me medikamente, aparatura dhe urgjenca të ndryshme dhe në mbështetje të stafeve mjekësore.*
- ✓ *Të rrisë me 1 miliard lekë Fondin Rezervë të buxhetit të shtetit, me qëllim krijimin e hapësirës për financimin e shpenzimeve të domosdoshme me karakter të paparashikuar, për vitin 2020.*

Është thelbësore të theksojmë që, situata emergjente e shkaktuar nga pandemia e virusit Covid-19 impaktoi veprimtarinë e operatorëve ekonomikë. Si rezultat i mbylljes së veprimtarisë së bizneseve në fushën e shërbimeve, turizmit, etj, reduktimit të theksuar të veprimtarisë prodhuese në jo pak sektorë, reduktimit të konsumit të karburanteve për shkak të kufizimeve në lëvizje, ishte e pritshme që të reduktoheshin edhe të ardhurat tatimore që gjeneroheshin nga këto veprimtari. Krahas mbylljes dhe reduktimit të veprimtarive prodhuese, të ardhurat tatimore u impaktuan në ulje edhe nga shtyrja e afateve ligjore të deklarimit të një sërë detyrimeve. Për pasojë, në atë kohë u parashikua që impakti negativ në të ardhura do të ishte -20 miliardë lekë, krahasuar me buxhetin fillestar 2020, reduktim ky që preku të gjitha zërat e të ardhurave tatimore.

Për sa i përket Pushtetit Vendor, u bënë disa rregullime të cilat krijuan mundësi të cilat krijuan mundësi që edhe qeverisja vendore të bëjë pjesë e mbështetjes së situatës së krijuar pas emergjencës COVID-19. Në kuadër të forcimit të disiplinës buxhetore, me qëllim që të rritet eficientia e përdorimit të fondeve publike dhe ato të përdoren për investime dhe shërbime publike, ky AN përcaktoi që fondet e mbartura nga vitet e mëparshme të përdoren nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas rregullave që përcaktohen nga ministri përgjegjës për financat.

Nderkohe, në paketën e masave për përballimin e situatës emergjente COVID-19, u përfshi edhe mbështetja për biznesin, në formën e instrumentit të Garancisë Sovrane në masën 11 miliardë lekë (100 milionë USD). Ajo shkoi si garanci për kompanitë që u gjenden përballë vështirësisë për pagesën e pagave të punonjësve gjatë atyre muajve. Kjo garanci për kredi afatshkurtra, kishte për qëllim të siguronte që çdo familje të ketë të ardhura të mjaftueshme për përballimin e situatës së vështirë.

Është me rëndësi të theksohet që pavarësisht se ndryshimet e propozuara prekën treguesit kryesorë makroekonomikë dhe fiskalë, nisur edhe nga eksperiencat botërore, u tregua një kujdes maksimal për t'i destinuar dhe orientuar burimet buxhetore drejt sektorëve më emergjentë.

✓ **Akti Normativ Nr.15 datë 15.04.2020 "Për disa ndryshime në Liqjin nr.88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020, i ndryshuar"**:

Aspekti i nevojës dhe emergjencës së këtij AN, lidhet me financimin e Paketës së dytë të masave anti-COVID19 të Qeverisë, dhe konkretisht:

- *Përmes një alokimi shpenzimesh në masën 7 miliardë lekë për këtë qëllim, e cila u përdor me VKM. Ky fond i dedikohet financimit të masave të reja me karakter social që ndërmori Qeveria, në funksion të lehtësimit dhe mbështetjes së punëmarrësve dhe/ose shtresave të tjera të prekura nga pezullimi i proceseve të punës në shkallë vendi, si për biznesin e madh ashtu edhe për pjesën e mbetur të biznesit të vogël.*
- *Përmes miratimit të një garancie sovrane në masën 15 miliardë lekë, e cila shkoi si garanci për kompanitë që u gjenden përballë vështirësive, jo vetëm për pagesën e pagave të punonjësve gjatë atyre muajve, por edhe në nivel kapitali apo likuiditeti në tërësi.*

Ndryshimet e propozuara nuk prekën deficitin buxhetor, duke treguar një kujdes maksimal për t'i destinuar dhe orientuar burimet buxhetore drejt sektorëve më emergjentë. Kjo, duke treguar kujdes maksimal për ecurinë e treguesve kryesorë makroekonomike, me objektiv primar përmirësimin e tyre gradual dhe ruajtjen e qendrueshmerisë fiskale.

✓ **Akti Normativ Nr.28 datë 02.07.2020 “Për disa ndryshime në Liqjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020, i ndryshuar”:**

Mbështetur në ecurinë e treguesve makro-fiskalë e buxhetorë përgjatë gjysmës së parë të vitit 2020, si pasojë e gjendjes së emergjencës shëndetësore, ky AN pati për synim:

- a) Të reflektojë një reduktim në masën -63.1 miliardë lekë të planit të arkëtimeve të të ardhurave buxhetore, kundrejt planit fillestar 2020, si rrjedhojë e impaktit negativ të pandemisë Covid-19, ku pjesën kryesore e zë reduktimi i të ardhurave tatimore me rreth -57 miliardë lekë.
- b) Të reflektojë një rritje të shpenzimeve buxhetore prej rreth 30.16 miliardë lekë, me synim kryesor injektimin me financim të sektorëve prioritarë të ekonomisë, specifikisht përmes investimeve publike.
- c) Të reflektojë rritjen e deficitit buxhetor, për rrjedhojë, në nivelin -132.9 miliardë lekë ose rreth 8.4% e PBB, nga përkatësisht 39.7 miliard lekë ose 2.2% e PBB që ishin sipas buxhetit fillestar dhe nga 68.7 miliardë lekë ose rreth 3.9% në rishikimin e parë sipas AN nr.6/2020.
- d) Të reflektojë për rrjedhojë, rritjen e borxhit publik total në nivelin e pritur prej rreth 80% të PBB, nga rreth 65% të PBB që pritej sipas buxhetit fillestar dhe nga rreth 69% e PBB në rishikimin e parë sipas AN nr.6/2020.

Rritja e borxhit publik total të pritshëm si raport ndaj PBB në këtë AN, kundrejt buxhetit fillestar reflektoi: (i) rritjen e deficitit buxhetor dhe huamarrjes totale neto; (ii) rritjen e stokut të pritshëm të borxhit të garantuar; dhe (iii) reduktimin e PBB nominale të parashikuar. Rritja vetëm si rrjedhojë e reduktimit të PBB nominale të parashikuar nga buxheti fillestar, ishte rreth 8 pikë përqindje. Ndërkohë, ndryshe nga rregulli fiskal i përcaktuar në Ligjin Organik të Buxhetit për targetimin e një niveli të borxhit publik më të ulët se sa një vit më parë, devijimi i përkohshëm nga ky rregull fiskal në këtë Akt Normativ, ku borxhi publik i pritshëm për vitin 2020 prej rreth 80% e PBB është më i lartë se sa ai i vitit 2019 prej 66% të PBB, ishte në përputhje me një prej rasteve të rrethanave të jashtëzakonshme, përcaktuar në Nenin 4/4, Pika (a) e Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 i ndryshuar, rast në të cilin Qeveria mund të devijojë përkohësisht nga rregulli fiskal i sipërpërmendur. Referuar alokimeve më të rëndësishme, ky AN përcaktonte kryesisht:

Në terma të shpenzimeve korrente:

- *Financimin shtesë në masën 900 milionë lekë të nevojës së NJVQV-ve për bonusin e qirasë sociale në kuadër të tërmetit të datës 26.11.2019, deri në fund të vitit 2020.*
- *Alokimin e fondit shtesë prej 400 milionë lekë për Skemën e Fermerëve, bazuar në tejkalimin e pritshmërive të MBZHR për aplikimet e vitit 2020.*
- *Rritjen me 200 milionë lekë të fondit të planifikuar për skemën e Papunësisë, si rrjedhojë e parashikimeve dhe pritshmërive deri në fund të vitit 2020.*

Në terma të shpenzimeve kapitale:

- *Alokimin e fondit në masën 4 miliardë lekë për shpenzime shpronësimi dhe shlyerje detyrimesh të prapambetura në sektorin e infrastrukturës.*
- *Financimin shtesë prej 1 miliardë lekë për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në shkallë vendi.*
- *Alokimin e fondit shtesë prej 3 miliardë lekë për FSHZH, për programe zhvillimi.*
- *Alokimin e fondit prej 2 miliardë lekë për projektin madhor të Unazës së Re të Tiranës.*
- *Financimin prej 500 milionë lekë te studim-projektimit të konvikteve nga Bashkia Tiranë.*
- *Akordimin e një fondi prej 573 milionë lekë për blerjen e pajisjeve e përshtatjen e godinës së SPAK.*
- *Alokimin e fondit shtesë prej 100 milionë lekë për projektet e kanaleve ujitëse/kulluese.*

- *Financimin prej 73 milionë lekë te studim-projektimit të aksit Sheshi Shqiponja-Bulevardi i ri.*

Përkeqësimi i përkohshëm i parametrave të financave publike ishte tërësisht rrjedhojë e dy goditjeve tepër të forta që mori vendi dhe ekonomia dhe imponohej nga domosdoshmëria që në rrethana të tilla të jashtëzakonshme të utilizohet funksioni stabilizues i buxhetit të shtetit, si instrument kryesor për të amortizuar një pjesë të efekteve të forta negative të shkatuara nga këto dy goditje. Ky përkeqësim i parametrave ishte dhe do të jetë i përkohshëm, pasi në periudhën afatmesme politika fiskale do të rikthehet qartësisht drejt objektivit të saj prioritar të konsolidimit të qëndrueshëm fiskal.

- ✓ **Akti Normativ Nr.34 datë 16.12.2020 “Për disa ndryshime në Liqjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020, i ndryshuar”:**

Mbështetur në vlerësimet me të fundit të situatës makro-fiskale për 11M, Qeveria ndërmori procesin e rishikimit të fundit të buxhetit 2020. Aspekti i nevojës dhe emergjencës së këtij AN, lidhej kryesisht me:

- Financimin e shpërblimit të fundvitit për kategorinë e pensionistëve prej 3.4 miliardë lekë, përkatësisht në masën 5 000 (pesë mijë) lekë për çdo pensionist. Ky shpërblim u përballua:*
 - *Në masën 1.7 miliardë lekë nga rritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore;*
 - *Në masën 1.7 miliardë lekë nga fondet e vetë ISSH, të buxhetuara për vitin 2020.*
- Shtesën e fondeve për financimin e skemës së Ndhmës ekonomike & Paaftësisë, në masën 1 miliard lekë, si rrjedhojë e specifikave të përdorimit të saj gjatë vitit 2020 të karakterizuar nga pasojat sociale të pandemisë Covid-19. Konkretisht:*
 - *Fondet për PAK u shtuan me rreth 816 milionë lekë*
 - *Fondet për NE u shtuan me rreth 184 milionë lekë.*

Ky akt normativ nuk preku parametrat kyç makro-fiskalë, siç janë deficitit buxhetor dhe borxhi publik, të cilët mbetën të pandryshuar.

4.4 Fondi Rezervë dhe Kontigjenca

Fondi Rezervë i buxhetit të shtetit 2020 i planifikuar për 1.7 miliardë lekë në buxhetin fillestar u rishikua dy herë gjatë vitit 2020 në kuadër të situatave të emergjencës që u desh të përballoheshin. Përkatësisht, Akti Normativ nr.6 datë 21.03.2020 e rriti fondin rezervë në 16.2 miliardë lekë dhe Akti Normativ nr.28 datë 2.07.2020 në 3.58 miliardë lekë ndër të cilat, 2.7 miliardë lekë për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe 13.5 miliardë lekë si kontigjencë për paketën sociale anti-Covid-19. Gjatë vitit 2020 fondi rezervë u përdor si mëposhtë:

- *Fondi Rezervë për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme, prej 2.7 miliardë lekë, është përdorur gjatë vitit 2020 për shpenzime të tjera korrente (shpenzime operative dhe transfertat të brendshme rreth 50 për qind); për investime publike (rreth 47 për qind) dhe për shpenzime personeli (rreth 3 për qind).*
- *Fondi Rezervë si kontigjencë për paketën sociale anti-Covid-19 i planifikuar, prej 13.5 miliardë lekë, është akorduar si ndihmë financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, si fond shtesë për ndihmën ekonomike e pagesën nga papunësia gjatë periudhës së*

fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19”, si edhe për të punësuarit aktuale dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e COVID-19 (rreth 99.6 për qind).

Në mënyrë të detajuar fondet e akorduara sipas VKM-ve, paraqiten në Aneksin ç “Tabela analitike e përdorimit të Fondit Rezervë 2020”.

Fondi i Rindërtimit 2020 i planifikuar në masën 32 miliardë lekë nga i cili, 29 miliardë leke në Shpenzimet e Buxhetit të Shtetit dhe 3 miliardë lekë nga Grantet, është përdorur me Vendime të Këshillit të Ministrave si më poshtë:

- Nga fondi i planifikuar si shpenzim buxhetor, prej 29 miliardë lekë, janë akorduar 25 766 256 mijë lekë ose 88.8% e tij, nga të cilat:
 - 405 970 mijë lekë, ose 1.4% e fondit të planifikuar janë akorduar per shpenzime korrente për Njësitë e Qeverisjes Qendrore.
 - 10 451 539 mijë lekë ose 36% e fondit të planifikuar janë akorduar shpenzime për investime për Njësitë e Qeverisjes Qendrore
 - 14 908 747 mije leke ose 51% e fondit të planifikuar janë akorduar si trasferte e pakushtëzuar për Njësitë e Qeverisjes Vendore.
- Nga fondet grante të parashikuara në rreth 3 miliardë lekë, janë shpërndarë në zbatim te Vendimeve të Këshillit të Ministrave rreth 2 311 738 mijë lekë ose 77% e tyre.

Në mënyrë të detajuar fondet e akorduara sipas VKM-ve, paraqiten në Aneksin ç/1 “Tabela analitike e përdorimit të Fondit të Rindërtimit 2020”.

Fondet buxhetore të akorduara për masat anti-COVID19 – Me Aktet Normative të miratuara gjatë vitit 2020, janë bërë ndryshime në fondet e planifikuara në ligjin e Buxhetit nr.88/2019 “Për Buxhetin e vitit 2020”, në zërin e Fondit Rezervë të buxhetit të shtetit, me qëllim përdorimin e tyre për përballimin e situatës së vështirë të krijuar si pasojë e Pandemisë Covid19. Këto ndryshime paraqiten si më poshtë vijon:

Me Aktin Normativ nr 6 date 21.03.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.88/2019 ‘Për buxhetin e vitit 2020’”, Fondi Rezerve u rishikua në masën 9.2 miliard lekë, ndërkohë që Neni 7 përcakton përdorimin e tij si më poshtë:

- 1700 milione leke për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme.
- 6 500 milione leke si kontigjencë per paketën sociale anti-Covid-19
- 1 000 milione leke per emergjenca te tjera në kuadër të masave anti-covid 19

Me Aktin Normativ nr.15 date 15.04.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.88/2019 ‘Për buxhetin e vitit 2020’”, te ndryshuar”, Fondi Rezerve u rishikua në masën 16.2 miliard leke, ndërkohë që neni 2 i tij përcakton përdorimin si më poshtë:

- 1700 milione leke për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme.
- 13 500 milionë lekë si kontigjencë për paketën sociale anti-Covid-19
- 1 000 milionë lekë per emergjenca te tjera në kuadër të masave anti-covid 19

Me Aktin Normativ nr.28 date 02.07.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 ‘Për buxhetin e vitit 2020’”, te ndryshuar”, përdorimi i Fondit Rezervë është përcaktuar si më poshtë:

- 2700 milione leke për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme.
- 13 500 milionë lekë si kontigjencë për paketën sociale anti-Covid-19

Përdorimi i fondeve rezervë të parashikuara për vitin 2020 pëkatësisht për “Kontigjenca për paketën sociale anti-Covid19” dhe për “Emergjenca te tjera në kuadër të masave anti-COVID19”, është bërë me Vendime të Këshillit të Ministrave.

Me anë të VKM nr.249 datë 27.03.2020 “Për detajimin dhe mënyrën e përdorimit të Fondit anti-COVID19”, është përcaktuar mënyra e përdorimit të fondit prej 2.5 miliardë lekë për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Fondi “Kontigjenca për paketën sociale anti-Covid19” i planifikuar në masën 13.5 miliardë lekë, është akorduar:

- Ne masën 12.3 miliardë lekë si ndihmë financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë,
- Në masën 1.031 miliardë lekë si fond shtesë për skemën e Ndhmës Ekonomike, dhe
- Në masën 118.344 milionë lekë si fond shtesë për skemën e Papunësisë.

Në mënyrë të përmbledhur fondet buxhetore të akorduara gjatë vitit 2020, në kuadër të masave Anti-COVID19 paraqiten si më poshtë:

○ Fondi Kontigjencë për Paketën Sociale Anti Covid 19	13,500 milionë lekë
○ Fondi Rezerve i Buxhetit të Shtetit (Emergjencia te tjera ne kuader te masave anticovid 19)	629.4 milionë lekë
○ Alokime me VKM ne MSHMS	2,500 milionë lekë
Gjithsej fonde buxhetore	16,629.4 milionë lekë
○ Garancia Sovrane I	11,000 milionë lekë
○ Garancia Sovrane II	15,000 milionë lekë
Gjithsej Garancia Sovrane	26,000 milionë lekë
Financimi në total	42.629 milionë lekë

Në mënyrë të detajuar fondet buxhetore të akorduara për masat anti-COVID19, paraqiten në paraqiten në Aneksin ç/2 “Tabela analitike e financimit për masat anti-COVID19”.

Fondi Kontigjencë për risqet e borxhit, i planifikuar në masën prej 4.1 miliardë lekë, rezultoi i papërdorur gjatë vitit 2020.⁵

4.5 Programi i Rindërtimit

Një paketë e veçantë ligjore që vijoi tërmetin shkatërrues të nëntorit 2019 përcaktoi rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve për menaxhimin e rindërtimit, si dhe mënyrën e financimit dhe procedurat përkatëse. Ministri i Shtetit për Rindërtim në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Shtetëror të Rindërtimit, u caktuan si autoriteti përgjegjës për propozimin dhe bashkërendimin e programit. Me Aktin Normativ 9 (datë 16.12.2019), u krijua dhe Fondi i Rindërtimit, i cili konsiston në:

- Një program të veçantë të buxhetit të shtetit, me të ardhura nga buxheti i shtetit dhe donatorë dhe
- Kontribute në natyrë nga donatorë

Buxheti fillestar⁶ caktoi 20 miliardë lekë për Fondin e rindërtimit; i përbërë nga grante në masën 7 miliardë lekë dhe shpenzime të buxhetit të shtetit në masën 13 miliardë lekë. Ky buxhet u rishikua në rritje në korrik 2020 (AN 28/2020), duke arritur në 34 miliardë lekë, prej të cilave 3 miliardë lekë parashikoheshin financime nga grantet. Një rishikim i fundit në dhjetor 2020 pakësoi fondet nga shpenzimet e buxhetit të shtetit në masën 29 miliardë

⁵ Shih raportin e posaçëm për Fondin rezervë dhe të kontigjencës për më shumë detaje.

⁶ Ligji nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”

lekë, dhe Fondi i Rindërtimit arriti në 32 miliardë lekë. Financimet e parashikuara për Fondin e Rindërtimit në 2021 arrijnë në 28 miliardë lekë dhe ky program pritet të përmbillet deri në vitin 2022. Fondi i Rindërtimit shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi, si dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore në përputhje me vendimet përkatëse.

Detajimi i Fondit të Rindërtimit u krye në përputhje me ecurinë e procedurave të ndërlikuara të identifikimit dhe vlerësimit të dëmeve; verifikimit të kërkesave për dëmshpërblime dhe projektimit e zbatimit të investimeve publike. Sipas planit, Fondi i Rindërtimit do të financonte:

- 5.7 miliardë lekë në sektorin e arsimit (rreth 160 objekte arsimore)
- 6.8 miliardë lekë në sektorin e strehimit (rreth 4,500 shtëpi individuale dhe 11,000 apartamente)
- 10.7 miliardë lekë grante rindërtimi
- 1.9 miliardë lekë infrastrukturë publike (rreth 28 objekte)

Gjatë vitit 2020, në zbatim të Vendimeve të Këshillit të Ministrave, për procesin e rindërtimit janë akorduar fonde si më poshtë:

- Nga fondi i planifikuar prej 29 miliardë lekësh nga Shpenzimet e buxhetit, janë akorduar 25 766 256 mijë lekë. Nga këto:
 - 405 970 mijë lekë, janë akorduar për shpenzime korrente për Njësitë e Qeverisjes Qendrore.
 - 10 451 539 mijë lekë janë akorduar shpenzime për investime për Njësitë e Qeverisjes Qendrore
 - 14 908 747 mijë leke janë akorduar si transferte e pakushtëzuar për Njësitë e Qeverisjes Vendore.
- Nga fondet grante të parashikuara prej 3 miliardë lekësh janë shpërndarë në zbatim te VKM-ve rreth 2 311 738 mijë lekë .

Deri në 31 dhjetor 2020, nga Fondi i Rindërtimit u akorduan fonde në projekte specifike në masën 28.1 miliardë lekë. Nga këto, u shpenzuan nga njësitë zbatuese 15.3 miliardë lekë, ose 54.3% e fondeve të akorduara; ndërsa pjesa tjetër është mbartur në buxhetin e vitit 2021 në formën e transfertës së pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore dhe për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në përputhje me parashikimet e veçanta ligjore.

45.8% e fondeve të rindërtimit u shpenzuan nga njësitë e qeverisjes qendrore:

- Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FZSH) shpenzoi 6.4 miliardë lekë (nga 9.9 miliardë të akorduara) për rindërtimin e 1,978 shtëpive individuale (nga 2,500 të planifikuara në të gjitha vitet); 2,918 apartamenteve (nga 4,500 plan); përfundimin e rindërtimit/rikonstruksionit të 29 nga 37 objektet shkollore e planifikuara gjithsej; si dhe punime në katër nga nëntë zona të infrastrukturës publike.
- Agjenci të tjera qendrore shpenzuan 622 milionë lekë (nga 1 miliard i akorduar); për hartimin e planeve të zhvillimit të territorit (AKPT – 89.5 milionë); identifikimin dhe vlerësimin e dëmeve (Instituti i Ndërtimit, 160 milionë); akomodimi i përkohshëm i të pastrehëve në struktura hoteliere (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, 152 milionë); restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore dhe sondazhe arkeologjike në zonat e reja të zhvillimit (IKTK, 190 milionë); etj.

54.2% e fondeve u shpenzuan nga njësitë e qeverisjes vendore:

- Bashkia Tiranë shpenzoi 2.2 miliardë lekë (nga 11 miliardë të akorduara), për hartimin e projekteve dhe planeve të zhvillimit për zonat e reja; identifikimin dhe vlerësimin e dëmeve në territorin e saj, ndërtimin e objekteve shkollore; infrastrukturës publike dhe shtëpive individuale; si dhe grantet e rindërtimit.
- 11 bashkitë (përfshirë Tiranën) paguan rreth 7.25 miliardë lekë si grante rindërtimi për familjet e prekura nga tërmeti, nga 10.3 miliardë të miratuara. Rreth 44% e këtyre fondeve janë miratuar në bashkinë Durrës

(lëvruar 3.6 miliardë nga 4.6 miliardë të akorduara); ndjekur nga Tirana (1 miliardë lëvruar nga 1.2 miliardë akorduar) dhe Shijaku (0.7 miliardë lëvruar nga 1.3 miliardë miratuar). Deri në janar 2021, u paguan rreth 28,000 grante rikonstruksioni, nga mbi 33,000 të miratuara. Procesi i shqyrtimit dhe verifikimit të kërkesave vijon edhe në vitin 2021.

Në dhjetor 2020, 13,325 familje ishin akomoduan në apartamente me qira të subvencionuar nga shteti; ndërkohë që disa qindrave iu dorëzuan banesat e reja. Vetëm 680 familje ishin ende në tenda në dhjetor 2020, kryesisht për arsye private, nga 12,000 familje në tenda në dhjetor 2019.

Në mënyrë të detajuar fondet e akorduara sipas VKM-ve, paraqiten në Raportin ç/1 dhe Aneksin respektiv “Përdorimet e Fondit të Rindërtimit për vitin 2020”.

Kontributet e donatorëve

Në Konferencën e Donatorëve në Bruksel më 17 shkurt 2020 u premtuan 1.15 miliardë Euro fonde për rindërtimin dhe rimëkëmbjen pas tërmetit; ndër të cilat 295.73 milionë Euro ishin grante, 853 milionë Euro hua dhe 3.42 milionë Euro kontribute në natyrë.

Deri në dhjetor 2020, 94% e granteve (277 milionë Euro) dhe 11% e huave (90 milionë Euro) u finalizuan në marrëveshje konkrete; ndërsa 1.1 milionë Euro grante dhe 160 milionë Euro hua ishin në process negocimi. Disa donatorë po i zbatojnë kontributet nëpërmjet sistemeve të tyre; në bashkërendim me Qeverinë shqiptare, përfshirë donatorët më të mëdhenj si BE (115 milionë Euro); Emiratet e Bashkuara Arabe (75 milionë USD) dhe Turqia (44.8 milionë Euro). Disa donatorë kanë zgjedhur të përdorin sistemet e shtetit shqiptar, si Gjermania nëpërmjet KfE-së (11 milionë Euro); Zvicra, e cila ka kaluar një pjesë të kontributit të saj prej 9.5 milionë Euro nëpërmjet Fondit të Rindërtimit, si edhe Republika Çeke dhe Sllovakia. Donatorët vendas kanë akorduar 12.2 milionë Euro për rindërtimin, kryesisht nëpërmjet Fondit të Rindërtimit. Sektorët kryesorë që përfitojnë nga grantet e donatorëve ndërkombëtarë janë strehimi (39%); arsimit (35%) dhe infrastruktura publike, përfshirë kulturën (20%).

4.6 Politikat sociale dhe ekonomike në kuadër të masave anti-COVID19

Tërmeti i nëntorit 2019 dhe pandemia Covid-19 ndikuan në ecurinë ekonomike të vendit, me pasoja që mund të ndjehen për një kohë të gjatë. Në fillim të vitit 2020, kur vendi nisi procesin e rindërtimit, pandemia Covid-19 filloi të përhapej në rang global. Në mars 2020 u konfirmuan rastet e para të infektimit në Shqipëri dhe për të ngadalësuar përhapjen e sëmundjes vendi u detyrua të ndërmernte masa të paprecedente: kufizime të rrepta për udhëtimet vendase dhe ndërkombëtare; si dhe mbylljen e detyrueshme të hapësirave të grumbullimeve publike si shkollat dhe restorantet. PO ashtu, veprimtaria në fusha kyç të ekonomisë u kufizua, përfshirë industrinë e turizmit, muzetë, teatrot dhe çdo njësi e tregtisë jothelbësore; ndërkohë që sektorë të tjerë si industria tekstile, call-center-at, ndërtimi, minierat, etj. Ngadalësuan prodhimin për t’u përshtatur me masat e distancimit social; por edhe si përgjigje e kërkesës më të ulët për eksporte.

Pandemia COVID19 e rriti ekspozimin e vendit ndaj rreziqeve fiskale dhe të tregtisë së jashtme; ndërkohë që vlerësohet se ka shkaktuar një rritje të varfërisë. Shpenzimet për shëndetësinë, papunësinë dhe përfitimet sociale u rritën; çka kombinuar me uljen e të ardhurave tatimore solli një rritje të deficitit fiskal, por arritën të zbusin efektin e krizës dhe të përmbajnë efektet e saj në punësim, ekonomi dhe varfëri.

Paketa financiare anti-COVID19 – Në kuadër të pandemisë COVID19 u ndërmorën një sërë masash për të mbështetur ekonominë gjatë krizës, të cilat synuan i) rritjen e transfertave sociale për familjet e varfra; të papunët ii) mbështetje për punësimin dhe për rimëkëmbjen e aktivitetit ekonomik përfshirë mbështetje për bizneset e vogla, të mesme dhe të mëdha dhe iii) mbështetje për sektorin e shëndetësisë. Këto paketa kushtuan rreth 43 miliardë lekë, ose 2.8% e PBB-së në vitin 2020. Paketa e parë përmbante financim për shëndetësinë, mbështetje për punëmarrësit në biznese të vogla, të vetëpunësuarit, të papunët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike; si edhe ndihmë humanitare për individët dhe familjet në nevojë. Paketa e dytë përmbante një mbështetje financiare për një kategori të gjerë punëmarrësish në sektorët dhe bizneset e ndikuara nga pandemia. Gjithashtu, qeveria miratoi dy instrumente të garancisë sovrane për të mbështetur nevojat për likuiditet për të paguar punëmarrësit; si edhe për kapital qarkullues dhe investime. Deri në dhjetor 2020, vlera e kombinuar e masave sociale për mbrojtjen e punësimin dhe të kategorive në nevojë arriti në 13.1 miliardë lekë, nga 13.4 miliardë lekë të parashikuara.

4.6.1 Mbështetje për shëndetësinë

Qeveria shqiptare akordoi për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale një buxhet të dedikuar të menaxhimit të epidemisë në forcimin e sistemit shëndetësor në vlerën 2.5 miliardë lekë nga buxheti i shtetit për vitin 2020, për të përballuar shpenzimet shtesë të nevojshme në sistemin shëndetësor për blerje pajisjesh mbrojtëse; pajisjesh mjekësore, autoambulanca, përmirësime në infrastrukturën spitalore si dhe bonus për mjekët dhe personelin shëndetësor. Kësaj shume i shtohen edhe rreth 507 milionë lekë ndihma kryesisht nga organizata ndërkombëtare në pajisje mjekësore, materiale mbrojtëse dhe medikamente. Gjatë vitit 2020 sistemi shëndetësor arriti të menaxhojë përballjen me COVID – 19 falë punës së ekipit mjekësor dhe investimeve të kryera nga qeveria dhe bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë. Në vitin 2020 nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u krye gjithashtu pagesa prej 430 milionë lekë për kuotën në bazë të marrëveshjes me COVAX.

COVID19 u përfshi në listën e sëmundjeve ngjitëse në shkurt 2020, duke rregulluar procedurat për përfitimin e lejes së paguar mjekësore nga sigurimet shoqërore për punëmarrësit e karantinuar. Në nëntor 2020 u miratua paketa e rimbursimit të barnave për trajtimin e sëmundjes nga Covid-19, e cila përballohet nga buxheti i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor. Për efekt të trajtimit të kësaj sëmundjeje, të gjithë rezidentët konsiderohen përfitues nga skema e sigurimeve shëndetësore.

4.6.2 Mbështetje sociale për familjet në nevojë

Gjatë vitit 2020, programi i ndihmës ekonomike u zgjerua për të mbështetur me ndihmë ekonomike shtesë (dyfish) familjet që ishin përfituese në prill 2021, për një periudhë tremujore gjatë karantinës. Po ashtu, familje që kishin aplikuar, por nuk ishin kualifikuar për programin e ndihmës ekonomike përfituan secila një pagesë prej 16,000 lekë. Si rezultat, shpenzimet për ndihmën ekonomike u rritën me 24%, ose rreth 1 miliard lekë dhe kostoja për njësi e programit u rrit gjithashtu me rreth 23%. Më hollësisht, përfituan:

- 66,650 familje dhe individë në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike për rreth 5.4 miliardë lekë
- 7,850 familje të tjera iu shtuan skemës për këtë periudhë (me një pagesë)
- 168,243 persona me aftësi të kufizuar dhe kujdestarë përfitues nga programi i aftësisë së kufizuar, për rreth 18.5 miliardë lekë ose rreth 2 miliardë lekë më shumë
- Shërbime të përkujdesit social të ofruara në qendrat rezidenciale publike, është realizuar me një kosto faktike prej rreth 871 milionë lekë për 824 persona, për shërbimet thelbësore të cilat vijuan funksionimin edhe gjatë karantinës.

4.6.3 Mbështetje për punësimin dhe bizneset

Buxheti i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë u rishikua në rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2020, si një nga institucionet kyç që administroi masat shtetërore në ndihmë të biznesit dhe tregut të punës për përbalimin e pasojave të pandemisë Covid-19. Masat në ndihmë të punëmarrësve dhe bizneseve, në ngjasim me vende të tjera të Europës e më tej, synuan drejt garantimit të një niveli minimal të ardhurash dhe ruajtjes së punësimit. Fondet për masat në ndihmë të punësimit u rritën me rreth 12.7 miliardë lekë. Një nga rezultatet kryesore të arritura nëpërmjet këtij programi ishte mbështetja për biznesin në kushtet e mbylljes ekonomike gjatë karantinës së Covid-19 (VKM 254, 284, 305/2020), ku u paguan gjithsej 12.05 miliardë lekë (ose 98% e fondeve të parashikuara) për 243,500 biznese dhe individë të prekur nga pandemia:

- Në kompanitë me qarkullim vjetor deri në 14 milionë lekë:
 - 65,574 punonjës dhe të vetëpunësuar në ndërmarrje të mbyllura nga masat anti-Covid morën paga minimale 26,000 lekë për tre muaj në 38,994 subjekte, për 5.1 miliardë lekë
 - 68,391 përfitues në 31,746 ndërmarrje të lejuara të operojnë në kushte të pazakonta, morën një pagesë 40,000 lekë; për një total prej 2.73 miliardë lekë
- Ndërmarrjet me qarkullim mbi 14 milionë lekë në vit, të mbyllura prej masave anti-Covid (821 ndërmarrje): 9,435 individë morën një pagesë prej 40,000 lekë, për një total prej 377 milionë lekësh
- Punonjësit e larguar nga puna në ndërmarrjet e lejuara të operojnë: 65,666 ish-punëmarrës në 10,476 ndërmarrje morën një pagesë 40,000 lekë për një total prej 2.63 miliardë lekë
- Punëmarrësit në ndërmarrjet e hotelierisë: 4,927 përfitues në 1,106 ndërmarrje morën pagese 40,000 lekë për një total prej 197 milionë lekë
- 721 punonjës në rafinerinë e Ballshit dhe 28,379 punëmarrës në ndërmarrje të tjera (pas ankimimit) morën pagesa për një total prej 984 milionë lekë.
- 4,553 punonjës në sektorin e transportit në 714 ndërmarrje morën një pagesë prej 26,000 lekë, për një total prej 118 milionë lekë
- 23,320 përfitues në 457 ndërmarrje të cilat përfituan mbështetje financiare për zbatimin e masave dhe protokolleve anti-Covid, për një kosto prej 118 milionë lekë.
- Pagesa e papunësisë: përfitues të pagesës së papunësisë përfituan nga dyfishimi i mbështetjes gjatë periudhës prill – qershor 2020, 6,157 pagesa, për një kosto prej 170 milionë lekë

4.6.4 Masat për nxitjen e punësimit

Një program i ri për nxitjen e punësimit u miratua në shtator 2020, për të mbështetur punësimin e punëmarrësve të larguar nga puna për shkak të Covid19 nëpërmjet mbulimit të pagës minimale për 4 muaj dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore për 8 muaj të tjerë, me një kosto prej 200 milionë lekë shtesë (në 2020 dhe 2021); krahas një programi për mbështetjen e formalizimit të punëmarrësve informalë (44 mln lekë në 2020). Nga shtatori 2020 deri në fund të vitit rreth 1,650 punonjës u punësuan nëpërmjet këtij programi, mes të cilëve 560 ishin informalë.

4.6.5 Stimuli për ekonominë: Garancia sovrane

Qeveria miratoi instrumentin e garancisë sovrane për të mbështetur nevojat për likuiditet të subjekteve të cilat kishin pezulluar apo ngadalësuar aktivitetin për shkak të situatës së pandemisë.

Garancia e parë sovrane, në masën 11 miliardë lekë, shtrihej për të siguruar lëvrimin e huave për ndërmarrjet të cilat hasnin vështirësi në pagesën e pagave të punëmarrësve. Marrëveshja u lidh me dymbëdhjetë banka të nivelit të dytë dhe përfshin subvencionimin e interesave nga qeveria shqiptare dhe periudhë pa shlyerje të principalit (grace) deri në tre muaj. Deri në dhjetor 2020, u miratuan hua të garantuara në masën 5.9 miliardë lekë dhe u

lëvruan hua në masën 5.33 miliardë lekë për 492 ndërmarrje, kryesisht në prodhim (44%); tregti (17%); shërbime (14%); ndërtim (8%) dhe shëndetësi (7%).

Garancia e dytë sovraane u miratua në masën 15 miliardë lekë për të siguruar likuiditete për kapital qarkullues dhe investime në të gjithë sektorët e ekonomisë. Ky instrument mbulon një përqindje të principalit të çdo huaje me afate preferenciale financimi dhe afat shlyerjeje deri në pesë vjet dhe periudhe faljeje prej gjashtë muajsh. Deri në dhjetor 2020, u miratuan hua të garantuara në masën 8.95 miliardë lekë dhe u lëvruan hua në masën 8.33 miliardë lekë për 318 ndërmarrje, kryesisht në tregti (51%); shërbime (21%); ndërtim (14%) dhe prodhim (11%).

4.6.6 Lehtësimet fiskale

Një sërë masash të lehtësimit fiskal u miratuan gjithashtu gjatë vitit 2020, për të lehtësuar barrën fiskale të bizneseve dhe individëve:

- Përrjashtimi nga detyrimi për këstet e parapagimit të tatim fitimit
 - *Tatimpaguesit me qarkullim deri në 14 milionë lekë, u përjashtuan nga detyrimi për pëapagimin e kësteve të tatim fitimit të vitit 2020, që duhet të paguheshin deri në dhjetor 2020. Këto detyrime u paguan deri në mars 2021.*
 - *Tatimpaguesit me qarkullim mbi 14 milionë lekë u përjashtuan nga detyrimi për parapagimin e kësteve të tatim fitimit për periudhën prill – dhjetor 2020, të cilat u shtynë për periudhën pasardhëse. Ky lehtësim nuk aplikohet për ndërmarrjet në sektorët e telekomunikacioneve, farmaceutikës, produkteve ushqimore dhe fruta-perimeve.*
 - *Parapagimet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël gjithashtu u anuluan për vitin 2020.*
- Përrjashtimi nga taksa e ndikimit në infrastrukturë u miratua për subjektet në kuadrin e programit të rindërtimit në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.
- Vetëdeklarimi i tatimit të të ardhurave personale për vitin fiskal 2019 dhe afati për pagesat përkatëse u shtynë deri në 31 korrik 2020.

Njësitë e qeverisjes vendore bënë përjashtime të tjera, sipas rastit, të kategorive të veçanta në nevojë nga detyrimi për disa taksa e tarifa vendore.


5. BUXHETI VENDOR

Reformat në qeverisjen vendore ndër vite janë fokusuar si në thellimin e decentralizimit fiskal duke riparë të gjithë skemën e të ardhurave të pushtetit vendor, ashtu edhe menaxhimin e financave publike në nivel vendor. Gjatë vitit 2020 procesi i menaxhimit të financave publike vendore paraqiti sfida të reja, për shkak të nevojës për mbështetje me asistencë teknike për njësitë vendore në procesin e rishpërndarjeve buxhetore të imponuara nga ndryshimi i prioriteteve strategjike si pasojë e pandemisë COVID-19 dhe rindërtimit nga tërmeti. Përballimi i një sfide të madhe ekonomike dhe buxhetore nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2020, janë një tregues pozitiv i punës së zhvilluar në këto vite në drejtim të stabilitetit makroekonomik, parashikueshmërisë së fondeve dhe transparencës së përdorimit me disiplinë të fondeve buxhetore.

5.1 Të ardhurat e njësive të vetëqeverisjes vendore

Decentralizimi fiskal si një ndër shtyllat më të rëndësishme të menaxhimit financiar publik në nivel vendor pjesën më të rëndësishme ka rritjen e të ardhurave nga burimet e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore. Njësitë e vetëqeverisjes vendore në pëputhje më përcaktimet ligjore të ligjit për financat vendore nga qeveria qendrore gjithashtu përfitojnë të ardhura në formën e transfertave, ku një rol të rëndësishëm e zë transfertat e pakushtëzuar. Duke marrë në analizë të ardhurat e veta vendore, të klasifikuara sipas natyrës së burimit të të ardhurave gjatë vitit 2020 për shkak të situatës ekonomike të shkaktuar nga pandemia dhe tërmeti i fundvitit 2019, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë pësuar një trend rënës nga këto burime. Gjatë vitit 2020, pushtetit vendor ka siguruar rreth 21.9 miliardë lekë të ardhura tatimore ose thënë ndryshe rreth 1.2 miliardë lekë më pak të ardhura se një vit më parë. Ndërkohë, referuar të dhënave mbi të ardhurat jotatimore gjatë vitit 2020 janë mbledhur rreth 2.2 miliardë lekë nga ky burim, ose rreth 300 milion lekë më pak se në vitin 2019. Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat në mijë lekë të realizimit të këtyre burimeve gjatë vitit 2020-2019:


Grafiku 37 Realizimi i të ardhurave tatimore dhe jotatimore në vitin 2020 dhe 2019.



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Rritja e rolit të pushtetit vendor në drejtim të shërbimeve publike dhe funksioneve që ushtron, ka rritur peshën që të ardhurat nga burimet e veta ndaj totalit të burimeve dhe Produktit të Brendshëm Bruto të ndryshojë në vitet e fundit. Pavarësisht rënies së të ardhurave nominale gjatë vitit 2020, si pasojë e rënies ekonomike në tërësi nga pandemia, të ardhurat e veta të pushtetit vendor në raport me të ardhurat publike janë rritur nga 5.02% në vitin 2019 në 5.16% në vitin 2020, duke shënuar një rritje prej 2.07% në krahasim me vitin 2015, kur raporti i të ardhurave vendore me të ardhurat publike ishte rreth 3.09%. Nga ana tjetër, pushteti vendor ka rritur rolin e tij në vite përmes kontributit në ekonomi e në Produktin e Brendshëm Bruto duke ndryshuar raportin nga 0.82% e PBB në vitin 2015 në 1.4 % në vitin 2020, me një rritje prej 0.58% pikë përqindje.


Grafiku 38 Të ardhurat vendore në raport me totalin e të ardhurave publike dhe PBB.



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Të ardhurat e pushtetit vendor në vite kanë ruajtur një trend rritje të ndjeshme, duke përcaktuar në këtë mënyrë ecurinë pozitive të aftësisë së pushtetit vendor për të siguruar të ardhura. Ky trend nga viti 2015 e në vazhdim ka ardhur gjithnjë dhe në rritje, duke bërë në këtë mënyrë që të rritet ndjeshëm roli i pushtetit vendor në potencialin fiskal për të ofruar shërbime.


Grafiku 39 Të ardhurat e pushtetit vendor në vite dhe ritmi i ndryshimit.



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Duke marrë në analizë të ardhurat sipas burimeve të pushtetit vendor konstatojmë që gjatë vitit 2020, të ardhurat e veta vendore dhe ato nga transfertat e buxhetit qendror zënë një peshë pothuajse të barabartë. Nga 51.6 miliardë lekë shpenzimet vendore gjatë vitit 2020, rreth 50% ose 26.1 miliard lekë e zënë shpenzimet me burim transfertat e buxhetit qendror, ndërkohë pjesa tjetër e këtyre shpenzimeve mbulohet nga të ardhurat e veta të pushtetit vendor dhe taksat e ndara. Gjatë viteve të fundit, rritja e shpenzimeve vendore ka ardhur si rrjedhojë e rritjes konstante nga të gjitha burimet e të të ardhurave vendore: nga niveli qendror dhe të ardhurat e veta.


Grafiku 40 Të ardhurat e pushtetit vendor sipas burimit në vite



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Efeki i pandemisë COVID-19 dhe ngadalësimi ekonomik gjatë vitit 2020 reflektohet në rënien e disa prej burimeve të rëndësishme për financimin e buxhetit vendor. Në veçanti, në krahasim me një vit më parë konstatohet një rënie me rreth 500 milion lekë e të ardhurave të NJQV-ve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë; rënie me 150 milion lekë nga taksa e zënies së hapësirës publike dhe rënie rreth 270 milion lekë e të ardhurave jotatimore. Nga ana tjetër, të ardhurat nga tarifatat e shërbimeve ishin i vetmi burim që pësuan rritje gjatë vitit 2020, në raport me vitin 2019.

Grafiku 41 Të ardhurat e veta të pushtetit vendor sipas burimit në vite



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)


Burimi që zë peshën më të madhe në të ardhurat e veta vendore është taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, me rreth 37% të totalit të të ardhurave, e ndjekur nga taksa e ndërtesës dhe tarifatat e pastrimit, me përkatësisht 18% dhe 17% të totalit të të ardhurave të pushtetit vendor.

5.2 Shpenzimet e njëjësive të vetëqeverisjes vendore

Niveli i shpenzimeve për pushtetin vendor, për vitin 2020, arriti në masën rreth 51.6 miliardë lekë, nga 56.2 miliardë lekë një vit më parë. Kjo nënkupton një rënie prej 1.8 për qind në krahasim me shpenzimet e

përgjithshme vendore të vitit 2020 dhe një rënie të lehtë prej 0.06% të volumit të shpenzimeve vendore përkundrejt PBB-së. Efektet e pandemisë COVID-19 dhe procesi i rindërtimit kanë shkaktuar një luhatje të ndjeshme në shpenzimet e pushtetit vendor, kryesisht në gjysmën e parë të vitit 2020. Shumë procese të menaxhimit financiar publik në nivel vendor u ndikuan si pasojë e bllokimit të proceseve normale të zhvillimit ekonomik në tërësi. Në këtë drejtim nuk bën përjashtim efekti i shkaktuar nga situata ekonomike në shpenzimet e pushtetit vendor. Gjatë vitit 2020, pushteti vendor ka një rënie të shpenzimeve të financuara nga transferata e pakushtëzuar e sektoriale apo e përgjithshme dhe të ardhurat nga burimet e veta, me rreth 8% në raport me një vit më parë. Po ashtu, politikat fiskale që pushteti vendor ndërmori menjëherë përmes shtyrjes së pagesës për taksat e tarifat vendore, solli një ulje të burimeve të disponueshme në nivel vendor e novojën për tkurrjen e shpenzimeve.


Grafiku 42 Shpenzimet e pushtetit vendor në rritje dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Sipas natyrës ekonomike, peshën më të madhe të shpenzimeve vendore gjatë vitit 2020 e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime (43% të totalit). Në raport me një vit më parë konstatohet që shpenzimet për investime kanë një rënie me rreth 5 miliardë lekë, ndërkohë që shpenzimet e personelit dhe ato operative kanë një rritje të lehtë përkatësisht me 555 milionë lekë dhe 202 milionë lekë krahasuar me shpenzimet e vitit 2019. Shpenzimet kapitale pësuan një ulje prej 28% përkundrejt vitit 2019, si pasojë e situatës së vështirë financiare dhe riorientimit të prioritetëve drejt menaxhimit të situatës së krujuar nga pandemia. Përpjekjet e vazhdueshme të pushtetit vendor në funksion të zbutjes së problematikave sociale dhe gjithashtu mbulimit të shërbimeve jetike me ndikim të drejtpërdrejtë tek qytetarët, bëri që pothuajse të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore të rialokonin shpenzimet duke zbritur investimet e planifikuara dhe financiar shpenzimet sociale.

Grafiku 43 Shpenzimet e pushtetit vendor sipas klasifikimit ekonomik (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Tabela 11 Të ardhurat dhe shpenzimet e pushtetit vendor, sipas natyrës

Nr	E M Ë R T I M I	Fakt 12 mujori	Diferenca
----	-----------------	----------------	-----------

	(milionë lekë)	2020	2019	2020/2019	% e 2020 kundrejt 2019
I.	Të ardhura nga pushteti vendor	21,976	23,102	-1,126	95%
I.1	Taksa mbi pasurinë	5,124	5,208	-84	98%
I.2	Taksa e biznesit të vogël	384	355	29	108%
I.3	Taksa Lokale	16,468	17,539	-1,071	94%
II.	Shpenzime nga pushteti vendor	51,626	56,227	-4,601	92%
II.1	Shpenzime korrente	38,714	38,340	374	101%
	Personeli	22,390	21,835	555	103%
	Shpenzime Oper. Mirëmbajtje	15,168	14,966	202	101%
	Subvencione	152	180	-28	84%
	Te tjera	1,004	1,359	-355	74%
II.2	Shpenzime kapitale	12,912	17,887	-4,975	72%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Shpenzimet vendore të personelit përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale të NJVQV. Për vitin 2020, këto shpenzime janë realizuar në masën 22.4 miliardë lekë ose rreth 555 milion lekë më shumë se viti 2019. Rritja e shpenzimeve të personelit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk përbën rritje të ndjeshme por është një trend natyror i rritjes që njësitë vendore realizojnë me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve. Këto shpenzime për vitin 2020 zënë rreth 43% të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor, trend i cili ka qënë thuajse i qëndrueshëm krahasuar edhe me vitet paraardhëse. Me rritjen e kompetencave që pushteti vendor ka për të ushtruar në shërbim të qytetarëve, ka lindur nevoja për rritjen e personelit në funksion të mbulimit me shërbime cilësore ndaj qytetarëve.

Shpenzimet vendore operative janë shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve. Për vitin 2020, këto shpenzime janë realizuar në masën 15,2 miliardë lekë dhe rezultojnë më një rritje të lehtë në raport me një vit më parë. Shpenzimet operative përbëjnë rreth 29% të shpenzimeve të pushtetit vendor për vitin 2020, trend i cili rezulton me rritje në raport me vitin 2019 me rreth 2.4%. Parë në këndvështrimin e procesit të menaxhimit financiar publik, rritja e shpenzimeve operative me rreth 202 milion lekë vjen për shkak të rritjes së financimit në drejtim të mbështetjes me fonde buxhetore për dezinfektimin e ambjentëve publike, shkollave dhe godinave në varësi të NJVQV-ve për shkak të situatës së krijuar nga pandemia.

Shpenzimet vendore për subvencione dhe të tjera janë shpenzimet që zhvillojnë NJVQV për të subvencionuar dhe mbuluar funksione të tjera administrative, të cilat në vitin 2020 kanë pësuar një rënie prej 383 milion lekë. Tashmë njësitë e reja vendore duhet të planifikojnë më afatgjatë dhe mbështetur mbi një strategji të qartë zhvillimi dhe ofrimi të shërbimit publik, e në këto kushte është e nevojshme që në mënyrë vazhdueshme të mbështesë me subvencione zhvillimin ekonomik të zonës nën juridiksion.

Shpenzimet kapitale vendore rezultojnë në një vlerë të konsiderueshme prej rreth 12.9 miliardë lekë, ose 25% të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor. Ndërkohë, që sipas të dhënave shpenzimet për investime janë ato që kanë pësuar rënien më të madhe për vitin 2020 me rreth 5 miliardë lekë më pak se ato të realizuara në vitin 2019.

5.3 Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Në kuadër të evidentimit të detyrimeve të prapambetura të krijuara rishtazi, si dhe monitorimit të shlyerjes së tyre, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka vazhduar monitorimin edhe përgjatë vitit 2020. Stoku i detyrimeve të prapambetura për njësitë e vetëqeverisjes vendore në fund të muajit dhjetor 2020, është rreth 6.9 miliard lekë. Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është ulur me 1.2 miliard lekë krahasuar me stokun e detyrimit në

fund të vitit 2019, që ishte 8.1 miliard lekë dhe parashikohet të shlyhet në një periudhë afatmesme, në përputhje me planin e dakordësuar me MFE-në.

Stokun më të lartë të detyrimeve e ka bashkia Tiranë në vlerën rreth 762 milion lekë (11% të totalit të detyrimeve), bashkia Kavajë në vlerën rreth 728 milion lekë (0.5% të totalit të detyrimeve), bashkia Vorë në vlerën rreth 703 milion lekë (10.1% të totalit të detyrimeve) dhe bashkia Pogradec në vlerën rreth 339 milion lekë (4.9% të totalit të detyrimeve). Sa u përket qarqeve, stokun më të lartë të detyrimit e ka qarku Durrës në vlerën 63 milion lekë (49.2% të totalit të detyrimeve të qarqeve), qarku Berat në vlerën 42 milion lekë (32.9%) dhe qarku Gjirokastër në vlerën rreth 19 milion lekë (14.6% të totalit të detyrimeve të qarqeve). Sipas kategorive, peshën më të madhe të stokut të detyrimeve e zë kategoria “Investime” me 54.4%, kategoria “Të tjera” 17.3%, “Shërbime” 10.3%, dhe “Vendime Gjyqësore” 10%. Ndërsa sa u përket qarqeve, stoku i detyrimit të tyre përbëhet kryesisht nga vendime gjyqësore, të cilat zënë 95.3% të totalit të detyrimit të qarqeve.

Tabela 12 Detyrimet e prapambetura në nivel vendor sipas kategorive

Llog. Ekonomike	Kategoria	Bashki	Qarqe	Pesha në % Bashki	Pesha në % Qarqe
4864100	Vendime Gjyqësore	692,025,933	122,257,766	10.0%	95.3%
4864200	Det.Prap. Shërbime	716,505,694	2,068,017	10.3%	1.6%
4864300	Det.Prap.Mirembajtje	247,250,606	0	3.6%	0.0%
4864400	Det.Prap. Investime	3,769,240,374	739,225	54.4%	0.6%
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH	1,774,446	0	0.0%	0.0%
4864600	Mallra	245,428,057	1,284,342	3.5%	1.0%
4864900	Det.Prap.Te Tjera	1,195,677,167	1,954,484	17.3%	1.5%
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore	31,050,100	0	0.4%	0.0%
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet	2,843,748	0	0.0%	0.0%
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal	20,451,877	0	0.3%	0.0%
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera	8,391,753	0	0.1%	0.0%
TOTAL		6,930,639,755	128,303,834	100.0%	100.0%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

6. MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK

Borxhi publik gjatë vitit 2020 përgjithësisht është menaxhuar në përputhje me objektivat strategjike afatmesëm për ruajtjen e qëndrueshmërisë së raporteve ndërmjet kostos dhe risqeve. Në fund të vitit 2020, borxhi publik u vlerësua në nivelin 1,224.47 miliardë Lekë ose 77.9% e PBB-së, duke shënuar një rritje në nivelin e borxhit publik në raport me PBB me 11.6 pikë për qindje, krahasuar me nivelin e vitit të mëparshëm. Në linjë me nevojat buxhetore u realizua me sukses huamarrja, e cila mundësoi rfinansimin e borxhit ekzistues dhe financimin e pjesëshëm të deficitit buxhetor të planifikuar për vitin 2020. Huamarrja u realizua nëpërmjet burimeve të brendshme dhe burimeve të huaja, përkatësisht në nivelin 97.3% dhe 83.6% të planit vjetor. Në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, gjatë vitit 2020 u menaxhua reduktimi i mëtejshëm i ekspozimit ndaj risqeve të borxhit të brendshëm, si edhe u vijua me aktivitete në drejtim të zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë.

Në portofolin e borxhit të brendshëm është ulur pesha e borxhit që maturohet brenda një viti dhe pesha e titujve me norma interesi të ndryshueshme, duke mundësuar reduktimin e ekspozimit ndaj riskut të rfinansimit dhe atij të normave të interesit. Kosto mesatare e portofolit të borxhit ka vijuar të ulet edhe përgjatë këtij viti, kryesisht ndikuar nga rënia e mëtejshme e normave të interesit në tregun e brendshëm të titujve shtetërorë. Në vazhdim të angazhimit të ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar dhe zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë, përgjatë vitit 2019 është vijuar me praktikën që kontribuojnë në krijimin e madhësive referencë dhe konsolidimin e kurbës së yield-it në segmentin e titujve shtetërorë afatmesëm dhe afatgjatë. Në

këtë drejtim vlen të përmendet vijimi me Projektin Pilot për emetimin e obligacionit 5 vjeçar referencë dhe shtrirja edhe tek obligacioni 3 vjeçar.

Kosto mesatare e portofolit të borxhit ka vijuar të ulet edhe përgjatë këtij viti, kryesisht si rezultat i normave të interesit në nivele ende të ulëta, shoqëruar me refinancimin e borxhit që maturohet (kryesisht atij afatgjatë) me borxh më pak të kushtueshëm. Në vazhdim të angazhimit të ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar dhe zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë, përgjatë vitit 2020 është vijuar me zbatimin e projektit pilot për emetimin e obligacioneve referencë 3 dhe 5 vjeçare, i cili ka për qëllim të nxisë tregtimin e titujve në tregun sekondar dhe të rrisë zbulueshmërinë e çmimit të titujve, duke reduktuar në këtë mënyrë kostot e huamarrjes në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Për sa i përket zhvillimeve në tregun primar, kërkesa për tituj shtetërorë, megjithëse mbetet ende jo shumë e diversifikuar dhe e bazuar kryesisht tek sektori bankar, pothuaj gjatë gjithë vitit 2020 ka qenë e kënaqshme dhe ka mbuluar plotësisht nevojat e qeverisë për huamarrje të brendshme. Pavarësisht huamarrjes atipike të lartë dhe intensive gjatë vitit 2020, pothuajse të gjitha ankandet e titujve qeveritare kanë qenë relativisht të suksesshme, me nivele mbulimi mbi 1, duke mos reflektuar rritje substanciale të normave të interesit. Gjatë vitit 2021 dhe në vijim, menaxhimi i borxhit do të ketë në fokus përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së borxhit (kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm) në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, si edhe mbajtjes nën kontroll të kostove. Në tregun e brendshëm, nëpërmjet titujve afatshkurtër kryesisht do të synohet refinancimi i titujve ekzistues, si dhe menaxhimi i nevojave për likuiditet. Ndërkohë, nëpërmjet titujve afatgjatë do të synohet të realizohet huamarrja e re e planifikuar.

Huamarrja nëpërmjet burimeve të huaja do të plotësojë financimin e nevojshëm, duke kontribuar në uljen e presionit për hua në tregun e brendshëm, optimizimin e kostos së borxhit, si edhe sigurimin e pjesshëm të flukseve valutore të nevojshme për të shërbyer detyrimet e borxhit në valutë. Burimet kryesore të huamarrjes së huaj do të jenë huatë me terma të buta ose pjesërisht të buta, cilat do të financojnë projektet ekzistuese dhe projektet e reja të konsideruara si prioritare nga qeveria, si edhe huatë në formën e mbështetjes buxhetore të akorduara nga institucionet financiare ndërkombëtare për të mbështetur reformat dhe politikat zhvillimore të vendit. Pjesa e mbetur e financimit të huaj planifikohet të realizohet nëpërmjet burimeve private, ku si instrument huaje planifikohet të përdoret Eurobond-i, duke mos përjashtuar instrumentet e tjera financiare të tregjeve të kapitalit mbi baza oportuniste. Huamarrja nëpërmjet këtyre burimeve do të përdoret kryesisht për të menaxhuar detyrimet e borxhit në valutë duke përfshirë këtu refinancimin e Eurobondit që maturohet në vitin 2025.

7. RREZIQET FISKALE DHE DETYRIMET KONTIGJENTE GJATË 2020

Me qëllim ndjekjen e performancës të zbatimit të buxhetit të shtetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me mbështetjen e FMN dhe BB që prej vitit 2017 ka nisur monitorimin e risqeve që shoqërojnë zbatimin e tij. Ky proces ka për qëllim që, në bazë të analizave të thelluara, të rekomandojë zbutjen dhe/apo parandalimin në kohë të rreziqeve fiskale, pasuar nga një vendimarrje koherente. Risqet fiskale janë faktorë që mund të shkaktojnë devijim nga parashikimet fiskale dhe buxhetore gjatë ciklit të buxhetit, si rrjedhojë e disa ngjarjeve të paparashikuara. Ato mund të lindin si pasojë e supozimeve dhe zhvillimeve makroekonomike, vendimeve *ad-hoc* mbi politikën fiskale dhe/ose materializimin e detyrimeve kontingjente. Vlerësimi i probabilitetit dhe ndikimit të risqeve fiskale kryhet në bazë të analizave të thelluara dhe parashikimeve në kuadër të Buxhetit afatmesëm. Përkatësisht vlerësohen dy kategori risqesh:

- *Eksplícite*, Detyrime të njohura nga qeveria dhe të bazuara në legjislacionin në fuqi apo kontrata të ndryshme të cilat mund të lidhen me supozimet dhe zhvillimet makroekonomike, të ardhurat e qeverisë, shpenzimet e përgjithshme të qeverisë, shpenzimet dhe menaxhimin e borxhit, etj.

- *“Implicite”, kontingjente, Detyrime (indirekte) që mund të lindin si pasojë e presionit politik apo presionit të grupeve të ndryshme të interesit si detyrimet e lidhura me PPP-të, ato të vetëqeverisjes vendore, ndërmarrjet publike me kapital shtetëror, risqe të tjera si vendime gjyqësore, fatkeqësi natyrore dhe sektori financiar apo risqet afatgjata.*

Tabela 13 Matrica e riskut

Lloji i rrezikut	Skenarët e mundshëm
Risqet dhe detyrimet eksplicite	
Goditje Makroekonomike	Zhvillime makroekonomike të paparashikuara, që mund të ndryshojnë perspektivën e rritjes ekonomike dhe pozicionin fiskal
Parashikimi i të ardhurave	Mosrealizimi i të ardhurave, që mund të sjellë përkeqësimin e bilancit fiskal
Shpenzime të paplanifikuara	Detyrime ligjore ose presione politike, që mund të sjellin rishpërndarje të shpenzimeve
Borxhi publik	Zhvillime të papritura të tregut, ndryshime në normën e interesit ose në kursin e këmbimit, që mund të rrisin nivelin e borxhit publik
Risqet implicite dhe detyrimet kontingjente	
Pagesat për PPP	Pagesat vjetore për PPP-të, mund të tejkalojnë nivelin e lejuar ligjor prej 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës
Vështirësia financiare e Ndërmarrjeve Shtetërore (NSH)	Qeverisë mund t'i duhet të ndërhyjë për të mbështur financiarisht NSH-të
Risqe të tjera	Vendime gjyqësore, arbitrazhe ndërkombëtare, fatkeqësi natyrore, etj, që mund të sjellin kosto buxhetore shtesë në buxhetin e shtetit

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Gjatë vitit 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë vijoi monitorimin e risqeve kryesore fiskale/buxhetore, sipas Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.2 datë 20.01.2020 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2020, i ndryshuar” dhe Udhëzimit nr.37 datë 06.10.2020 për “Monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, nëpërmjet strukturës së Monitorimit të Risqeve Buxhetore. Kryesisht, raportimi në adresë të MFE u kanalizua përmes skeduleve kohore dhe formateve standarde të miratuara, një proces tashmë i institucionalizuar për monitorimin e risqeve, krahas intensifikimit të punës në drejtim të rritjes së cilësisë së përpunimit, raportimit dhe publikimit të informacionit të grumbulluar, me synim final:

- Monitorimin dhe raportimin periodik mbi bazë tremujore, të stokut të akumuluar të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme.
- Monitorimin dhe raportimin periodik mbi bazë tremujore, të performancës financiare të ndërmarrjeve kryesore shtetërore;
- Monitorimin dhe raportimin periodik mbi bazë mujore, të performancës së kontratave konçesionare/PPP, me mbështetje buxhetore.


Më poshtë jepet një tablo e vlerësimeve mbi disa nga tipologjitë e risqeve fiskale, si rezultat i monitorimit nga njësitë përgjegjëse në MFE, për vitin 2020:

7.1 Ndërmarrjet shtetërore

Referuar publikimit të Instat mbi sektorin publik në Shqipëri për vitin 2020 numri total i institucioneve jashtëbuxhetore është 169. Këto institucione ndahen si më poshtë:

- 66 jashtëbuxhetore Qeveria qendrore
- 88 jashtëbuxhetore qeveria lokale
- 16 korporata jo-financiare
- 1 korporatë financiare


Grafiku 44 Sektori quasi publik sipas numrit të ndërmarrjeve



Ndërmarrjet e Sektorit Energjetik.


Ky sektor strategjik ka qenë dhe mbetet nën monitorimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke patur parasysh ndikimin e konsiderueshëm fiskal dhe impaktin e ndjeshëm të tij në ekonomi. Ky monitorim, i cili është kryer periodikisht mbi bazë tremujore, ka konsistuar në analizimin e treguesve të performancës financiare të secilës prej tre kompanive KESH, OSHEE dhe OST. Këto të fundit kanë detyrimin e ndarjes së planeve financiare vjetore dhe pasqyrave financiare vjetore mbi bazë tremujore me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Grafiku 45 Ecuria e nivelit të arkëtimeve të OSHEE sh.a (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Grafiku 46 Ecuria e nivelit të humbjeve në rrjet për OSHEE sh.a (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Projektet e investimeve me financim të huaj për Sektorin e Energjisë për vitin 2020, u miratuan në nivelin 1.5 miliardë lekë sipas buxhetit fillestar dhe 1 miliardë lekë sipas Aktit Normativ nr.34 datë 16.12.2019 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 88/2019 ‘Për buxhetin e vitit 2020’”. Gjatë vitit 2020 niveli i përgjithshëm i prodhimit është rritur me rreth 2.1 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Situata vijon të mos jetë në kushte të favorshme hidrike dhe mund të shkaktojë vështirësi financiare kryesisht për OSHEE Sh.A e cila nuk do të arrijë të sigurojë furnizimin e një viti normal nga KESH Sh.A prej 3.85 TWh. Gjatë vitit 2020, KESH Sh.A realizoi një nivel prodhimi prej rreth 3.09 TWh, nga e cila 2,97 TWh ishte energji e transmetuar për FSHU Sh.A. Kjo situatë e detyroi OSHEE që ta sigurojë energjinë e munguar në tregun e lirë me një çmim shumë herë me të lartë se energjia që merr nga KESH Sh.a. Një rol pengues gjithashtu kishte dhe situata e shkakuar nga pandemia COVID-19.

Mbyllja e përkohshme, gjatë muajve mars dhe prill 2020, e disa aktiviteteve të prodhimit e shërbimit, ka sjellë një ndryshim të konsiderueshëm në konsumin e energjisë elektrike, duke rritur konsumin e klientëve familjarë dhe ulur konsumin e klientëve jofamiljarë. Sipas vlerësimeve paraprake të OSHEE Sh.A të efekteve negative të kësaj situatë në likuiditetet e kompanisë, parashikohet që kompania të pësojë luhatje të konsiderueshme financiare si pasojë e ndryshimit të strukturës së shitjes së energjisë nga klienti jofamiljar tek klienti familjar. Gjithashtu, një zhvillim i rëndësishëm është dhe ndarja e OSHEE Sh.A në tre kompani bija që prej datës 1 Janar 2020. Kjo ndarje u

bë në kuadër të reformës në sektorin energjetik, reformë e cila ka rikthyer këtë sektor në trend pozitiv dhe të qëndrueshëm.

Në terma të riskut fiskal, impakti i sektorit si kosto apo të ardhura të munguara në financat publike, për vitin 2020, vlerësohet rreth **5.2 miliardë** lekë. Krahasuar me vitin 2019, kur sektori pati një kosto rreth **6.8 miliardë lekë** për buxhetin e shtetit, vihet re një përkeqësim i gjendjes së detyrimeve. Kjo situatë është ndikuar nga kushtet e pafavorshme atmosferike që ulin nivelin e prodhimit dhe humbjet e shkaktuara gjatë pandemisë të cilat ulën ndjeshëm performancën financiare të kompanive të sektorit energjetik.

Një arritje e rëndësishme për vitin 2020 është edhe niveli rekord minimal i humbjeve në rrjet me 21.4 për qind, duke shënuar një ulje të humbjeve krahasuar me vlerën 21.8% të vitit 2019. Gjithsesi, një tregues mjaft i rëndësishëm për sektorin energjetik mbetet niveli i arkëtimeve i cili është ulur për vitin 2020 me rreth 9 miliardë lekë.

Në kuadër të reformës në sektorin e energjisë, në muajin Dhjetor, u finalizua me sukses plani i masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike. Ky plan masash, sipas Urdhërit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr.304 datë 17.12.2020 “Për miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”, do të shërbejë si në instrument kryesor për realizimin e një prej elementeve kryesore të reformës në këtë sektor jetik për ekonominë e vendit. Ky plan ofron një seri masash me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura dhe gjithashtu disiplinimin e pagesave ndërmjet kompanive të sektorit energjetik dhe palëve kryesore të lidhura me to. Pas arritjes së në disipline të shëndetshme pagesash ndërmjet tyre, plani propozon ristrukturimin e stokut të detyrimeve dhe përdorimin e instrumentave të ndryshme favorizuese në funksion të reduktimit të këtij stoku.

Ndërmarrjet e Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përmes Sektorit të Monitorimit të Risqeve dhe në kuadër të përmirësimit të monitorimit të ndërmarrjeve shtetërore, në bashkëpunim me asistencën teknike të Bankës Botërore, monitoruan dhe rishikuan disa tregues kryesorë financiarë të ndërmarrjeve të Ujësjellës Kanalizime për vitet 2018-2019 dhe 6-mujorin 2020.

Për vitin 2019 rezultati financiar i sektorit të ujësjellës-kanalizimeve u përkeqësua duke rezultuar me një humbje në vlerën 877 milion lekë. Ky rezultat financiar është përkeqësuar ndjeshëm duke konsideruar se në fund të vitit 2018 sektori rezultoi me një fitim në vlerën 542 milion lekë.

Për vitin 2020, nga të dhënat e agreguara të sektorit, 37 ndërmarrje rezultojnë me humbje në vlerën totale prej 1.8 miliard lekë dhe 11 ndërmarrje rezultojnë me fitim në vlerën 0.9 miliard lekë. Ndërmarrjet Durrës, Vlorë, Tepelenë, Elbasan dhe Kavajë përbëjnë 1.2 miliard të vlerës totale të ndërmarrjeve që raportojnë humbje (1.8 miliard lekë) ose 67% të sektorit për vitin 2019.

Treguesit kryesorë të performancës për 6-mujorin 2020 për ndërmarrjet e U-K të analizuar, tregojnë për një vijimësi të gjendjes ekzistuese financiare dhe vështirësi në pagimin e detyrimeve dhe mbledhjen e të ardhurave të faturuara korrente dhe të prapambetura, duke sinjalizuar probleme potenciale të likuiditetit në periudhën afashkurtër, krahasuar me vitin 2019. Impakt të konsiderueshëm në vështirësitë financiare të ndërmarrjeve U-K patën edhe pasojat nga pandemia COVID19, si dhe vazhdimësia e atyre të tërmetit të fuqishëm të muajit Nëntor 2019.


Ndërkohë, Qeveria nëpërmjet AKUM-it gjatë vitit 2020 i ka shpërndarë shoqërive U-K sh.a një vlerë totale subvencioni prej 720 milion lekë. Ky subvencion shkon kryesisht për ndërmarrjet të cilat nuk arrinjë të mbulojnë koston/shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat u shtuan gjatë periudhës së vështirë ekonomike të shkaktuar nga pandemia.

Një problematikë e rëndësishme mbetet edhe stoku i detyrimeve të akumuluar nga ndërmarrjet U-K sh.a ndaj sektorit të energjisë. Vlen për tu theksuar se, në kuadër të reformës në sektorin e energjisë, janë intensifikuar marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me institucionet dhe aktorët kryesorë të fushës, Ndërmarrjet UK me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe me ndërmarrjet e energjisë. Në muajin Dhjetor, u finalizua me sukses plani i masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike nëpërmjet Urdhërit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr.304 datë 17.12.2020 “Për miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”, ku është parashikuar stimulimi i performances së shëndoshë financiare me instrumenta të ndryshëm në drejtim të reduktimit të këtij stoku detyrimesh. Gjithashtu, ky plan propozon një seri aktivitete për të parandaluar borxhet e reja ndërmjet kompanive të energjisë elektrike dhe për të forcuar disiplinën e pagesave nga palët e treta. Pas disiplinimit të pagesave korrente, procesi i reduktimit të detyrimeve të prapambetura sigurohet nëpërmjet marrëveshjeve të ristrukturimit të borxheve mes kompanive, dhe ku është e mundur, netimin e detyrimeve të ndërsjella për të përshpejtuar procesin e konsolidimit.

7.2 Detyrimet e prapambetura të pushtetit qendror

Një nga çështjet problematike në sistemin tonë buxhetor, u vërtetua se ishte akumulimi i detyrimeve të prapambetura të krijuara përpara vitit 2014. Qeveria jo vetëm e adresoi me prioritet çështjen e shlyerjes së tyre, por me angazhimin maksimal si të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ashtu edhe të institucioneve buxhetore të përfshira në këtë proces, u arrit që brenda dy viteve (2014-2015) të shlyhen të gjitha detyrimet e prapambetura të raportuara, në vlerën 67 miliardë lekë. Bazuar në VKM nr. 50 datë 05.02.2014 “Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” dhe Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë disa hapa konkretë në drejtim të monitorimit, raportimit dhe parandalimit të detyrimeve të prapambetura. Ky është një proces i konsoliduar në kohë dhe cilësi, përmes monitorimit periodik intensiv të të gjitha detyrimeve të pashlyera. Në muajin tetor 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë vuri në zbatim Udhëzimin nr.37 për “Monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, i cili rregullon raportimin e detyrimeve të prapambetura nëpërmjet Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) duke prodhuar një raport gjithpërfshirës të stokut të detyrimeve për institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet ecuria e detyrimeve të prapambetura për vitin 2020.

Grafiku 47 Stoku i detyrimeve të prapambetura qendrore dhe vendore gjatë vitit 2020, mln lekë




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Megjithëse në vitin 2020 vendi u përball me pasojat e situatës pas termetit dhe efektet e shkaktuar nga pandemia, niveli i përgjithshëm i detyrimeve të prapambetura u mbajt në kontroll pavarësisht ngritjes që pësoi në fund të vitit 2019 e cila kulmoi në gjashtë mujorin e parë të vitit 2020. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka monitoruar edhe ecurinë e shlyerjeve të detyrimeve të prapambetura për secilën periudhë. Në total, gjatë vitit 2020, janë shlyer rreth 14.8 miliardë lekë detyrime të prapambetura nga periudhat e mëparshme. Në këto kushte, duke konsideruar që procesi i shlyerjes së detyrimeve nga ana e institucioneve bëhet në respektim të parimit FIFO, rezultojnë se detyrimet që mbeten për t'u shlyer gjatë vitit 2020 karakterizohen nga një "moshë mesatare" e re e krijimit të tyre.

Detyrimet e prapambetura të institucioneve buxhetore

Në grafikun e mëposhtëm jepet ecuria e stokut të detyrimeve të prapambetura për secilin tremujor të vitit 2020. Duhet të theksohet që vlera e regjistruar në shtator 2020 nuk përmban të gjithë stokun e detyrimeve pasi rezultojnë në periudhën e kalimit nga raportimi manual i të dhënave në sistemin SIFQ.

Grafiku 48 Stoku i detyrimeve të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturas dhe ministrive të tjera



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Një zë me peshë në ecurinë e detyrimeve të prapambetura mbetet ai i vendimeve gjyqësore administrative të formës së prerë:

- *Këto vendime kanë kryesisht në sfond largimet e padrejta nga puna të ish-punonjësve, të cilat në çdo rast implikojnë kosto buxhetore të paparashikuara. Këto detyrime monitorohen dhe raportohen nga Miiinistria e Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të monitorimit të përgjithshëm të detyrimeve të prapambetura.*

Për vitin 2020, detyrimet e prapambetura për vendime gjyqësore rezultuan në rreth 3,5 miliardë lekë ose rreth 18 për qind e stokut total të detyrimeve të prapambetura.

- *Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për t'i paraprirë akumulimit të tyre në kohë, përveç një monitorimi periodik, vazhdimisht i ka bërë apel nëpërmjet aftësisë menaxhuese të vetë institucioneve buxhetore, përmes aplikimit me këste të pagesës për përfituesit apo instrumenteve të tjerë të lehtësimit dhe/ose zhvendosjes në kohë të të barrës së tyre buxhetore.*

Parë në një aspekt më të gjerë dhe gjithëpërfshirës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka sugjeruar të gjitha njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik që në “Planin strategjik dhe vjetor të veprimtarisë audituese për vitet 2018 – 2020” të përfshijnë angazhime auditimi për analizimin dhe vlerësimin e situatës së detyrimeve të prapambetura të njësive publike. Kjo, përsa kohë që detyrimet e prapambetura janë përcaktuar si fushë me risk të lartë dhe duhet të trajtohen me përparësi nga auditimi i brendshëm i njësive publike, për të paraqitur gjendjen aktuale dhe për të dhënë rekomandime sa më të vlefshme për shlyerjen e tyre në afate të përcaktuara.

7.3 Koncesionet/PPP-të

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale. Shuma totale e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme, për t'u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore.

Gjatë vitit 2020, MFE ka vijuar monitorimin e performancës së kontratave koncesionare/PPP-ve me mbështetje buxhetore, duke monitoruar ecurinë e pagesave faktike buxhetore dhe treguesit e performancës të planifikuar/realizuar, për secilën kontratë koncesionare/PPP. Monitorimi dhe raportimi mbi kontratat koncesionare/PPP është institucionalizuar edhe përmes përfshirjes në udhëzimin plotësues nr.2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, të skedulit të detyrueshëm kohor të raportimit të tyre nga çdo autoritet kontraktor dhe të formateve standarde respektive, me qëllim thellimin e analizës dhe rritjen e transparencës. Ky monitorim është kryer në bazë mujore, me qëllim identifikimin dhe monitorimin hap pas hapi të risqeve potenciale që mund të materializohen nga implementimi i tyre.

Në fund të vitit 2020, në nivel total rezultoi se:

- Nga 13 kontrata koncesionare/PPP, me mbështetje buxhetore:
 - *Për 10 kontrata u regjistruan pagesa faktike buxhetore, për periudhën 12 mujore.*
 - *Për 3 kontrata nuk u krye asnjë pagesë.*
- Fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2020, sipas planit vjetor të ndryshuar, me destinacion mbështetjen nga buxheti për kontratat koncesionare/PPP, në total ishin rreth 9.73 miliardë lekë.
- Pagesat faktike për vitin 2020, në total rezultuan në rreth 9.63 miliardë lekë ose 99% e planit vjetor 2020, të ndryshuar.

Respektimi i rregullit fiskal, për vitin 2020:

- Kufiri i lejuar i pagesave neto për kontratat koncesionare/PPP, prej 5% i të ardhurave tatimore faktike të vitit 2019, përlogarit në rreth 21.3 miliardë lekë.
- Referuar tabelës së mëposhtme, pagesat vjetore neto të realizuara (faktike) nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, rezultuan në rreth 9.63 mld lekë.
 - *Rrjedhimisht, në buxhetin 2020 është respektuar kufizimin ligjor i sipërcituar në zbatim të rregullit fiskal respektiv, pasi vlera e realizuar prej 9.63 miliardë lekë, për pagesat vjetore neto të kontratave koncesionare apo PPP, për vitin 2020, përbën vetëm 2.26 për qind të totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2019, prej rreth 426.27 miliardë lekë.*

Tabela 14 Koncesionet/PPT-të aktive me mbështetje nga buxheti i shtetit (në mijë lekë)

Autoriteti Kontraktor	Nr.	Emërtimi i Kontratës PPP	Viti i fillimit	Viti i mbarimit	Programi	Lloji i Shpenzimit	Fakt 2017	Fakt 2018	Fakt 2019	Plan 2020	Fakt 2020	% e realizimit	
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Elbasanit	2015	2021	06220	Investim	538,085	601,429	631,317	586,770	582,720	99.3%	
	2	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier	2016	2023	06220	Investim	721,404	752,771	752,770	755,500	752,770	99.6%	
		Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese	2015	2019	04320	Investim	1,351,200	1,355,108	1,505,822				
	3	Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës së Arbrit	2018	2030	04520	Investim			3,910,860	2,691,110	2,691,055	100%	
	4	Ndërtim, Operim dhe Mirëmbajtje e Rrugës Milot-Morinë	2017	2047	04520	Investim	21,000	308,183	570,643	813,259	811,734	99.8%	
	5	Ndërtimi dhe Operimi i Porti Jahteve Oriikum - Dukat	2018	2030	04520	Investim				500	0		
	6	Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës Milot - Baldren	2018	2032	04520	Investim				-	0		
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1	Shërbimi i Skanimit në Dogana	2013	2030	01150	Korente	1,548,992	1,525,579	1,509,659	1,140,896	1,140,893	100%	
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	Koncesion/PPP Kontrolli bazë i popullsisë (check up)	2015	2024	07220	Korente	876,083	876,083	876,083	352,083	322,322	91.5%	
	2	Koncesion/PPP (Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale)	2015	2024	07330	Korente	1,086,572	1,625,581	2,163,282	1,300,700	1,288,269	99%	
	3	Koncesion/PPP (Ofrimi i shërbimit të dializës)	2016	2025	07330	Korente	370,251	738,911	804,388	733,300	733,203	100%	
	4	Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore	2019	2028	07330	Korente			0	80,000	30,670	38.3%	
Bashkia Tiranë/Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	1	Ndërtimi i Shkollave të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë e Tiranës	2017	2024	09120	Investim							
MIE / Bashkia Tiranë	1	Inceneratori i Tiranës	2017	2046	06220	Korente		977,000	977,125	1,280,000	1,280,000	100%	
	13	TOTALI						6,513,587	8,760,645	13,701,949	9,734,118	9,633,635	99%
		Totali i të Ardhurave Tatimore							419,333,310	426,270,680		398,657,710	
		Respektimi i Rregullit Fiskal (përpjesa e pagesave të PPP ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor më pak se 5%)								3.27%		2.26%	

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

7.4 Detyrime të tjera Kontigjente:

7.4.1 Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ)

Këto vendime kanë të bëjnë kryesisht me çështje që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave tek ish-pronarët. Sipas Avokaturës së Shtetit, risqet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ-së janë të karakterizuara nga një aftësi e dobët parashikuese, përse kohë që kjo Gjykatë nuk funksionon me një kalendar të përcaktuar për komunikimin e çështjeve dhe nxjerrjen e vendimeve. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka respektuar në vazhdimësi të gjitha vendimet e miratuara nga GJEDNJ, përmes likuidimit të VKM-ve respektive

miratuar në mbështetje të tyre, me përpikmëri dhe brenda afateve strikte të përcaktuara prej këtij organi. Kjo, duke konsideruar faktin se kur pagesat nuk kryhen brenda afatit tre mujor nga data kur vendimi përkatës merr formën e prerë, shteti shqiptar ngarkohet me pagesën e një kamatë-vonese për çdo ditë vonese. Sidoqoftë, për garantimin e shlyerjes në kohë të këtyre vendimeve, MFE ka rekomanduar vazhdimisht përdorimin e të gjitha kanaleve të mundshme institucionale dhe procedurale, brenda hapësirave që siguron kuadri ligjor në fuqi, duke sugjeruar skedulimin e detyrimit financiar, sipas mundësive të buxhetit të shtetit me këste, në negociim me përfituesit. Ndërkohë, hyrja në fuqi më datë 30.12.2018 e ndryshimeve në ligjin “Për Avokaturën e Shtetit”, përmban një kre të veçantë dedikuar ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së, ku specifikisht në nenin 19/4 përcaktohen 2 mënyra ekzekutimi të shpërblimit:

- *Vendimet me detyrim financiar mbi 10.000 EUR implikojnë nxjerrjen e VKM-ve për ekzekutimin e tyre.*
- *Vendimet me detyrim financiar deri në 10.000 EUR, ekzekutohen drejtpërdrejtë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas kërkesës zyrtare të Avokaturës së Shtetit.*

Gjatë vitit 2020, Këshilli i Ministrave ka miratuar një VKM lidhur me vendimet e GJEDNJ-së, me një vlerë totale prej 30.000 Euro (rreth 3.78 milion lekë), të cilat janë përballuar nga Fondi Rezervë i buxheti i shtetit, i miratuar për vitin 2020. Gjatë vitit 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka ekzekutuar anjë vendim të GJEDNJ-së, me vlerë përkatëse nën 10.000 Euro.

7.4.2 Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit

Ato kanë të bëjnë me vendimet e formës së prerë për zgjidhjen e konflikteve në mosmarrëveshjet dy ose shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar. Duke patur parasysh efektet e qënësishme financiare që rëndom shoqërojnë këto vendime, ato vlerësohen me risk të konsiderueshëm për buxhetin e shtetit.

Në pjesën më të madhe, efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtyre vendimeve janë përballuar nga buxheti i vetë institucioneve buxhetore (kryesisht ministri linje), të cilat kanë qenë edhe palë e paditur në gjykimet respektive. Ndërkohë që, në rastet kur palë e paditur cilësohet ‘shteti shqiptar’ apo ‘qeveria shqiptare’, këto vendime likujdohen përmes buxhetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe/ose Fondit rezervë të buxhetit të shtetit, nëse lind nevoja. Në vitin 2020, vlera totale e vendimeve të arbitrazhit të paguara nga buxheti i shtetit rezultoi në masën rreth 33.3 milion lekë. Nga këto:

- *1.5 milion lekë, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për likuidimin e faturave të shërbimeve juridike, për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar.*
- *8.694 milion lekë nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për pagesën e kostove administrative të Tribunalit.*
- *23.1 milion lekë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për pagesën e shërbimeve juridike dhe procesin e anulimit të një vendimi arbitrazhi.*

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në vazhdimësi dhe me këmbëngulje, ka rekomanduar forcimin e rolit negociues të institucioneve buxhetore dhe Avokaturës së Shtetit në çështjet e kësaj natyre, si edhe disiplinimin e procesit të shlyerjes financiare të përfituesve. Kjo, me qëllimin final të lehtësimit, reduktimit dhe/ose shmangies së barrës financiare mbi buxhetin e shtetit.

8. SHTOJCAT

8.1 Shtojca 1 - Zbatimi dhe monitorimi i parimeve dhe rregullave fiskale

Ligji Nr.57 datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar” (referuar në vijim si Ligji Organik i Buxhetit - LOB), në nenin 4/1 sanksionon disa parime dhe rregulla fiskale për mirëmenaxhimin e financave publike në Shqipëri. Ky seksion paraqet zbatueshmërinë e këtyre parimeve dhe rregullave fiskalë përgjatë vitit 2020.

Përcaktimi ligjor (1):

Neni 4/1, pika (1.a) i LOB sanksionon që në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qendrojë poshtë nivelit 45 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto.

Zbatimi i ligjit (1):

Ligji fillestar i buxhetit vjetor 2020 (Ligj nr. 88, dt. 18.12.2019) ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Ndërkohë, ndryshimet e këtij ligji që janë kryer nëpërmjet Akteve Normative përgjatë vitit 2020 kanë devijuar nga rregulli fiskal i sipërpërmendur. Këto devijime kanë qenë sërish në përputhje të plotë me përcaktimet që përmban LOB (sipas Neni 4/1, pika 1.b) ku parashikohen përjashtimet nga rregulli i mësipërm fiskal në “rastet e rrethanave të jashtëzakonshme”. Më specifikisht:

- Neni 4/1, pika (1.b) i LOB përcakton që përjashtim nga sanksionet e pikës së mësipërme të këtij neni (pikës "a") mund të bëhet vetëm në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme, të përcaktuara në nenin 4/4 të LOB.
- Përjashtimi (devijimi) i përkohshëm nga ky rregull fiskal për targetimin e një niveli të borxhit publik më të ulët sesa një vit më parë, është në përputhje me një prej rasteve të rrethanave të jashtëzakonshme, përcaktuar në nenin 4/4, shkronja “a” të LOB. Kjo pikë përcakton se një prej rrethanave të jashtëzakonshme, për efekt të këtij ligji, cilësohen rasti kur ndodhin katastrofa ose fatkeqësi natyrore, aksidente teknologjike apo situata të tjera, të paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të Qeverisë, të cilat rrezikojnë jetën dhe shëndetin e shtetasve shqiptarë.
- Gjatë vitit 2020, në zbatim të Vendimit nr. 243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyre” është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 në muajin mars 2020.

Tabela më poshtë paraqet nivelin e planifikuar të borxhit publik në vitin 2020 në ligjin fillestar të buxhetit dhe në cdo ndryshim të tij (nëpërmjet AN-ve) përgjatë vitit, si dhe krahasimin me nivelin e vlerësuar të borxhit publik për vitin 2019 në cdo rast.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2020

Ligji Nr. 88, dt. 18.12.2019		AN. Nr. 6, dt. 21.03.2020		AN. 15, dt. 15.04.2020		AN. 28, dt. 2.07.2020		AN. 34, dt. 16.12.2020	
Borxhi i vlerësuar për vitin 2019 (% PBB)	Borxhi i planifikuar për vitin 2020 (% PBB)	Borxhi i vlerësuar për vitin 2019 (% PBB)	Borxhi i planifikuar për vitin 2020 (% PBB)	Borxhi i vlerësuar për vitin 2019 (% PBB)	Borxhi i planifikuar për vitin 2020 (% PBB)	Borxhi i vlerësuar për vitin 2019 (% PBB)	Borxhi i planifikuar për vitin 2020 (% PBB)	Borxhi i vlerësuar për vitin 2019 (% PBB)	Borxhi i planifikuar për vitin 2020 (% PBB)
66.3%	64.7%	66.3%	68.7%	66.3%	69.6%	66.3%	80.5%	66.3%	80.5%

Shënim: Niveli i borxhit faktik i rezultuar në fund të 2020 nuk është relevant për sa i përket zbatueshmërisë ligjore të këtij neni/pike të LOB. Ky nen sanksionon vetëm nivelin e planifikuar të borxhit për 2020 dhe jo atë të rezultuar faktikisht në fund të vitit. Niveli faktik i rezultuar në fund të vitit është informues mbi efektshmërinë e LOB sa i takon uljes faktike të borxhit, por nuk është relevant sa i takon zbatueshmërisë/përputhshmërisë me ligjin.

Sa i takon vlerësimin të borxhit faktik gjatë vitit 2020 (sipas shifrave të disponueshme deri në momentin e hartimit të këtij raporti) rezultojnë 76.1% e PBB. Kjo konsiston në një rritje prej rreth 9.9 pikë për qindje të borxhit publik total nga niveli prej 66.3% që ishte në vitin 2019.

Ndërsa, nëse në konsideratë do merrej treguesi i borxhit publik total, *neto* nga gjendja e depozitës së qeverisë në Bankën e Shqipërisë (Llogarisë unike të thesarit), atëherë rritja e borxhit sipas këtij treguesi (borxhi neto) rezultojnë me 10.3 pikë për qindje, nga 65.3% në vitin 2019, në 75.7% në vitin 2020.

Përcaktimi ligjor (2):

Neni 4/1, pika (1.c) i LOB sanksionon që vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin “Perspektiva Ekonomike Botërore” (Ëorld Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqërues të ligjit vjetor të buxhetit.

Zbatimi i ligjit (2):

Çdo ligj vjetor i buxhetit 2020 hartuar dhe miratuar për vitin 2020 (ligj fillestar ose i ndryshuar) ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor të LOB. Tabela më poshtë paraqet shifrat konkrete në kohën e hartimit dhe miratimit të lligjit fillestar dhe secilit ndryshim pasues përgjatë 2020 dhe përputhshmërinë respektive me këtë përcaktim të LOB.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2020

Ligji Nr. 88, dt. 18.12.2019				AN. Nr. 6, dt. 21.03.2020				AN. 15, dt. 15.04.2020				AN. 28, dt. 2.07.2020				AN. 34, dt. 16.12.2020			
PBB sipas FMN (1) (miliardë lekë)		PBB e përdorur në planifikim (miliardë lekë)		PBB sipas FMN (1) (miliardë lekë)		PBB e përdorur në planifikim (miliardë lekë)		PBB sipas FMN (2) (miliardë lekë)		PBB e përdorur në planifikim (miliardë lekë)		PBB sipas FMN (2) (miliardë lekë)		PBB e përdorur në planifikim (miliardë lekë)		PBB sipas FMN (3) (miliardë lekë)		PBB e përdorur në planifikim (miliardë lekë)	
2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
1,705	1,809	1,705	1,793	1,705	1,809	1,679	1,742	1,705	1,809	1,679	1,742	1,705	1,809	1,679	1,581	1,678	1,570	1,679	1,581

(1) WEO - Tetor 2019;

(2) WEO - Prill 2020;

(3) WEO - Tetor 2020

Shënim: Vlerat faktike të PBB të vitit 2020 të vlerësuara dhe publikuara nga INSTAT nuk janë relevante për sa i përket zbatueshmërisë ligjore të këtij neni/pike të LOB. Ky nen/pikë sanksionon vetëm limitin e sipërm sa i takon PBB të parashikuar dhe përdorur gjatë planifikimeve të çdo ligji vjetor buxheti (pra, jo më e lartë se sa parashikimi respektiv i FMN). Ndërkohë që PBB faktike (pra, sipas INSTAT) e rezultuar në fund të vitit është informuese sa i takon efektshmërisë së LOB lidhur me "realizmin" e parashikimeve të PBB, dhe veçanërisht eliminimin e devijimeve "optimiste" sistematike (të përsëritura disa vite rresht).

Përcaktimi ligjor (3):

Neni 4/1, pika (1.ç) i LOB sanksionon që në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7 për qind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Zbatimi i ligjit (3):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2020 (ligj fillestar ose i ndryshuar) ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Tabela më poshtë paraqet shifrat konkrete në kohën e hartimit dhe miratimit të lligjit fillestar dhe secilit ndryshim pasues përgjatë 2020 dhe përputhshmërinë respektive me këtë përcaktim të LOB.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2020

Vlera e Buxhetuar e zërit "Kontigjencë për luhatjet e normave të interesit"

Ligji Nr. 88, dt. 18.12.2019	AN. Nr. 6, dt. 21.03.2020	AN. 15, dt. 15.04.2020	AN. 28, dt. 2.07.2020	AN. 34, dt. 16.12.2020
4 miliardë Lekë ose 0.7% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji	4 miliardë Lekë ose 0.7% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji	4 miliardë Lekë ose 0.7% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji	4.1 miliardë Lekë ose 0.7% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji	4.1 miliardë Lekë ose 0.7% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji

Përcaktimi ligjor (4):

Neni 4/1, pika (1.d) i LOB sanksionon që në çdo ligj vjetor fillestar të buxhetit, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, kur rritja reale e Produktit të Brendshëm Bruto, e parashikuar në raportin respektiv "Perspektiva Ekonomike Botërore", të FMN-së, është të paktën 5 për qind, atëherë deficitin i përgjithshëm nuk mund të jetë më i lartë se 2 për qind e Produktit të Brendshëm Bruto, përveç rasteve të rrethanave të jashtëzakonshme, të përcaktuara në shkronjat "a", "b" e "c", të nenit 4/4, të këtij ligji.

Zbatimi i ligjit (4):

Në cdo fazë të hartimit dhe miratimit të ligjeve vjetore të buxhetit për vitin 2020 kjo pikë nuk ka qenë rasti të jetë kufizuese për sa i takon sanksionit ligjor që ajo përcakton, pasi në asnjë nga raportet "Perspektivës Ekonomike Botërore" të FMN-së të publikuar gjatë vitit 2020 nuk parashikohej një rritje reale për vitin 2020 të paktën 5%. Rrjedhimisht, të gjitha ligjet vjetore të buxhetit të hartuara dhe miratuara për vitin 2020 kanë qenë në përputhje me këtë pikë.

Shënim: Kjo pikë ka si synim të ankorojë në mënyrë kundër-ciklike politikën fiskale. Pra, nëse ekonomia parashikohet të rritet "përtej potencialit të natyreshëm" të saj, që në rastin konkret ky prag është kuantifikuar në LOB si "rritja reale e parashikuar nga FMN të paktën 5%", atëherë në këtë rast kjo pikë ankoron politikën fiskale drejt një konsolidimi më të lartë në terma të borxhit publik, duke vendosur një limit direkt mbi deficitin e targetuar në jo më shumë se 2% e PBB. P.sh., një rast hipotetik, ilustrues, nëse do të ndodhte që në një vit të caktuar rritja reale do të ishte 5% dhe nëse deficitin do të ankorohet sipas kësaj pike 2% (maksimumi i lejueshëm në këtë rast), duke supozuar një normë inflacioni (deflator) 3% dhe variablat e tjerë të pandryshuar, atëherë borxhi publik përgjatë vetëm atij viti do të reduktohej me rreth 4 pikë për qindje. Ndërkohë pika (ç) në nenin 4/4 përcakton rastin e kundërt të pikës më sipër, pra përcakton një opsion manovrimi ekspansionist të politikës fiskale për të ndikuar në stabilizimin e ciklit të ekonomisë nëse do të ndodhte një rast ku ekonomia të gjendej "në një pikë tejet të dobët të saj", e cila është kuantifikuar në LOB si "rritje reale e parashikuar nga FMN në 1% ose më e ulët". Por në këtë rast, që të mund të përdoret ky opsion lehtësues për stabilizim kundër-ciklik duhet që gjithashtu të jetë siguruar një farë niveli relativisht i qëndrueshëm i borxhit publik, i cili në këtë pikë të LOB kuantifikohet si niveli poshtë 60% të PBB.

Përcaktimi ligjor (5):

Neni 4/1, pika (1.dh) i LOB sanksionon që në fazat monitoruese të buxheteve faktike, nëse për shkak të rishikimeve të mundshme të PBB-së nominale ose për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit, që përdoren për vlerësimin e stokut faktik të borxhit publik, rezulton se raporti i borxhit publik ndaj PBB-së nuk është më i ulët, kundrejt nivelit të vitit pararendës, atëherë, si rregull këto devijime duhet të kompensohen në planifikimet e viteve buxhetore pasuese.

Zbatimi i ligjit (5):

Në fund të vitit 2020 niveli i borxhit faktik ka rezultuar më i lartë se sa niveli që shënonte në vitin 2019. Megjithatë, në këtë rast specifik, kjo pikë e LOB nuk gjen aplikim, pasi siç shpjegohet edhe më sipër, për vitin 2020 është planifikuar (në ndryshimet e ligjit përgjatë 2020) një nivel borxhi më i lartë se një vit më parë si pasojë ndodhjes

dhe aplikimit të rasteve të rrethanave të jashtëzakonshme, në përputhje me përcaktimet e LOB. Pra, ky përjashtim nga rregulli u parashikua që në fazat planifikuese të ligjit të buxhetit 2020 (ndryshimet përgjatë 2020 nëpërmjet AN-ve) dhe rrjedhimisht, edhe në fund të vitit 2020 rezultoi një nivel faktik i borxhit publik më i lartë se sa niveli i 2019.

Shënim: Kjo pikë nuk është relevante sa i takon përputhshmërisë me LOB për vitin që analizohet aktualisht, konkretisht viti 2020, por ajo ka implikime që duhen adresuar në ligjet e buxheteve të viteve të tjera në vijim nëse ndodh rasti që parashikohet në këtë pikë të LOB.

Përcaktimi ligjor (6):

Neni 4/1, pika (2) i LOB sanksionon që të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 për qind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

Zbatimi i ligjit (6):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2020 ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Së pari, në asnjë ligj vjetor të buxhetit 2020 nuk janë parashikuar të ardhura shtesë nga privatizimet. Së dyti, të ardhurat nga privatizimet të realizuara gjatë vitit 2020 kanë qenë në vlerën e rreth 0.2 miliardë Lekë, e cila është një vlerë marxhinale, pa rëndësi relative, krahasuar me ndryshimet e pësuar përgjatë vitit (në ndryshimet ligjore, si dhe rezultatet faktike) të zërit të shpenzimeve kapitale totale, si dhe atij të huamarrjes totale neto. Pra, pjesa e dytë e kësaj pike (lidhur me përdorimin e këtyre të hyrave në rast arkëtimi) nuk gjen aplikim (nuk është relevante) në këtë rast.

Përcaktimi ligjor (7):

Neni 4/1, pika (3) i LOB sanksionon që ndryshimet e ligjeve tatimore, me efekte në të ardhurat buxhetore, bëhen një herë në vit, jo më vonë se tre muaj përpara fillimit të vitit të ri fiskal. Ligjet tatimore konsultohen paraprakisht me përfaqësuesit e biznesit dhe grupe të tjera interesi, në strukturat e ngritura për këtë qëllim.

Zbatimi i ligjit (7):

Amendimet e ligjeve tatimore me efekt në të ardhurat e buxhetit për vitin 2020 kanë nisur në fillim të 6-mujorit të dytë 2019. Paketa e ndryshimeve ligjore i është nënshtruar diskutimit dhe marrjes së mendimeve nga Ministritë e linjës, si dhe nga organizatat përfaqësuese dhe grupet e interesuara të biznesit, duke reflektuar kërkesat dhe sugjerimet e tyre.

Paketa fiskale është miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave në tetor dhe është miratuar nga Kuvendi në dhjetor 2019. Efektet e paketës fiskale përgjithësisht janë marrë në konsideratë në planifikimin e të ardhurave tatimore të buxhetit 2020, buxhet i cili u miratua pas miratimit të ndryshimeve në paketën fiskale.

Përcaktimi ligjor (8):

Neni 4/1, pika (4) i LOB sanksionon që masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit, përveç në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme, që parashikohen në nenin 4/4 të këtij ligji.

Zbatimi i ligjit (8):

Ligji fillestar vjetor i buxhetit për vitin 2020, si dhe dy (nga katër) ndryshimet e tij vijuese kanë qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Ndërkohë që ndryshimi i tretë dhe ai i katërt kanë bërë një përjashtim (devijim) të përkohshëm nga ky rregull fiskal në kushtet e ndodhjes dhe aplikimit të përcaktimit të rrethanave të jashtëzakonshme, sikurse parashikohet në nenin e mësipërm. Tabela më poshtë paraqet shifrat konkrete në kohën e hartimit dhe miratimit të lligjit fillestar dhe secilit ndryshim pasues përgjatë 2020 dhe përputhshmërinë respektive të secilit prej tyre me këtë përcaktim të LOB.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2020

Ligji Nr. 88, dt. 18.12.2019		AN. Nr. 6, dt. 21.03.2020		AN. 15, dt. 15.04.2020		AN. 28, dt. 2.07.2020		AN. 34, dt. 16.12.2020	
Deficiti i targetuar (miliardë lekë)	Shpenzimet Kapitale të targetuara (miliardë lekë)	Deficiti i targetuar (miliardë lekë)	Shpenzimet Kapitale të targetuara (miliardë lekë)	Deficiti i targetuar (miliardë lekë)	Shpenzimet Kapitale të targetuara (miliardë lekë)	Deficiti i targetuar (miliardë lekë)	Shpenzimet Kapitale të targetuara (miliardë lekë)	Deficiti i targetuar (miliardë lekë)	Shpenzimet Kapitale të targetuara (miliardë lekë)
32.9	87.5	68.7	100.8	68.7	96.0	133	121.8	133	121.3

Shënim: Edhe kjo pikë e LOB jep përcaktime ligjore të detyrueshme për fazën planifikuese të buxhetit, ndërkohë që nuk është sanksionuese për rezultatin faktik në mbyllje të vitit.

Përcaktimi ligjor (9):

Neni 4/1, pika (5) i LOB sanksionon që duke filluar që prej vitit buxhetor 2023 e në vijim, balanca primare buxhetore nuk duhet të rezultojë më e vogël sesa zero, përveçse në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme që parashikohen në nenin 4/4, të këtij ligji.

Zbatimi i Ligjit (9):

Në përputhje me këtë dispozitë, vlerësimi i balancës primare buxhetore për qëllim të këtij neni do të bëhet duke nisur nga viti 2024, referuar vitit buxhetor 2023.

Përcaktimi ligjor (10):

Neni 4/3 sanksionon që në vitet buxhetore, gjatë të cilave mbahen zgjedhjet e përgjithshme, ekzekutimi i deficitit buxhetor të qeverisjes së përgjithshme, përveç rasteve të jashtëzakonshme, të parashikuara në nenin 4/4, të këtij ligji, bëhet në përputhje me përcaktimet e këtij neni si më poshtë:

- ekzekutimi i deficitit deri në fund të tremujorit të parë të vitit buxhetor nuk mund të jetë më i lartë se 30 për qind e deficitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor;
- ekzekutimi i deficitit deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit buxhetor nuk mund të jetë më i lartë se 55 për qind e deficitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor;
- ekzekutimi i deficitit deri në fund të nëntëmujorit të parë të vitit buxhetor nuk mund të jetë më i lartë se 80 për qind e deficitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor.

Zbatimi i ligjit (10):

Gjatë vitit 2020, nuk janë mbajtur zgjedhje të përgjithshme dhe rrjedhimisht nuk aplikohet përcaktimi ligjor i mësipërm.

8.2 Shtojca 2 – Efektet e paketës fiskale 2020

Masat	Efektet e parashikuar i paketës	Të ardhura të mbledhura si efekt i masës fiskale	Diferenca Parashikimi/Të ardhura të mbledhura	Diferenca Fakt 2020/Fakt 2019	Faktorët	Efektet
Rritet niveli i akcizës së cigareve për vitin 2020, nga 6,250 lekë/1000 fije që ishte parashikuar në kalendar, në 6,500 lekë/1000 fije.	+0.76 miliardë lekë	0.66 miliardë lekë	-0.1 miliardë lekë	-0.6 miliardë lekë	Rënie e sasisë së cigareve, e shoqëruar me situatën ekonomike prej Covid – 19	Rënie e nivelit të të ardhurave të mbledhura në buxhetin e shtetit nga akciza për vitin 2020, me efekt total -0.6 miliardë lekë krahasuar me një vit më parë.
Shtyrja e afateve të parapagimit të kësteve të tatimit mbi fitimin dhe afateve të pagesës së tatimit për vitin 2020 për tatimpaguesit me qarkullim nën 14 milion	-5 miliardë lekë	28.3 miliardë lekë		-11.7 miliardë lekë	Shtyrja e afateve të pagesës së tatimit me qëllim rimëkembjen e biznesit	Lehtësim i mbi 50% të bizneseve ose ndihmuan rreth 49 Mijë biznese.
Shtyrja e afatit të rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme	+4 miliardë lekë	+3.3 miliardë lekë	-0.7 miliardë lekë		Të jepet kohë e mjaftueshme të gjithë individëve apo subjekteve që kanë interes ta kryejnë procesin e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme	Efekt të drejtpërdrejtë në nxitjen dhe formalizimin me vlerën e tregut të pasurive të paluajtshme
Detyrimi për deklarimin e të ardhurave individuale vjetore për individët e punësuar në shumë se një punedhënës	+800 milionë lekë				Përlllogaritja e sakte edhe e drejtë e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi	Trajtim të njëjtë tatimor ndërmjet individëve që i sigurojnë të njëjtën vlerë të ardhurash nga disa burime punësimi me ata që i sigurojnë vetëm nga një burim punësimi

8.3 Shtojca 3 Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës

Buxheti i vitit 2020 financoi 129 programe buxhetore dhe synonte realizimin e 604 produkteve të 11 ministrive të linjës. Gjithashtu, këto shpenzime kanë financuar edhe buxhetin e institucioneve të pavarura; fondeve speciale si edhe njësive të vetëqeverisjes vendore: 61 bashki dhe 12 qarqe. Në përgjithësi evidentohet një performancë relativisht e mirë e realizimit të produkteve buxhetore nga ministrinë e linjës, po të kemi parasysh vështirësitë e krijuara nga pandemia. Nga 604 produkte të parashikuara për vitin 2020, janë realizuar plotësisht 430 produkte ose 71.2 për qind; realizuar pjesërisht 104 produkte ose 19.9 për qind dhe nuk janë realizuar vetëm 54 produkte ose 8.9 për qind nga të planifikuarat në vitin 2020. Tabela në vijim jep në mënyrë të përmbledhur, sa më sipër cituar:

Tabela 15 Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës

Nr	Ministria e Linjës	Produktet (në numër)			
		Planifikuar	Plotësisht	Pjesërisht	Pa realizuar
1	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	78	46	22	10
2	Ministria e Infrastruktura dhe Energji	110	72	10	28
3	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	78	70	8	-
4	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	67	50	15	2
5	Ministria e Kulturës	18	14	3	1
6	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	50	29	19	2
7	Ministria e Drejtësisë	54	27	21	6
8	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	33	16	12	5
9	Ministria e Brendshme	33	28	5	0
10	Ministria e Mbrojtjes	34	32	2	-
11	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	49	46	3	0
	TOTALI	604	430	120	54

Tabela 16 Realizimi i buxhetit 2020 në disa institucione kryesore qendrore

Institucioni	2020 Plan fillestar	2020 Plan i rishikuar	2020 (fakt)	2019 (fakt)	Shpenzime korrente (fakt/plan)	Shpenzime kapitale (fakt/plan)	Total Gjithsej (fakt/plan 2020)	Fakti 2020/Fakti 2019
Presidenca	252,300	235,907	195,471	205,060	77%	88%	77%	95%
Kuvendi	1,341,160	1,174,188	931,187	957,362	70%	66%	69%	97%
Kryeministria	591,000	586,160	467,583	605,903	84	64	79%	77
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	11,112,000	10,535,244	9,918,702	6,955,170	97	85	89%	143
Ministria e Infrastruktura dhe Energji	36,610,615	50,011,385	47,302,926	39,616,641	20%	289%	129%	119%
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	59,857,139	83,557,353	81,606,685	56,636,375	139%	92%	136%	144%
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë	41,979,763	41,434,592	39,049,394	32,202,653	96%	63%	93%	121%
Ministria e Kulturës	2,256,204	2,526,331	2,171,464	2,129,864	86%	94%	96%	102%
Ministria e Shëndetësisë	62,969,940	69,165,856	67,811,411	44,128,994	91%	107%	108%	154%
Ministria e Drejtësisë	10,846,390	8,899,698	8,550,497	10,732,728	79	76	79%	80
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	3,416,380	3,304,331	3,051,200	3,044,973	91	46	89%	100
Ministria e Brendshme	20,545,648	21,110,778	20,698,375	20,870,904	98%	127%	101%	99%
Ministria e Mbrojtjes	24,108,845	22,490,621	21,353,335	21,669,923	90%	80%	89%	99%
Sherbimi Informativ Kombëtar	3,679,500	1,736,500	1,685,926	1,573,189	90%	2%	46%	107%
Akademia e Shkencave	106,000	284,400	282,741	99,850	88	184	267%	283
Kontrolli Lartë i Shtetit	444,036	422,312	364,908	377,009	86%	29%	82%	97%
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	2,241,030	2,719,929	2,747,867	2,645,741	96%	159%	123%	104%
Prokuroria e Përgjithshme	2,308,800	2,301,600	2,180,371	2,171,758	94%	98%	94%	100%
Keshilli i Lartë Gjyqësor	3,409,150	2,912,650	2,758,839	2,633,137	83%	54%	81%	105%
Gjykata Kushtetuese	147,000	115,350	98,463	102,312	67%	93%	67%	96%
Fondi i Zhvillimit Shqipëtar	14,898,000	25,035,391	21,427,415	13,224,069		144%	144%	162%
Veprimtaria e Mbikëqyrjes dhe Rivlerësimit në sistemin e Drejtësisë	484,600	431,600	416,401	440,149	87%	67%	86%	95%
Institucione të tjera Qeveritare	6,657,520	8,548,828	7,790,553	5,535,273	109	136.5	117%	141

8.3.1 Shëndetësia dhe Mbrojtja Sociale

Në përputhje me drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2020, performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, paraqitet si më poshtë:

Tabela 17 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (në mijë lekë)

Programi buxhetor	Fakti viti 2019	Buxheti vjetor Plan fillestar 2020	Buxheti vjetor Plan i rishikuar 2020	Realizimi faktik 2020	Diferenca në % me planin fillestar	Diferenca në % me planin e rishikuar
Planifikim Menaxhim Administrim	338 718	423 968	2 633 674	2 188 312	516%	83,09%
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	7 814 460	8 321 398	7 752 468	7 702 041	93%	99,35%
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	25 672 290	25 861 642	26 371 245	25 732 181	99%	97,58%
Shërbime të Shëndetit Publik	2 677 134	3 013 791	3 002 351	2 842 056	94%	94,66%
Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	179 839	333 382	347 182	296 051	89%	85,27%
Përkujdesi Social	23 542 443	23 988 460	28 021 635	27 756 407	116%	99,05%
Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë	1 301 722	1 037 300	1 037 300	1 033 156	100%	99,60%
Gjithsej	61 526 605	62 979 941	69 165 855	67 550 204	107%	97,66%
Shpenzime nga të ardhura jashtë limitit				312 489		
Gjithsej	61 526 605	62 979 941	69 165 855	67 862 692	108%	98,12%

Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u rishikua në ngritje të ndjeshme gjatë vitit 2020, si institucioni drejtues për përballimin e pasojave të pandemisë Covid-19 jo vetëm nga pikëpamja e shëndetit publik; por edhe për masat e ndërmarra në ndihmë të kategorive në nevojë.

Më konkretisht, buxheti i programit “Planifikim, menaxhim dhe administrim” u gjashtëfishua gjatë vitit 2020, për të përballuar shpenzimet ekstra të nevojshme në sistemin shëndetësor për blerje pajisje mbrojtëse ndaj Covid 19-ës; blerje pajisjesh mjekësore, autoambulanca, si dhe bonusi për mjeët dhe infermierët e angazhuar jashtë shtetit. Disa prej projekteve të parashikuara në këtë kaudër nuk u realizuan për shkak të vonesës së procedurave të prokurimit dhe/ose vonesave me procedura të tjera ligjore.

Programi “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor” hasi disa pengesa në lidhje me qëllimin, i cili synon mbulim universal të nevojave të popullatës për kujdes mjekësor parësor. Megjithatë, personeli shëndetësor u angazhua maksimalisht nëpërmjet vizitave në qendra shëndetësore e në distancë. Qëllimi i programit u realizua nëpërmjet dy objektivave, sa më poshtë:

- Përmirësimi i shërbimeve parandaluese dhe të diagnostikimit të hershëm të sëmundjeve.
- Plotësimi i qendrave shëndetësore në masën 80% me infrastrukturën e nevojshme për funksionimin e sistemit të informacionit.

Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për vitin 2020, është realizuar, si më poshtë:

- ✓ “Mbulimi me kujdesin parësor”, janë realizuar rreth 6,14 milionë vizita tek mjeku i familjes (ose 96% e vizitave të parashikuara), me një kosto faktike rreth 2,170 milionë lekë.
- ✓ “Kryerja e Check-Up”, ku gjatë vitit 2020 kanë kryer check-up rreth 101 mijë pacientë (ose 86% e numrit të kontrolleve të parashikuara për vitin 2020 dhe 40% e kontrolleve në vitin 2019) me një kosto faktike rreth 352 milionë lekë. Programi i check-up-it u pezullua për pjesën më të madhe të vitit 2020 për shkak të situatës së pandemisë.

- ✓ “Pacientë të trajtuar me recetë me rimbursim nga mjeku i familjes”, me një kosto faktike prej 4,775 milionë lekë për rreth 407 mijë pacientë (ose 84% e parashikimit fillestar). Ndër këta, 1,708 persona janë trajtuar me listën e rimbursimit për Covid-19.

Programi **“Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”**, i cili synon mbulim universal të nevojave të popullatës për kujdes mjekësor të specializuar, u prek nga kufizimi i shërbimeve jorgjente spitalore për shkak të pandemisë. Si rezultat, gjatë vitit 2020 janë trajtuar në shërbimet me shtretër rreth 220,325 pacientë (rreth 90 mijë më pak nga e njëjta periudhë e një viti më parë dhe 29% më pak se plani për vitin 2020).

Në përgjithësi, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia, disa nga ndërhyrjet e planifikuara në spitalet publike nuk u realizuan, kështu që realizimi i paketave spitalore gjatë vitit 2020 nuk ishte në nivelin e pritshëm. Megjithatë, u trajtuan normalisht pacientët për shërbimin e dializës (195,384 seanca, në spitalet publike, jopublike si dhe sipas kontratës koncesionare në pesë qendra të reja - spitale rajonale të vendit); u realizuan 6,197 raste të paketave të kardiologjisë e kardiokirurgjisë, 10 raste të paketës së transplantit të veshkës, 2,089 raste të paketës së kataraktës, si dhe 19,168 seanca të radioterapisë.

Programi **“Shërbime të Shëndetit Publik”** ofrohet nëpërmjet programeve kombëtare të imunizimit, TBC, HIV/AIDS dhe IST, të survejancës epidemilogjike dhe ndjekjes së sëmundshmërisë infektive (sëmundshmërisë kronike me pasoja në shëndet publik të ndikuara nga kushtet e mjedisit) si dhe të programeve të sigurisë ushqimore, kontrollit të ujit të pijshëm dhe shëndetit riprodhues. Gjatë vitit 2020 është rritur volumi i aktivitetit në lidhje me monitorimin e situatave apidemiologjike dhe inspektimet, për shkak të situatës (404 mijë inspektime ose 12 fish më shume se parashikimi, me një kosto faktike prej rreth 264 milion lekë dhe 3,350 kontrole për agjentët mjedisore për ujërat, ambjentin, ushqyerjen, shëndetin në punë ose 5% më shumë se parashikimi). Megjithatë, numri i vaksinime është ulur lehtësisht (207 mijë fëmijë të vaksinuar përkundrejt 240 mijë të planifikuar) dhe po ashtu, numri i depistimeve të popullatës për kancerin e gjirit (3,150 depistime ose 40% më pak se parashikimi). Po ashtu, 270 punonjës mjekësorë dhe jo-mjekësorë janë trajtuar me bonus per COVID-19”, me kosto faktike rreth 76 milionë lekë, për vitin 2020.

Për sa i përket programit të shërbimit të urgjencës mjekësore, numri i thirrjeve të administruara gjatë vitit 2020 ishte 780 mijë, ose pothuajse dyfishi i vitit paraardhës. Megjithatë, kostoja faktike ishte rreth 248 milionë lekë (55% më shumë se 2019), për shkak të menaxhimit në distancë të një pjese të thirrjeve. Edhe në këtë program është përballuar bonusi i personelit mjekësor dhe jo-mjekësor për përballimin e Covid-it, i cili u akordua në këtë program me rishikimin e buxhetit.

Programi **“Përkujdesi Social”**, mbështet nëpërmjet pagesave në cash dhe shërbimeve sociale, familjet në nevojë dhe individët me aftësi të kufizuara, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe mundësive personale, për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara social ekonomike.

Gjatë vitit 2020, programi i ndihmës ekonomike u zgjerua për të mbështetur me ndihmë ekonomike shtesë (dyfish) për familjet që ishin përfituese në prill 2021, për një periudhë tremujore gjatë karantinës; si edhe disa familje të pakualifikuara për programin me një pagesë prej 16,000 lekësh. Si rezultat, shpenzimet për ndihmën ekonomike u rritën me 24% përkundrejt planit fillestar dhe kostoja për njësi e programit u rrit gjithashtu me rreth 23%. Më hollësisht, produktet e financuara nga programi përfshijnë:

- ✓ “Familje dhe individë në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike”, është realizuar me një kosto faktike prej rreth 5.4 miliardlekë për 66,650 familje përfituese; përkundrejt planit prej 4.38 miliardë lekë për 66,000 familje përfituese
- ✓ “Persona me aftësi të kufizuar përfitues nga programi i aftësisë së kufizuar” është realizuar me një kosto faktike prej rreth 18,465 milion lekë për 168.243 persona përfitues, me një rritje prej 13% ndaj planit fillestar dhe mbulimin e 2,243 më shumë përfituesve

- ✓ “Përfitues të shërbimeve të përkujdesit social të ofruara në qendrat rezidenciale publike”, është realizuar me një kosto faktike prej rreth 871 milionë lekë për 824 persona. Numri i përfituesve në qendrat rezidenciale ishte më i ulët se parashikimi (1,100 përfitues) për shkak të mbylljes së përkohshme të disa prej qendrave; por niveli i shpenzimeve ishte afërt me planin fillestar (4% më shumë), pasi përfshiu edhe pagesat bonus për personelin në kushtet e Covid-it.
- ✓ Shperblimi i lindjes” ku kanë përfiturar 36,188 bebe me një kosto faktike prej rreth 2,820 milion lekë, ose 41% më shumë fonde për 21% më shumë përfitues se plani fillestar.

Për sa u përket **investimeve publike**, realizimi në vitin 2020 ishte 77% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (1 miliard lekë) dhe 112% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (0,95 miliardë lekë). Buxheti i shpenzimeve kapitake pësoi disa ndryshime, duke shtuar fonde për projekte prioritare për përbalimin e pandemisë; përfshirë edhe disa rialokime. Disa vonesa lidhur me proceset e prokurimeve dhe procedurat ligjore; por edhe kushtet e pandemisë veçanërisht për disa projektë të huaja vonuan përfundimin e disa projekteve. Disa nga projektet kryesore ishin:

- Disa investime u ndërmorën posaçërisht për përbalimin e efekteve të pandemisë (1 miliard lekë shtesë nga financim i brendshëm dhe i huaj ose 1,2 miliard lekë në total, nga të cilat u realizuan rreth 60%), ku përfshihen blerje paisjesh mjekësore të ndryshme; respiratorë; instalimi i linjës së gazrave mjekësore në tre spitale; rikonstruksioni i reanimacionit të spitalit Vlorë dhe blerje autoambulancash për spitalet
- Rikonstruksion i 105 qendrave shëndetësore në qytete/njësi administrative të vendit për shërbimin shëndetësor parësor (355,6 nga 500,3 milionë lekë të parashikuar, në vijim të rishikimit të buxhetit)
- Rikonstruksione dhe pajisje për shërbimet e kujdesit dytësor, përfshirë spitalin Kukës, pediatriinë Durrës, fazën e 2-të rehabilitimit të QSUT-së (kredi nga CEB) dhe pajisje e aparatura (1,5 miliardë të realizuara nga 2,2 të parashikuara, ose 71%).

8.3.2 Arsimi

Në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2020, performanca e treguesve buxhetorë për këto katër programe kryesore në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, paraqitet si më poshtë:

Tabela 18 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (në mijë lekë)

Programi buxhetor	Fakti viti 2019	Buxheti vjetor Plan fillestar 2020	Buxheti vjetor Plan i rishikuar 2020	Realizimi faktik 2020	Diferenca në % me planin fillestar	Diferenca në % me planin e rishikuar
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	753 885	735 000	689 000	616 731	84%	90%
Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	22 429 799	23 320 720	22 742 420	22 147 728	95%	97%
Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm)	7 161 886	7 364 043	6 973 830	6 834 684	93%	98%
Arsimi Universitar	8 766 492	9 730 000	9 485 672	8 812 526	91%	93%
Fonde për Shkencën	364 028	500 000	640 000	614 895	123%	96%
Zhvillimi i Sportit dhe Rinisë	447 625	330 000	248 200	208 474	63%	84%
Grant i trashëguar	-	-	655 470	-	-	-
Gjithsej	39 923 715	41 979 763	41 434 592	39 235 038	93%	94,7%

Në programin “Arsimi Bazë” është ofruar shërbimi i mësimdhënies për mbi 415 mijë fëmijë në arsimin parashkollor dhe arsimin bazë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar uljes së braktisjes shkollore; tërheqjes e

fëmijëve romë/egjiptianë dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në kushtet e pandemisë, u zhvilluna klasa përgatitore para fillimit të vitit shkollor 2020-2021 për rekuperimin e dijeve të munguara për fëmijët që nuk kishin frekuentuar rregullisht mësimin gjatë periudhës së karantinës si dhe u dhuruan 5438 pajisje digjitale për ndjekjen e mësimave. Gjatë vitit shkollor 2019 – 2020, të zhvilluar në distancë, 70% e fëmijëve romë dhe 93% e fëmijëve egjiptianë në arsimin bazë publik ndoqën rregullisht mësimin. Për shkak të kushteve të pandemisë, gjatë vitit 2020 disa aktivitete jashtëshkollore si programi i mbështetjes së fëmijëve jashtë shkollës nuk u zhvilluan; po ashtu disa aktivitete si transporti i mësuesve dhe fëmijëve nëpër shkolla nuk ishte i nevojshëm, çka rezultoi në realizim lehtësisht më të ulët të buxhetit se plani fillestar.

Në programin **“Arsimi Mesëm i Përgjithshëm”** afërsisht 96% e nxënësve që përfunduan arsimin e detyrueshëm u regjistruan në arsimin e mesëm. Në vitin shkollor 2020 – 2021 marrin shërbim arsimor në arsimin e mesëm të përgjithshëm rreth 77,382 nxënës, me një kosto prej rreth 5,823 milion lekë. Vijoi ofrimi i shërbimit të transportit për rreth 5.000 mijë mësues të AML me një kosto (43 milion lekë) si dhe plotësimi i paketës kurrikulare sipas qasjes me bazë kompetencat në arsimin e mesëm të lartë. Po ashtu, mosrealizimi i lehtë i planit është i lidhur me kufizimin e disa aktiviteteve kryesisht jashtëshkollore dhe mosplotësimin e personelit për shkak të pandemisë.

Në programin **“Arsimi Lartë”**, gjatë vitit 2020, tashmë me një reformë tërësore të sistemit të arsimit të lartë, që synon rritjen e cilësisë në të gjithë sistemin, pa cenuar aspak mundësitë e të rinjve për t’u arsimuar, është rritur numri i studentëve në ciklin e parë të studimeve në rreth 79.398 studentë me një kosto prej rreth 7,287 milion lekë. Ka vijuar me prioritet financimi me bursa i studentëve me rezultate të larta, atyre nga kategorive sociale në nevojë, si dhe përjashtimi 100 % nga tarifa vjetore e shkollimit apo reduktimi në masën 50% nga tarifa vjetore e shkollimit për studentët e ciklit të dytë. Për vitin akademik 2020-2021 kanë përfutur bursa dhe mbështetje financiare, nëpërmjet akomodimit në shtëpitë e trajtimit të studentëve të rreth 19,351 studentëve me një kosto me rreth 1.1 miliardë lekë (nga 20,704 studentë të parashikuar).

Për sa u përket **investimeve publike**, realizimi në vitin 2020 arriti në 2.67 miliardë lekë, ose 97% e buxhetit të rishikuar dhe 68% e buxhetit fillestar për Ministrinë e Arsimit për shpenzime kapitale. Buxheti fillestar u pakësua me 1.1 miliard lekë për shkak të vobesave të hasura në prokurime për shkak të kufizimeve gjatë gjysmës së parë të vitit 2020. Disa nga projektet kryesore të realizuara ishin:

- Në arsimin bazë u përfunduan 34 kontrata investimi me vlerë totale rreth 1.3 miliardë lekë, për rikonstruksione/rindërtime/shtesa të 9 shkollave 9-vjeçare dhe pajisje mobilerie për shkollat e rindërtuara të arsimit bazë, të dëmtuara nga tërmeti, që rikonstruktohen në kuadrin e Programit të Rindërtimit
- Në programin e Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm janë përfunduar 24 kontrata me vlerë totale rreth 1.3 miliardë lekë për rikonstruksione/ shtesa/ të shkollave të mesme.
- Në programin e Arsimit të lartë janë mbyllur 8 kontrata me vlerë totale 348 milionë lekë, përfshirë ndërtimin e një godine të re universitare për Universitetin "Aleksander Moisiu" Durrës dhe pajisje për konviktet e studentëve në qytetet Korçë, Vlorë dhe Shkodër.
- Në programin e Sportit dhe rinisë janë mbyllur 4 kontrata me vlerë 78.6 milionë lekë për mjedise sportive dhe rikonstruksione në katër shkolla, pallatin e sportit Rrëshen dhe Qendren rinore Korçë.

8.3.3 Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

Performanca e treguesve buxhetorë për shtatë programet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, paraqitet si më poshtë:

Tabela 19 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (në mijë lekë)

Programi buxhetor	Fakti viti 2019	Buxheti vjetor Plan fillestar 2020	Buxheti vjetor Plan i rishikuar 2020	Realizimi faktik 2020	Diferenca në % me planin fillestar	Diferenca në % me planin e rishikuar
Planifikim menaxhim administrimi	292 428	411 000	309 660	301 561	73%	97%
Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1 378 437	1 897 122	1 500 814	1 375 680	73%	92%
Mbeshtetje për peshkimin	248 138	966 635	245 231	206 518	21%	84%
Menaxhimi i infrastruktures së kullimit dhe ujitjes	3 293 192	3 610 800	4 332 274	4 226 761	117%	98%
Zhvillimi rural duke mbështetur bujqësinë, blegtorinë dhe agroindustrinë	1 639 883	3 675 443	3 683 560	3 491 252	95%	95%
Keshillimi dhe informacioni bujqësor	396 602	524 000	451 506	426 731	81%	95%
Menaxhimi i qendrueshëm i tokës bujqësore	13 396	27 000	12 200	12 103	45%	99%
Gjithsej ministria	7 262 076	11 112 000	10 535 245	10 040 606	90%	95%
Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	22 829		119 432	1 025		1%
Gjithsej	7 284 905	11 112 000	10 654 677	10 041 631	90%	94%

Buxheti vjetor i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural fillestar u rishikua në ulje të lehtë (-4%) gjatë vitit 2020 nëpërmjet 3 Akteve Normative për rishikimin e buxhetit. Realizimi faktik ishte 10.04 miliardë lekë, ose 90% e buxhetit fillestar dhe 94% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve korrente ishte 97% dhe i investimeve 94% e planit të rishikuar.

Në programin e **“Zhvillimi Rural duke mbështetur bujqësinë, blegtorinë dhe agroindustrinë”**, janë realizuar produkte me një kosto faktike prej 3.5 miliard lekë (nga 3.7 miliardë të planifikuara në buxhetin fillestar), përfshirë:

- Grante nga skemat e mbështetjes kombëtare për 5,496 fermerë dhe agrobiznese (përkundrejt 2,300 të planifikuarve) me një kosto faktike 1.14 miliardë lekë (përkundrejt 1 miliard lekësh në buxhetin fillestar).
- Grante nga skema IPARD për 280 fermerë (përkundrejt 317 në planin fillestar) me një kosto prej 1.4 miliardë lekë, ose 26% më e ulët se buxheti fillestar
- Panaire lokale dhe ndërkombëtare, aplikacione promovuese, vrojtme statistikore dhe analizime, testime e certifikime për fara dhe fidanë

Në programin **“Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”**, janë realizuar produkte me një kosto faktike prej 1,4 miliardë lekë (ose 73% e planit fillestar dhe 85% e të rishikuarit), përfshirë:

- Kafshë të vaksinuara dhe të gjurmua: është realizuar vaksinimi i 653 mijë krerëve (përkundrejt 930 mijë të planifikuar) , me një kosto faktike prej 35.7 milionë lekë (nga 28 milionë në planin fillestar).
- Janë kryer analiza e inspektime për kafshë dhe në fushën e sigurisë ushqimore; dëmshtëpërbyer fermerë për shkak të prejjes së bagëtisë nga sëmundja e plasjes dhe brucelozës si dhe trajtuar 6,000 hektarë me dëmtime nga grerëza e gështenjës.

Në programin “**Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit**”, me rishikimin e buxhetit u rritën fondet e akorduara në program me 20% dhe u zbatuan disa produkte me një kosto totale prej 4.2 miliardë lekë, ose 17% më shumë se plani fillestar (98% e planit të rishikuar), ndër të cilat 3.6 miliardë lekë investime.

Për sa u përket **investimeve publike** janë mbyllur kontratat e investimit si më poshtë sipas programeve buxhetore:

- Në programin e Ujitjes dhe Kullimit kanë përfunduar 44 kontrata për objekte të mbrojtjes nga përmytja. Ndër objektet kryesore janë: Përroi Zaranikës, Skema ujitëse-Sektor i Ri në Xeng, Rehabilitimi i Kanalit Ujitës Hardhishtë-Rreth, Rehabilitimi i pesë kanaleve ujitëse në zonën e Sukut, Mbrojtje nga lumi Vjose ne Pische Poro, Fier dhe rehabilitim i skemes ujitëse ujëmbledhësi Malaj2 (Faza 3), etj.
- Në programin Mbështetje për Peshkimin, është mundësuar investimi i “Ndërtimit të tregut të peshkut Shengjin”.
- Në programin Siguria Ushqimore është përmirësuar më tej infrastruktura e Institutit të sigorisë Ushqimore dhe Veterinare.

8.3.4 Infrastruktura dhe Energjia

Performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, paraqitet si më poshtë:

Tabela 20 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (në mijë lekë)

Programi buxhetor	Fakti viti 2019	Buxheti vjetor Plan fillestar 2020	Buxheti vjetor Plan i rishikuar 2020	Realizimi faktik 2020	Diferenca në % me planin fillestar	Diferenca në % me planin e rishikuar
Planifikim Menaxhim Administrimi	900899	549 956	504 547	493 207	98%	97,8%
Transporti Rrugor	23 396 044	22 559 832	28 863 204	28 930 649	128%	100,2%
Transporti Detar	141 004	155 009	145 075	132 197	85%	91%
Transporti Hekurudhor	644802	1 789 400	759 456	599 901	34%	79%
Transporti Ajror	10 252	55 200	55 200	43 698	79%	79%
Furnizimi me ujë dhe Kanalizime	9 114 439	8 574 711	12 620 153	11 042 888	129%	88%
Menaximi i Mbetjeve Urbane	2 118 631	3 492 272	3 653 272	3 494 979	100%	96%
Mbështetje për Energjinë	3 027 562	2 590 900	2 375 900	1 945 578	75%	82%
Mbështetje për Burimet Natyrore	269 158	204 000	263 778	256 262	126%	97%
Mbështetje për Industrinë	338 035	379 150	376 616	357 575	94,3%	94,9%
Planifikimi Urban	154 866	329 100	392 184	260 491	79%	66%
Gjithsej	40 115 692	40 679 530	50 009 385	47 557 425	117%	95%

Buxheti vjetor fillestar i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë fillestar u rishikua në rritje të ndjeshme (+23%) gjatë vitit 2020 nëpërmjet akteve normative për rishikimin e buxhetit, për të akomoduar nevojat shtesë për investime veçanërisht në programet e transportit rrugor dhe të furnizimit me ujë dhe kanalizime. Realizimi faktik ishte 47.6 miliardë lekë, ose 117% e buxhetit fillestar dhe 95% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve korrente ishte 90% dhe i investimeve 94.8% e planit të rishikuar. Investimet me financim të brendshëm në përgjithësi u realizuan sipas planit në të gjitha programet, ndërsa pati disa pengesa në disa projekte me financim të huaj.

Në programin “Transporti Rrugor” ka vijuar puna për forcimin dhe integrimin me rrjetin rajonal dhe përfundimin e korridoreve me te gjitha korsite dhe parametrat teknike deri ne v. 2020, duke perfshire arterie strategjike si: autostrada Adriatiko-Joniane ne kuader te procesit te Berlinit dhe Konektivitetit; Korridori 8; Korridori Durrës-Morinë. Ky program ka marrë financime shtesë gjatë vitit 2020 për të garantuar ecurinë e shpejtë të punimeve, ne veçanti 7.2 miliardë lekë shtesë në korrik 2020 (Akti normativ 28); dhe rreth 0.5 miliardë shtesë për financimin e shpronësimeve lidhur me punimet në aksin lidhës të unazës së Tiranës, studimin e fizibilitetit për tunelin e Llogarasë si dhe ndërtimin e urës së Tapizës. Po ashtu, buxheti u pakësua me 140 milionë lekë nga financimi për AKSHI-n si dhe me 2.6 miliardë lekë në dhjetor 2020 (Akti normativ 34), duke marrë ne konsideratë ecurinë vjetore të punimeve.

Në këtë kuadër, është kryer **ndërtimi dhe rehabilitimi sipas standardeve i rrugëve të rrjetit kombëtar me kosto** 10 miliardë lekë, ose rreth 99.8 % e fondeve vjetore sipas planit të rishikua, përfshirë përfundimin e punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore për nyjen e Milotit(358 milionë lekë); ndërtimi i unazës Tiranë dhe rrethrotlimi “Shqiponja” (2.6 miliardë lekë) dhe by-pass-i perëndimor Shkodër (0.26 miliardë lekë) (kategoria A); ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë Loti 4, 5, 6 (kategoria B, 3.2 miliardë lekë); dhe 2,5 miliardë lekë ose 100% e fondeve të planifikuara për objekte të kategorisë C, përfshirë *ndërtimin e by-pass-it Tepelenë; stabilizimi i rrëshqitjeve në segmentin rrugor Milot - Rrëshen, rruga e vjetër; dhe kthimi i bregut të liqenit në gjendjen e mëparshme në aksin Lin - Pogradec.*

Po ashtu, për sistemimin, asfaltimin e riveshjen për rrugë të rrjetit kombëtar, janë realizuar fonde në masën 841 milionë lekë përgjatë vitit 2020; ku përfshihen përmirësimi e rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore në akset e Rajonit verior, Rajonit qendror, Rajonit jugor, punime ndërtimi për eliminimin e pikave të zeza në rrugë financim kombëtar dhe bashkëfinancim IPA 2013, Siguria rrugore).

Në programin “**Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime**” u realizuan shpenzime në masën 11 miliardë lekë, ose 29% me shumë se buxheti fillestar dhe 12% më pak se buxheti i rishikuar. U realizuar 23,424 ml linja të reja ujësjellësi për furnizimin me ujë, shoqëruar me një kosto prej 4.9 miliardë lekë. Gjithashtu, janë kryer rikonstruksione ujësjellësi për rreth 848 ml ose 92% e fondeve të planifikuara për produktin “Rikonstruksion Ujësjellësi”; si dhe ndërtime dhe rikonstruksione për rrjetet e kanalizimeve të ujërave të zeza. Realizimi i investimeve për KUZ ishte relativisht më i ulët për shkak të vonesave kryesisht për projektet me financim të huaj.

Në programin “Mbështetje për Burimet Natyrore” është realizuar qëllimi i programit lidhur me realizimin e politikave të promovimit, mbikëqyrjes, monitorimit dhe transparencës në fushën e gjeologjisë, minierave, ambientit dhe ujërave. Në këtë kuadër, janë përditësuar 725 të dhëna të lejeve minerare gjeohapsinor, me kosto prej 4 milionë lekë; u realizua mbikëqyrja e 360 burimeve të shfrytëzimit minerare, metalore dhe jo metalore, me kosto prej 15.2 milionë lekë; u krye studimit mbi zonimin minerar dhe hartimi o planit vjetor dhe 3-vjecar minerar dhe raporti vjetor i gjendjes mjedisore në industrinë minerare dhe metalurgji.

Në programin “**Menaxhimi i Mbetjeve urbaneu realizuan fonde në masën 3.5 miliardë lekë, ose 100% e buxhetit fillestar dhe 86% e buxhetit të rishikuar.** Shpenzimet korrente (0.7 miliardë lekë) u realizuan në masën 100% të buxhetit fillestar dhe të rishikuar, pavarësisht pakësimit e më vonë shtimit të buxhetit të fondeve korrente me 200 milionë lekë për inceneratorin e Tiranës (përkatesisht me AN 6 dhe AN 34). Shpenzimet kapitale u realizuan në masën 97% të planit të rishikuar, ose 2.3 miliardë lekë. Disa rialokime gjatë vitit 2020 janë lidhur me projektet e inceneratorit të Fierit, Elbasanit dhe mbylljes së venddepozitimit ekzistues në Durrës. Projektet kryesore të realizuara përfshijnë sipërfaqe landfilli e ndërtuar në rajonin e Korçës (135 milionë lekë); venddepozitimi i Bushatit (15 milionë lekë); impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Elbasan (587 nga 661 milionë lekë në buxhetin fillestar) dhe në Fier (756 nga 753 milionë lekë në planin fillestar).

8.3.5 Turizmi dhe Mjedisi

Performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit paraqitet si më poshtë:

Tabela 21 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Programi buxhetor	Plani fillestar 2020		Plani i rishikuar 2020		Fakti 2020		Diferenca në % me planin fillestar		Diferenca në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
<i>(në mijë lekë)</i>										
Planifikim, Menaxhim, Administrim	201 000	2 000	196 300	2 171	184 788	2 152	92%	108%	94%	99%
Administrimi i Pyjeve	437 000	89 812	370 000	87 962	318 676	69 943	73%	78%	86%	80%
Financimi i huaj		50 000		320 000		338 007		676%		106%
Zhvillimi i Turizmit	178 630	265 500	451 830	254 293	355 763	251 105	199%	95%	79%	99%
Financimi i huaj		50 000		50 000		40 134		80%		80%
Mbrojtja e Mjedisit	494 000	183 088	477 120	101 253	405 488	89 097	82%	49%	85%	88%
Financimi i huaj		290 000		409 000		692 713		239%		169%
<i>Gjithsej sipas natyrës</i>	1 310 630	930 400	1 495 250	1 224 679	1 264 715	1 483 151	96%	159%	85%	121%
Gjithsej	2 241 030		2 719 929		2 747 866		123%		101%	

Buxheti vjetor fillestar i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit u rishikua në rritje të ndjeshme (+21%, ose 479 milionë lekë shtesë) duke arritur një buxhet 3% më të lartë se realizimi i vitit paraardhës. Realizimi faktik ishte 2.7 miliardë lekë, ose 123% e buxhetit fillestar dhe shumë afër buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve korrente ishte 96% e planit fillestar dhe i investimeve 60% më shumë se plani fillestar, por 21% më shumë se i rishikuari. Mbirealizimi erdhi si pasojë e ecurisë më të mirë se parashikimet me projektet me financim të huaj në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe administrimit të pyjeve.

Në programin **“Mbrojtja e Mjedisit”** për vitin 2020, fondet e akorduara nga buxheti i shtetit janë realizuar në masën 86% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara. Përmirësimi i cilësisë së mjedisit, ajrit, mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit janë ndjekur nëpërmjet realizimit të 20 puseve artizanale në zonën e Kune Vainit për të siguruar përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike; monitorimit dhe inspektimeve për gjendjen e liqeneve dhe mjedisit. Në këtë program janë shqyrtuar aplikime për leje mjedisore në masën 76% përkundrejt parashikimit.

Në programin **“Administrimi i Pyjeve”** synohet të realizohet deri në vitin 2021 hartimi i planeve të menaxhimit për 90% të zonave të mbrojtura dhe 100 % të planeve të mbarështrimit për sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullor. Gjatë vitit 2020 kanë hyrë 3.4 milionë turistë në zonat e mbrojtura dhe janë regjistruar 300,000 ha pyje dhe kullota.

Në programin **“Zhvillimi i Turizmit”** synohet kthimi i Shqipërisë në një destinacion tërheqës turistik, cilësor dhe të qëndrueshëm, duke shfrytëzuar potencialet dhe burimet lokale. Pavarësisht goditjes nga pandemia, gjatë vitit 2020 kanë hyrë 2.66 milionë shtetas të huaj në Shqipëri, nga të cilët janë 1.14 milionë turistë brenda sezonit veror dhe 1.5 jashtë sezonit veror dhe 1,315 struktura akomoduese kanë marrë certifikatën e kategorizimit.

Për sa u përket **investimeve publike** disa nga projektet kryesore të vitit 2020 ishin përmirësimi i infrastrukturës në zonën e mbrojtur Kune Vain; ngritja e sistemit elektronik të monitorimit të pyjeve; hartimi i masterplaneve për zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

8.3.6 Drejtësia

Performanca e treguesve buxhetorë për nëntë programet kryesore në Ministrinë Drejtësisë, paraqitet si më poshtë:

Tabela 22 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Drejtësisë

Programi buxhetor	Plani fillestar 2020		Plani i rishikuar 2020		Fakti 2020		Diferenca në % me planin fillestar		Diferenca në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
<i>(në mijë lekë)</i>										
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	430 000	375 300	319 117	325 300	299 244	297 305	70%	79%	94%	91%
Publikimet Zyrtare	54 400	5 000	43 365	5 000	43 015	3 813	79%	76%	99%	76%
Mjekësia Ligjore	77 000	10 000	73 090	10 000	72 601	9 137	94%	91%	99%	91%
Shërbimi për Çështjet e Birësimit	14 500	2 000	9 070	2 000	8 856	1 256	61%	63%	98%	63%
Agjencia e Trajtimit të Pronave ALUIZNI	3 762 000	1 000	2 105 396	1 000	2 083 748	450	55%	45%	99%	45%
Ndihma juridike	76 000	0	45 500	-	17 140	-	23%		38%	
Shërbimi i Përmbartimit gjyqësor	154 100	0	129 600	-	127 100	-	82%		98%	
Sistemi i Burgjeve	5 362 916	370 374	5 369 416	320 374	5 184 109	268 039	97%	72%	97%	84%
Shërbimi i Provës	151 300	500	140 970	500	134 351	333	89%	67%	95%	67%
Gjithsej sipas natyrës	10 082 216	764 174	8 235 524	664 174	7 970 164	580 333	79%	76%	97%	87%
Gjithsej	10 846 390		8 899 698		8 550 497		79%		96%	

Buxheti vjetor fillestar i Ministrisë së Drejtësisë u rishikua në ulje gjatë vitit 2020 (-18% më pak se buxheti fillestar ose 17% më pak se fakti I vitit paraardhës).. Realizimi faktik ishte 8.55 miliardë lekë, ose 79% e buxhetit fillestar dhe 96% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve përkundrejt planit fillestar ishte 79% për shpenzimet korrente dhe 76% për shpenzimet kapitale. Në krahasim me buxhetin e rishikuar, realizimi ishte disi më i ulët (87%) për investimet, një pjesë e të cilave janë kryer me më pak fonde se buxheti fillestar; ndërkohë që të tjera do të likuidohen gjatë vitit 2021.

Në programin “**Agjencia e Trajtimit të Pronave**” janë realizuar produkte me kosto faktike prej 2,1 miliard lekë, ndër të cilat kanë përfituar 254 subjekte nga fondi fizik dhe financiar të kompensuar (2.1 miliardë lekë); 997 subjekte kanë përfituar nga shpërndarja e fondit të ALUIZNIT (1.2 milionë lekë, nga fondet e mbartura gjatë vitit 2020 që ndodhen në Bankën e Shqipërisë); janë trajtuar 55 vendime për kalimin në pronësi të oborreve në përdorim 1.9 milionë lekë) dhe janë ankimuar 896 raste gjyqësore në gjykatë, me kosto faktike 2.1 milionë lekë.

Për sa u përket **investimeve publike**, janë mbyllur 21 kontrata me vlerë totale 740 milionë lekë, ndër të cilat janë blerë pajisje speciale dhe kontrolli për sigurinë në sistemin e burgjeve (116.8 nga 119.5 milionë lekë në plan); rikonstruksioni i ambjenteve të zyrave të D.P.Burgjeve dhe qendrës së trajnimeve, përmirësimi i sistemit për zyrën e gjendjes gjyqësore, arkiva elektronike e akteve, blerje pajisjesh autopsy dhe laboratorike.

8.3.7 Institucionet e Sistemit të Drejtësisë

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi në për qindje për vitin 2020 për **Institucionet e Mbikqyrjes dhe Rivlerësimit në sistemin e Drejtësisë**, paraqiten si më poshtë:

Tabela 23 Realizimi i buxhetit 2020 për Institucionet e Drejtësisë

Programi buxhetor	Plani fillestar 2020		Plani i rishikuar 2020		Fakti 2020		Diferenca në % me planin fillestar		Diferenca në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
<i>(në mijë lekë)</i>										
Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë	93 200	7 000	36 050	7 000	34 174	6 061	37%	87%	95%	87%
Komisioni I Pavarur I Kualifikimit	186 200	4 000	186 350	4 000	184 030	1 834	99%	46%	99%	46%
Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	125 000	2 000	129 150	2 000	126 062	854	101%	43%	98%	43%
Komisionerët Publikë	66 200	1 000	66 050	1 000	62 808	579	95%	58%	95%	58%
<i>Gjithsej sipas natyrës</i>	470 600	14 000	417 600	14 000	407 074	9 328	87%	67%	97%	67%
Gjithsej	484 600		431 600		416 402		86%		96%	

- Në lidhje me disa nga treguesit e performancës për **Komisionin e Pavarur të Kualifikimit** për vitin 2020, përmendim:
 - Prej fillimit të veprimtarisë, janë shortuar 756 subjekte rivlerësimi
 - Numri i dosjeve të marra në shqyrtim është rreth 430 dosje.
 - Gjatë 12 mujorit të vitit 2020 janë marrë gjithsej 104 vendime.
- Nga ana e **Komisionerëve Publikë** për vitin 2020 janë shqyrtuar 103 çështje të njoftuara nga KPK, nga 130 të planifikuara.
- Nga ana e **Kolegjit të Posaçëm i Apelimit** për vitin 2020 janë shqyrtuar 63 çështje nga 90 të planifikuara.

Pranë zyrës së **Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë** gjatë periudhës shkurt-dhjetor 2020 janë depozituar 3 054 ankesa nga të cilat: 756 ankesa nga qytetarët; 185 ankesa nga institucione të tjera dhe 9 ankesa nga organizata të tjera. Gjatë periudhës shkurt-dhjetor 2020 janë miratuar 184 vendime pas shqyrtimit të ankesave, konkretisht: 42 vendime për verifikimin e ankesave, nga të cilat 13 janë arkivuar pas verifikimit dhe pjesa tjetër, 29, janë në proces shqyrtimi; si dhe 142 vendime për arkivimin e ankesave.

Për sa u përket **investimeve publike**, me fondet e realizuara për investime (në total për 4 institucionet) prej 9.2 milionë lekë në vitin 2020, janë realizuar blerje pajisje kompjuterike dhe pajisje zyrash.

8.3.8 Financat, Ekonomia, Punësimi dhe Arsimi Profesional

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi në përqindje për vitin 2020 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për të gjithë programet, paraqiten si më poshtë:

Tabela 24 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Programi buxhetor 000 lekë	Plani fillestar 2020		Plani i rishikuar 2020		Fakti 2020		Diferenca në % me planin fillestar		Diferenca në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	594 000	193 000	639 970	250 000	594 427	242 866	100%	126%	93%	97%
Financim i huaj		200 000		531 000		520 363		260%		98%
Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	377 000	0	416 702	-	356 782	-	95%		86%	
Ekzekutimi i Pagesave të Ndryshme	300 000	200 000	495 781	200 000	461 676	198 000	154%	99%	93%	99%
Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore	2 530 000	417 000	2 431 400	417 000	2 177 578	415 516	86%	100%	90%	100%
Financim i huaj				4 000		5 713				143%
Menaxhimi i të Ardhurave Doganore	3 275 000	173 220	2 877 800	147 220	2 829 916	121 003	86%	70%	98%	82%
Financim i huaj		84 100		84 100		45 981		55%		55%
Lufta kundër Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore	78 900	2 000	76 012	2 000	73 576	1 675	93%	84%	97%	84%
Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	309 500	70 000	263 900	22 760	233 337	19 421	75%	28%	88%	85%
Financim i huaj		150 000		225 000		217 386		145%		97%
Mbështetje për Mbikq. e Tregut, Infrast. e Cilës. dhe Pron. Industr.	329 500	16 000	291 013	11 000	233 461	10 828	71%	68%	80%	98%
Sigurimi Shoqëror	43 805 750	0	53 108 014		53 107 260		121%		100%	
Tregu i Punës	1 669 000	30 000	14 367 870	40 800	13 669 948	34 818	819%	116%	95%	85%
Inspektimi në Punë	176 300	10 000	165 600	1 300	140 286	1 292	80%	13%	85%	99%
Arsimi i Mesëm Profesional	2 058 500	475 469	1 945 330	597 559	1 773 928	591 833	86%	124%	91%	99%
Financim i huaj		703 900		358 900		27 745		4%		8%
Strehimi	1 309 000	320 000	3 230 359	354 963	3 145 916	354 156	240%	111%	97%	100%
Gjithsej sipas natyrës	56 812 450	3 044 689	80 309 751	3 247 602	78 798 091	2 808 596	139%	92%	98%	86%
Gjithsej	59 857 139		83 557 353		81 606 687		136%		98%	

Buxheti i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë u rishikua në rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2020, si një nga institucionet kyç që administroi masat shtetërore në ndihmë të biznesit dhe tregut të punës për përballimin e pasojave të pandemisë Covid-19. Buxheti u rrit me rreth 40% në krahasim me planin fillestar të përgjithshëm: rritja i atribuohet kryesisht programit të sigurimit shoqëror; tregut të punës dhe strehimit; ndërkohë që disa programe të tjera patën pakësime të vogla.

Në programin **“Tregu i Punës**, i cili synon nxitjen e mundësive për punë të denjë dhe rritjen e punësueshmërisë së forcave të punës, fondet u rritën në 14.4 miliardë lekë, nga 1.7 miliardë të parashikuara në buxhetin fillestar. Gjatë vitit 2020, shpenzimet në këtë program arritën në 12.7 miliardë lekë, ose 95 për qind e buxhetit të rishikuar. Në veçanti, një nga rezultatet kryesore të arritura nëpërmjet këtij programi ishte mbështetja për biznesin në kushtet e mbylljes ekonomike gjatë karantinës së Covid-19 (VKM 254, 284, 305/2020), ku u paguan gjithsej 12.05 miliardë lekë (ose 98% e fondeve të parashikuara) për 243,500 biznese dhe individë të prekur nga pandemia:

- Në kompanitë me qarkullim vjetor deri në 14 milionë lekë:
 - 65,574 punonjës dhe të vetëpunësuar në ndërmarrje të mbyllura nga masat anti-Covid morën paga minimale 26,000 lekë për tre muaj në 38,994 subjekte, për 5.1 miliardë lekë
 - 68,391 përfitues në 31,746 ndërmarrje të lejuara të operojnë në kushte të pazakonta, morën një pagesë 40,000 lekë; për një total prej 2.73 miliardë lekë
- Pagesa e papunësisë: 6,527 përfitues të pagesës së papunësisë përfituan nga dyfishimi i mbështetjes gjatë periudhës, për 170 milionë lekë
- Ndërmarrjet me qarkullim mbi 14 milionë lekë në vit, të mbyllura prej masave anti-Covid (821 ndërmarrje): 9,435 individë morën një pagesë prej 40,000 lekë, për një total prej 377 milionë lekësh

- Punonjësit e larguar nga puna në ndërmarrjet e lejuara të operojnë: 65,666 ish-punëmarrës në 10,476 ndërmarrje morën një pagesë 40,000 lekë për një total prej 2.63 miliardë lekë
- Punëmarrësit në ndërmarrjet e hotelierisë: 4,927 përfitues në 1,106 ndërmarrje morën pagese 40,000 lekë për një total prej 197 milionë lekë
- 721 punonjës në rafinerinë e Ballshit dhe 28,379 punëmarrës në ndërmarrje të tjera (pas ankimit) morën pagesa për një total prej 984 milionë lekë.

Gjithashtu, program vijoi të realizonte produktet e tij të zakonshme, përfshirë ndërmjetësimet për punëkërkues në tregun e punës; pagesat e papunësisë dhe shërbimet e tjera të punësimit. Një program i ri për nxitjen e punësimit u miratua në shtator 2020, për të mbështetur punësimin e punëmarrësve të larguar nga puna për shkak të Covid-it nëpërmjet mbulimit të pagës minimale për 4 muaj dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore për 8 muaj të tjerë, me një kosto prej 200 milionë lekë shtesë (në 2020 dhe 2021); krahas një programi për mbështetjen e formalizimit të punëmarrësve informalë (44 milionë lekë në vitin 2020). Nga shtatori 2020 deri në fund të vitit rreth 1,650 punonjës u punësuan nëpërmjet këtij programi, mes të cilëve 560 kishin qenë informalë.

Në programin **“Strehimi”**, i cili mbështet zbatimin dhe monitorimin e politikave për sigurimin e strehimit të përballueshëm dhe të përshtatshëm për kategoritë në nevojë; fondet e parashikuara u rritën në 3.6 miliardë lekë, nga 1.6 miliardë në buxhetin fillestar, për të përballuar kostot e qirasë së subvencionuar për të prekurit nga tërmeti në nëntor 2019 në 11 bashki. Gjatë vitit 2020 u shpenzuan 3.5 miliardë lekë, ose 98 për qind e buxhetit të rishikuar.

Në përputhje me objektivat e programit të strehimit është arritur:

- Subvencionimi i interesave të kredive në vazhdim për 3,750 familje, për 153.6 milionë lekë, me një rritje të lehtë të kostos (5%) për shkak të rritjes së interesit për bonot e thesarit. Ndërkohë, u subvencionuan më pak kredi të reja se parashikimi fillestar, për shkak të vonësive të krijuara nga situata e pandemisë.
- U subvencionuan qiratë për 1,118 familje me të ardhura të ulëta në 23 bashki, për një kosto totale prej 88 milionë lekë
- U subvencionuan qiratë për familjet e prekura nga tërmeti për mbi 13,000 familje në 11 bashki, për një kosto totale prej 2.9 miliardë lekë (ose 98% e fondeve sipas planit të rishikuar). Numri i familjeve përfituese u rrit si rezultat i vazhdimit të verifikimeve në terren të banesave të shpallura të pabanueshme me akt konstatim, çka solli rritjen e kërkesës për mbështetje buxhetore nga ana e bashkive, me rishikimin e fundit të buxhetit (dhjetor 2020).
- 10 familje të prekura nga tërmeti përfituan grant të menjëhershëm për 13.3 milionë lekë. 27 familje të tjera do të përfitojnë nga ky grant në përputhje me VKM përkatëse në 2021.
- Disa projekte përmirësimi banesash janë financuar për vitin 2020, përfshirë 561 familje të komuniteteve të pafavorizuara (239 milionë lekë); dhe 99 familje të strehuara në godinat në pronësi të njësisve vendore (115 milionë lekë).

Në programin **“Sigurimi Shoqëror”**, fondet e parashikuara sipas planit vjetor të rishikuar janë në vlerën e 53 miliardë lekë, ose 21 për qind më shumë se plani fillestar. Për 12-mujorin 2020 janë realizuar thuajse 100% e fondeve. Nëpërmjet këtij programi është subvencionuar deficitin e skemës së pensioneve publike për Institutin e Sigurimeve Shoqërore në masën 39.5 miliardë lekë; si dhe janë paguar programet e posaçme të skemës së kompensimit të çmimeve (5.4 miliardë lekë); pensionet e veteranëve (dhe kompensimet përkatëse); invalidëve të punës; pensionet sociale; trajtimi i veçantë i punonjësve të nëntokës; sigurime suplementare për disa kategori të veçanta.

Fondet e parashikuara për programin e **“Arsimit të mesëm profesional”** sipas planit vjetor të rishikuar janë në vlerën e 2.9 miliardë lekë, nga 3.23 miliardë të parashikuara në planin fillestar, si rezultat i pamundësisë për realizimin e plotë të projekteve të investimit me financim të huaj. Për 12-mujorin 2020 u shpenzuan 2.4 miliardë lekë, ose në masën 98% e fondeve të rishikuara dhe 89% e planit fillestar. Shpenzimet operative u realizuan në masën 86% të planit fillestar, edhe për shkak të situatës së pandemisë; ndërkohë që investimet

me financim të brendshëm u realizuan në masën 124% të planit fillestar dhe 99% të të rishikuarit, ose 592 milionë lekë. Ndër projektet kryesore ishin rikonstruimi i shtatë shkollave profesionale në Cërrik, Durrës, Elbasan, Kavajë, Gjakastër, Berat dhe Tiranë. Disa përmirësime infrastrukturore janë kryer për zyrat e shërbimit të punësimit dhe qendrat e trajnimit profesional; godinat e degëve të doganave në Tiranë dhe Vlorë; si dhe rritja e kapaciteteve të rrjetit për Ministrinë e Financave. Po ashtu, për Tatimet u pagua kuota e anëtarësimit në programin FISCALIS 2020.

Gjatë vitit 2020, Ministria e financave dhe Ekonomisë vijoi përmirësimin e sistemeve të saj digjitale, nëpërmjet mirëmbajtjes së Sistemit të thesarit dhe blerjes së licencave Oracle. Në vitin 2020 u përfundua sistemi i menaxhimit të informacionit financiar të Qeverisë shqiptare (AFMIS), i cili mundëson lidhjen në kohë reale dhe regjistrimin e planifikimit dhe monitorimin e veprimeve financiare – përfshirë monitorimin e performancës; çka do të mundësojë përmirësimin e mëtejshëm të efektivitetit të menaxhimit të financave publike.

8.3.9 Mbrojtja

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi në përqindje për vitin 2020 për Ministrinë e Mbrojtjes, paraqiten si më poshtë:

Tabela 25 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Mbrojtjes

Programi buxhetor	Plani fillestar 2020		Plani i rishikuar 2020		Fakti 2020		Diferenca në % me planin fillestar		Diferenca në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
<i>(në mijë lekë)</i>										
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1 189 000	20 000	1 233 733	29 650	1 210 233	29 647	102%	148%	98%	100%
Forcat e Luftimit	5 845 835	3 799 950	4 837 789	2 784 764	4 404 898	2 718 974	75%	72%	91%	98%
Mbështetja e Luftimit	5 923 410	230 800	5 546 407	243 803	5 257 787	206 139	89%	89%	95%	85%
Arsimi ushtarak	600 050	110 000	567 870	10 110	516 255	9 043	86%	8%	91%	89%
Mbështetje për Shëndetësinë	845 550	50 000	1 109 224	50 000	1 080 758	37 369	128%	75%	97%	75%
Mbështetje Sociale për Ushtarakët (sig shoq)	5 060 000	0	5 122 136	-	5 122 136	-	101%		100%	
Emergjencat Civile	295 000	139 250	334 885	620 250	262 588	497 510	89%	357%	78%	80%
Gjithsej sipas natyrës	19 758 845	4 350 000	18 240 961	3 738 577	17 854 655	3 498 680	90%	80%	95%	94%
Gjithsej	24 108 845		22 490 621		21 353 335		89%		95%	

Ministria e Mbrojtjes ka synuar që nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimit të korrupsionit në Forcat e Armatosura, të arrijë realizimin e disa prej treguesve kryesorë të performancës, ku renditen:

- Lartësimi i figurës dhe integritetit të ushtarakut
- Implementimi në mënyrë cilësore i detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja dhe anëtarësia në organizma të niveleve të larta ndërkombëtare si: NATO, EAPC, RACVIAC, Karta e Atlantikut, etj; i realizuar nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadër të partneritetit mes vendeve, rritjes së sigurisë në rajon e më gjerë.
- Modernizimi me armatim të lehtë dhe municione për Forcat e Armatosura, sistemet e mbështetjes për zjarr apo vendosja e kamerave Infra të Kuqe stacionare të integruara me sistemin SIVHD.

Projektet prioritare në aspektin e ndërveprueshmërisë me strukturat e NATO-s, si dhe në kuadër të rritjes së sigurisë kombëtare, janë:

- Sistemet e Integruara të vëzhgimit të hapësirës ajrore e detare.
- Kompletimi i Forcave të Armatosura me pajisje individuale të luftimit, në funksion të certifikimit të Batalionit të dytë të këmbësorisë si një komponent i gatshëm i NATO Response Force.

- Shpenzimet operacionale u përdoren me efikasitet për kryerjen e misionit të Forcave të Armatosura si në rang kombëtar ashtu dhe në kuadër të misioneve paqeruajtëse, duke rritur prezencën e Forcave të Armatosura në Detin Egje, Afganistan, KFOR, etj.

Programi “Forca e Luftimit”, i cili synon mbajtjen në gatishmëri të kapaciteteve operacionale të forcës tokësore, detare e ajrore, ka shpenzuar 4.4 miliardë lekë (shpenzime korrente) në vitin 2020, ose 91 për qind të planit të rishikuar dhe 75 për qind të planit fillestar. Janë kryer disa projekte investimi, në vlerën 2.7 miliardë lekë, ose 72% e planit fillestar, përfshirë blerje armatimi e municionesh për forcat e armatosura (1.7 miliardë lekë).

Programi “Mbështetja e Luftimit” siguron logjistikën dhe inteligjencën strategjike për operacione të ndryshme si dhe kapacitete operacionale për reparte të vecanta. Realizimi ishte 5.8 miliardë lekë, ose 89% e planit fillestar dhe 94% e të rishikuarit.

Për programin “Mbështetje për Shëndetësinë”, janë planifikuar fillimisht 3 (tre) produkte korrente me buxhet 846 milionë lekë; i cili u rrit për të përballuar pasojat e pandemisë në 1.1 miliardë lekë, të cilat u realizuan në vlerën 1.08 miliardë, ose 97 për qind e planit të rishikuar. Për sa u përket shpenzimeve kapitale, 3 projekteve të parashikuara fillimisht iu shtua një i katërt, i cili u akomodua brenda parashikimit financiar fillestar, ku përfshihen projektme dhe përmirësime në infrastrukturën fizike të Spitalit të traumës e projektim përkatës (20.6 milionë lekë) si dhe blerje pajisjesh mjekësore e radiografie (16.6 milionë lekë).

Programi **“Emergjencia Civile”** lidhet me veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile. Fondet e miratuara për këtë program u rishikuan në rritje për buxhetin 2020, në vijim të tërmetit të nëntorit 2019, duke arritur në 955 milionë lekë, ose mbi dyfishin e planit fillestar. Gjatë vitit 2020 u realizuan shpenzime në masën 760 milionë lekë, ose 78 për qind e shpenzimeve korrente, 99 për qind e përket shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm dhe vërejmë se nuk ka pothuaj fare realizim për financimin e huaj të planifikuar në masën 119.250 mijë lekë. Nënrealizimi përkundrajt planit të rishikuar lidhet kryesisht me situatën e pandemisë, e cila vonoi proceset e rekrutimit në AKMC; si dhe vështirësoi mobilizimin e mjeteve për kryerjen e projekteve të huaja.

8.3.10 Kultura

Performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore të Ministrisë së Kulturës paraqitet si mëposhtë:

Tabela 26 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Kulturës

Programi buxhetor 000 lekë	Plani fillestar 2020		Plani i rishikuar 2020		Fakti 2020		Diferenca në % me planin fillestar		Diferenca në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi Administrimi	165 000	0	151 400	-	139 650	-	85%		92,2%	
Trashëgimia kulturore dhe muzetë	555 881	7 500	525 981	370 127	483 672	312 251	87%	4163%	92,0%	84,4%
Financimi i huaj		35 323	-	35 323	-	14 697		42%		41,6%
Arti dhe Kultura	768 000	579 500	751 000	547 500	724 270	487 977	94%	84%	96,4%	89,1%
Financimi i huaj		145 000	-	145 000	-	8 940		6%		6,2%
Gjithsej sipas natyrës	1 488 881	767 323	1 428 381	1 097 950	1 347 592	823 865	91%	107%	94,3%	75,0%
Gjithsej	2 256 204		2 526 331		2 171 457		96%		86%	

Buxheti i Ministrisë së Kulturës u rishikua në rritje gjatë vitit 2020, kryesisht për të përballuar disa nga pasojat shkatërruese që tërmeti i vitit 2019 la edhe në trashëgiminë kulturore. Buxheti u rrit me rreth 12% në krahasim me planin fillestar të përgjithshëm: rritja i atribuohet kryesisht programit të transhëgimisë kulturore; ndërkohë që programet e tjera patën pakësime të vogla.

Në programin “Trashëgimia Kulturore”, u realizuan hartimi i një sërë projektsh për restaurimin e objekteve të dëmtuar nga tërmetet e shtatorit dhe nëntorit 2019, si dhe restaurimi apo konsolidimi i objekteve monument kulture që rrezikohen nga degradimi i plotë për: Muzealizim i Muzeut “Mesenjëtorja e parë shqipe”, “Restaurim kisha e Shën Ilias Stegopull”, “Restaurimi i catisë së banesës së Sali Shijakut”, “Projekti elektrik për ndricimin e jashtëm Kalaja e Shkodrës, Kalaja e Beratit, Kalaja e Krujës, Kalaja e Gjirokastrës. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, të cilit iu akorduan 236.6 milionë lekë për restaurimet pas tërmetit dhe vrojtime arkeologjike në Zonat e reja të zhvillimit pas tërmetit, shpenzoi 190.2 milionë lekë për këtë qëllim, ose 80 për qind të fondit.

Gjithashtu, veprimtaria muzeale vijoi nëpërmjet aktiviteteve dhe projekteve online në Muzeun Kombëtar të Fotografisë “Marubi” dhe disa muze të tjera; ndërkohë që restaurime vijuan në Muzeun Historik Kombëtar dhe parqet arkeologjike të Butrintit dhe Apolonisë.

Në kushtet e masave të marra për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, në programin “Arti dhe Kultura” ka vijuar puna on-line dhe janë vënë në skenë disa shfaqje online, përfshirë 200 premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit skenik operistik, koreografik dhe folklorik kombëtar (288.8 milionë lekë); 170 premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit skenik teatror klasik dhe bashkëkohor (87.2 milione lekë) dhe 135 premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit skenik teatror eksperimental klasik dhe bashkëkohor (30.6 milionë lekë) dhe 30 aktivitete me fokus promovimin e krijimtarisë letrare(21.1 milionë lekë).

Për sa i përket **investimeve publike** janë mbyllur 13 kontrata me vlerë totale 1.8 miliardë lekë nga të cilat veçojmë:

- Investime të reja në skenat bashkëkohore si rikonstrukcionin e Teatrit të Operas dhe Baletit 91.7 (miliardë lekë); rikonstrukcioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura;
- Muzealizimi i Muzeut "Mesenjëtorja e parë shqipe" me vlerë 6 milionë lekë
- Restaurim i kishës së "Shën Ilias Stegopull" me vlerë 8 milionë lekë,
- Restaurim i kishës së "Shën e Premtes në fshatin Valsh", Faza II, Gjinar, Elbasan me vlerë 4 milionë lekë.

8.3.11 Rendi dhe Siguria Publike

Performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore të Ministrisë së Brendshme paraqitet si mëposhtë:

Tabela 27 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë e Brendshme

Programi buxhetor 000 lekë	Plani fillestar 2020		Plani i rishikuar 2020		Fakti 2020		Diferenca në % me planin fillestar		Diferenca në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	990 000	39 400	1 937 320		1 865 666		181%		96%	
Policia e Shtetit	15 190 729	717 151	15 037 017	642 151	14 851 973	637 504	98%	89%	98,8%	99,3%
Financimi i huaj		818 868		685 868		634 910	#DIV/0!	78%		92,6%
Garda e Republikës	1 506 000	100 000	1 522 000	55 000	1 513 687	54 805	101%	55%	99,5%	99,6%
Shërbimi i Gjendjes Civile	483 000	45 000	639 266	2 000	586 211	1 266	121%	3%	91,7%	63,3%
Prefekurat dhe Funkcionet e Deleguar	653 500	2 000	486 156	71 000	450 874	68 949	69%	3447%	92,7%	97,1%
Gjithsej	20 545 648		21 110 778		20 698 375		101%		98%	

Buxheti i Ministrisë së Brendshme u rishikua në rritje të lehtë gjatë vitit 2020 (3 për qind), duke arritur në 21.1 miliardë lekë, nga të cilat u realizuan 10.7 miliardë lekë, ose 98 për qind. Rritja i atribuohet kryesisht programit të shpenimeve publike të përgjithshme (planifikimi, menaxhimi, administrimi), ku fondet thuajse u dyfishuan

(+0.9 miliardë lekë); ndërsa rritje pati edhe në shpenzimet korrente të programit të gjendjes civile, ndërsa buxheti për investime u pakësua në tërësi.

Në programin **“Policia e Shtetit”**, u realizuan 96% e shpenzimeve ndaj planit vjetor për:

- Rritja e hetimeve proaktive në luftën kundër krimit të organizuar, trafikeve, korrupsionit, terrorizmit si dhe forcimi i koordinimit ndërinstucional ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit ku u kryen 140 operacione të posaçme; 68 programe anti-kanabis; 39,305 operacione policore të hetuara apo shërbime; dhe 51 operacione policore ndaj ekstremistëve e grupeve terroriste, me realizim thuajse të plotë me planin.
- Rritja e sigurisë publike dhe sigurisë rrugore përmes patrullimeve në rrugë dhe forcimi i kontrollit të territorit me policimin në komunitet; duke realizuar 6,189 shërbime të policisë rrugore të kryera në rrugët nacionale; apo 99% e sasisë së rishikuar për vitin 2020, me një kosto totale prej 254 milionë lekë; 485 shërbime të Forcave Speciale dhe e NSH për sigurimin e rendit publik apo 98% e sasisë së planifikuar vjetore, me një kosto totale prej 1,087 milionë lekë; 1,986 raste asistence dhe trajnime për Policinë e Shtetit, me kosto prej 123 milionë lekë dhe janë punësuar 10% më shumë punonjëse të policisë rrugore gra ndaj totalit, krahasuar me një vit më parë.
- Forcimi i masave për luftën kundër krimit ndërkufitar dhe trafikeve të paligjshme me synim rritjen e standardeve të sigurisë së kufijveduke realizuar 51 operacione të sigurisë në kufirin blu, apo 98% e sasisë së planifikuar për vitin 2020, me një kosto totale prej 125 milionë lekë; janë 1,550 raste/10,420 mijë kalimtarë të kufirit zbulues të trafikimit të paligjshëm duke përdorur teknikat e posaçme hetimore dhe janë trajtuar 320 shtetas të huaj në Qendrën e pritjes Karec
- Përafrimi i standardeve të shërbimeve policore me ato të BE-së, u trajnuan 209 rekrutë të rinj, apo 98% e sasisë së planifikuar për vitin 2020, me një kosto totale prej 89 milionë lekë.

Programi **“Garda e Republikës”**, me realizimin e fondeve me rreth 99% ndaj planit vjetor, me ndryshime, ka realizuar reruajtjen e 110 Personaliteteve VIP vendas dhe të huaj, me një kosto prej 1,514 milionë lekë; modernizimi i sektorit të ruajtjes nga incidentet me LE dhe ASHM në Gardë.

Në programin **“Shërbimi i Gjendjes Civile”**, ka realizim të fondeve rreth 92% ndaj planit vjetor, duke realizuar kështu regjistrimin e 909,363 akteve dhe dokumenteve të lëshuara nga shërbimi i Gjendjes Civile, me kosto prej 391 milionë lekë. Programi **“Prefektura dhe Funkcionet e Deleguara”**, ka realizuar fondet për vitin 2020 në masën 94%.

Për sa u përket **investimeve publike** janë mbyllur 4 kontrata me vlerë totale rreth 488 milionë lekë. Nga këto veçojmë:

- *Mjete Transporti të blera me bashkëfinancim me vlerë totale prej 417 milionë lekë,*
- *Restaurimi i godinës së re “Prefektura Tiranë” -Faza I me vlerë totale prej 71 milionë lekë.*

8.3.12 Politika e Jashtme

Performanca e treguesve buxhetorë për katër programet kryesore në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme paraqitet si më poshtë:

Tabela 28 Realizimi i buxhetit 2020 për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme

Programi buxhetor 000 lekë	Plani fillestar 2020		Plani i rishikuar 2020		Fakti 2020		Diferenca në % me planin fillestar		Diferenca në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	142 600	2 000	133 800	2 000	116 524	1 771	82%	89%	87,1%	88,6%
Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2 761 500	7 000	2 676 451	7 000	2 617 316	7 000	95%	100%	97,8%	100,0%
Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	252 000	0	237 500	-	164 002	-	65%	-	69,1%	
Mbështetje institucionale për procesin e Integritimit	96 000	155 280	92 300	155 280	78 482	66 106	82%	43%	85,0%	42,6%
<i>Gjithsej sipas natyrës</i>	3 252 100	164 280	3 140 051	164 280	2 976 324	74 877	92%	46%	94,8%	45,6%
Gjithsej	3 416 380		3 304 331		3 051 201		89%		92%	

Programi “**Mbështetje institucionale në procesin e integritimit**” ka si objektiv hapjen e negociatave të anëtarësimit dhe në përpara shteteve anëtare të BE-së i aftësisë së Shqipërisë për të plotësuar kriteret e anëtarësimit në BE. Në këtë program janë realizuar disa produkte me kosto faktike 92.3 milionë lekë, ku përmendim tetë takime të institucioneve të përbashkëta Shqipëri – Bashkimi Evropian ngritur në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit; dy raportime të plota dhe një raportim plotësues i Qeverisë shqiptare në kuadër të përgatitjes së Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020; pjesëmarrja në tre thirrje të hapura në kuadër të Instrumentit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor (ĒBIF), nga të cilat përfitoi në total gjashtë projekte për asistencë teknike dhe dy projekte investimi. Gjithashtu, u koordinua pjesëmarrja e Shqipërisë në Programet Evropiane, në programimin e Programeve të Bashkëpunimit Territorial dhe u zhvilluan vizitat monitoruese në kuadër të programeve të Bashkëpunimit Territorial.

Për sa u përket **investimeve publike**, vlen të përmenden financimet në kuadër të fondeve IPA, projekteve ndërkuftare me vendet e rajonit, të cilat janë projekte në vazhdim.

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ